| Blloku Qendror | Antanta |
|---|---|
| Gjermania, Austro-Hungaria, Italia | Britania e Madhe, Francë, Rusi |

Zonat ku përplaseshin interesat në Europë:

- Ballkani,
- Territoret polake
- Kufiri franko-gjerman
- Kufiri verilindor i Italisë

Mësuesi/ja plotëson se rivaliteti zhvillohej edhe për çështje të tjera, si:

✓ Anglia përpiqej të ruante hegjemoninë e saj në det, në botën industriale dhe në koloni.
✓ Serbia synonte bashkimin e sllavëve të Ballkanit nën kurorën e saj.
✓ Lëvizjet për pavarësi të popujve të shtypur, që gjendeshin në Perandorinë Osmane dhe atë Austro-Hungareze.
✓ Gjermania rriti shumë pretendimet e saj.

Në pjesën "Përgatitja për luftë" nxënësit parashikojnë të mësojnë se shtetet filluan të militarizoheshin. Filloi një propagandë e gjerë nga qeveritë e dy Blloqeve dhe qeveritë u ushqenin popujve një nacionalizëm të skajshëm ose shovinizëm, duke ngjallur urrejtje për kundërshtarët. Mësuesi/ja shton se preteksti për fillimin e Luftës I Botërore ishte vrasja e princit trashëgimtar të Perandorisë Austro-Hungareze, Franc Ferdinandit. Lufta nisi zyrtarisht në 28 korrik 1914.

✓ Austria, me pëlqimin e Gjermanisë, i shpalli luftë Serbisë dhe pushtoi Bosnjën.
✓ Gjermania i shpalli luftë Rusisë e Francës
✓ Kundër Gjermanisë hyri në luftë Anglia dhe Japonia.
✓ Dy vjet më vonë në krah të Antantës hyri dhe SHBA-ja.
✓ Përkrah Bllokut Qendror u radhitën Perandoria Osmane e Bullgaria.
✓ Rumania përkrahu Antantën

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Për të evidentuar përvetësimin e njohurive të reja, mësuesi/ja përdor pyetjet në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Ai/ajo u kërkon nxënësve të plotësojnë tabelën në f. 10 dhe bën disa pyetje për të nxitur diskutime në klasë.

- Cilat janë shkaqet që çuan në shpërthimin e Luftës I Botërore?
- Cilat janë shtetet që hynë në luftë?
- Pse lufta përfshiu pothuajse të gjitha shtetet e Europës brenda një kohe të shkurtër?
- Sipas mendimit tuaj, cili është ndryshimi midis nacionalizmit, nacionalizmit të skajshëm dhe atdhetarizmit (patriotizmit).

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në përgjigjet e dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime e debate.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Nxirrni nga interneti hartën e Luftës I Botërore. Ngjyrosni hartën sipas blloqeve luftuese.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.1:**<br>**Lufta dhe Paqja (1914–1920)**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Zhvillimi i Luftës dhe përfundimi i saj (1914–1918)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të nxjerrin hartën e Europës gjatë Luftës I Botërore (që e kanë pasur detyrë shtëpie) dhe të kenë bërë ndarjen mes shteteve luftuese. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- përkufizon termin "luftë rrufe";<br>- analizon arsyet e hyrjes së Italisë në Luftë krah Antantës;<br>- përshkruan përfundimin e Luftës I Botërore. | | **Fjalë kyç:**<br>Luftë Rrufe, Fronti Perëndimor, Fronti Lindor, shtet neutral, bllokadë detare, vijat e frontit | |
| **Burimet:**<br>Teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Luftën e Parë Botërore | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Bashkëbisedim**

Së bashku me nxënësit, mësuesi/ja risjell në kujtesë pretekstin dhe shkaqet e fillimit të Luftës I Botërore. Ai/ajo rikujton nxënësit për ndarjen e blloqeve, duke i treguar ato në hartë dhe duke i shkruar në tabelë.

**Hapi i dytë: Ditari dypjesësh**

Mësuesi/ja përdor teknikën "Ditar dypjesësh", ku ndan tabelën në dy pjesë dhe plotëson shtyllat "Çështja" dhe "Komenti.

| **Çështja** | **Komenti** |
|---|---|
| Plani gjerman i Luftës | ➢ Mbështetet në lëvizjen e shpejtë të ushtrisë dhe në sulmin e befasishëm.<br>➢ Parashikonte dy frontet: Frontin Perëndimor, që drejtohej kundër Francës, dhe Frontin Lindor, që drejtohej kundër Rusisë<br>➢ Plani dështoi se kufiri francez ishte i fortifikuar, Gjermania hyri në Belgjikë për të sulmuar Francën, por hasi në rezistencën e popullit belg<br>➢ Në Betejën e Marnës Gjermania u detyrua të kalonte në mbrojtje dhe shënoi dështimin e planit gjerman. |
| Hyrja e Italisë në Luftë | ➢ Fillimisht, shtet neutral<br>➢ Italia hyri në bisedime të fshehta me Antantën. Më 26 prill 1915 shtetet e Antantës dhe Italia nënshkruan një marrëveshje, "Traktati i Fshehtë i Londrës", me premtimin që do të merrte pas Luftës krahinat verilindore (Trentinën e Triesten), dhe territore e ishuj në Ballkan, ku përfshihej edhe ishulli i Sazanit dhe Vlora me rrethinat e saj.<br>➢ Në maj 1915, Italia i shpalli luftë Austro-Hungarisë; lindi Fronti Jugor i Luftës |
| Veprimet luftarake gjatë vitit 1916-1917 | ➢ Frontet kryesore: perëndimor, lindor, jugor<br>➢ Betejat kryesore: Beteja e Verdunit dhe beteja mbi lumin Soma<br>➢ Gjermanët përdorën për herë të parë përdorën nëndetëset<br>➢ Ngjarjet kryesore të vitit 1917:<br>o Revolucioni në Rusi<br>o Hyrja e ShBA-së përkrah Antantës<br>➢ Armët që u përdorën:<br>o armë të shkatërrimit në masë (gaz helmues etj.);<br>o nëndetëse, aeroplanë luftarakë;<br>o granata dore, mitralozë, tanke, pushkë me precizion. |
| Përfundimi i Luftës I Botërore | ➢ Shpërbëhen Perandoria Austro-Hungareze dhe Perandoria Gjermane.<br>➢ Më 9 nëntor u shpall republika në Gjermani.<br>➢ Qeveria e re më 11 nëntor 1918 nënshkroi armëpushimin dhe lufta përfundoi me dështimin e plotë të forcave të Bllokut Qendror. |

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Mësuesi/ja përdor pyetjet në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime", për

të matur nivelin e njohurive të reja që kanë përftuar nxënësit, duke bërë pyetje për të nxitur diskutime në klasë.

- Në Luftën I Botërore u përdorën armë të shkatërrimit në masë. Sipas mendimit tuaj, cilat janë disa nga pasojat më të rrezikshme të përdorimit të këtyre armëve?
- Lufta I Botërore quhet dhe lufta e parë industriale dhe moderne. A të duket i drejtë ky përcaktim? Argumento mendimin tënd.

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Nxirrni nga interneti foto që bëjnë fjalë për Luftën I Botërore dhe krijoni një minialbum me to.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.1:**<br>**Lufta dhe Paqja (1914–1920)**<br>**Tema mësimore:**<br>**Konferenca e Paqes dhe krijimi i Lidhjes së Kombeve** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos pamje nga punimet e Konferencës së Paqes dhe të udhëheqësve kryesorë të shteteve fituese dhe u flet shkurtimisht rreth këtyre fotove. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>➢ liston vendimet e Konferencës së Paqes;<br>➢ analizon dy qëndrimet që u mbajtën në Konferencë;<br>➢ tregon rëndësinë e krijimit dhe qëllimin e Lidhjes së Kombeve. | | **Fjalë kyç:**<br>Konferenca e Paqes, Lidhja e Kombeve, harta e re e Europës, shtet kombëtar | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Konferencën e Paqes | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë "Lufta I Botërore" dhe u kërkon nxënësve të flasin për të. Nxënësit evidentojnë shkaqet, pasojat dhe përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Këtu mësuesi/ja ndërhyn për të lidhur përfundimin e Luftës me Konferencën e Paqes.

**Hapi i dytë: Pema e mendjes**

Mësuesi/ja orienton nxënësit drejt leximit të tekstit dhe plotëson skemën e mendjes së bashku me ta.

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Për të matur nivelin e njohurive të reja që kanë përftuar nxënësit përdoren pyetjet në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja u drejton pyetje nxënësve për të nxitur diskutime në klasë:

– Pse paqja e vendosur u quajt "Paqe ndëshkuese"?

– A ishte e drejtë që vendet humbëse të shpalleshin të vetmet fajtore për dëmet që shkaktoi lufta?

- Konferenca e Paqes
  - U mbajt më 18.1.1919 dhe u shfaqën dy
    - Qëndrimi amerikan nga Presidenti Uillson
      - një sistem të ri: botë e çarmatosur (me paqe, mirëkuptim,
    - Qëndrimi i Anglisë, Francës, dhe Italisë
      - Kërkonin të ngarkonin me faj shtetet humbëse
  - Morën pjesë për të firmosur traktatet:
    - Shtetet fituese (SHBA-ja, Anglia, Franca, Italia)
    - Shtetet humbëse (Gjermania, Austro-Hungaria)
  - Vendimet:
    - Nënshkrimi i traktateve të paqes me shtetet humbëse
    - U krijua harta e re e Europës
    - U shpërbë Perandoria Austro-Hungareze, Osmane,
    - Nga Gjermania u shkëputën territore; i kaluan Francës,
    - Shtetet humbëse u detyruan të paguanin
    - Mori vendime të padrejta ndaj Shqipërisë
    - Nuk i zgjidhi problemet e Luftës I Botërore
    - Paqja u quajt e gabuar dhe ndëshkuese
    - U krijua Lidhja e Kombeve, me qëllim ruajtjen e paqes, e

## ▶ Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

## ▶ Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej në internet të dhëna për programin e Uillsonit. Analizo dhe vlerëso 14 pikat e programit të tij.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: HistorI 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.1:<br>Lufta dhe Paqja (1914–1920)</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja vendos foto me pamje të pasojave të Luftës I Botërore, si qytete të shkatërruara, ndërtesa që digjen, ushtarë e civilë të vrarë etj. Ai/ajo u kërkon nxënësve të flasin rreth këtyre pamjeve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Pasojat e Luftës së Parë Botërore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- liston disa nga pasojat e Luftës I Botërore;<br>- tregon arsyet e pakënaqësive që shpërthyen në Europë;<br>- shpjegon kuptimin e konceptit "inflacion".</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>humbje në njerëz, vështirësi ekonomike, zhgënjimi i shoqërisë pas Luftës, inflacion</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Luftën I Botërore</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin në mendje vendimet e Konferencës së Paqes, të tregojnë qëndrimet që u shfaqën në këtë konferencë, shtetet që u krijuan nga shpërbërja e disa perandorive, si ajo Austro-Hungareze, Gjermane, Osmane etj. Ai/ajo u drejton dy pyetje nxënësve, për t'i përgatitur ata për hapin e dytë:

– Çfarë pasojash sjellin luftërat?

– Si ndikojnë ato në jetën e njerëzve dhe në ekonominë e vendeve?

**Hapi i dytë: Di-dua të di-mësova**

Mësuesi/ja përdor teknikën "Di-Dua të di-Mësova" për ndërtimin e njohurive të reja. Ai/ajo ndaj tabelën në tri pjesë dhe e plotëson së bashku me nxënësit.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| ➢ Lufta sjell shkatërrim, viktima, rrënim të vendeve luftuese, dëmtime, varfërim, pra humbje njerëzore e materiale për vendet ndërluftuese | ➢ Dëmet që solli lufta për shtetet ndërluftuese;<br>➢ Si ndikoi lufta në jetën dhe ekonominë e vendeve? | ➢ Asnjë luftë në Europë nuk kishte lënë kaq shumë pasoja.<br>➢ 8 milionë të vdekur e 21 milionë vetë të plagosur e gjymtuar; miliona të tjerë vdiqën pas Luftës nga mungesa e ushqimit dhe nga epidemitë<br>➢ Dëme ekonomike:<br>◆ u shkatërruan toka bujqësore;<br>◆ u rrënuan qytete me qendra industriale;<br>◆ mungonin prodhimet ushqimore, industriale e bujqësore<br>◆ Europa u shndërrua nga eksportues në importues të drithërave;<br>◆ u zhvlerësua monedha.<br>➢ ShBA-ja e Japonia u bënë kryesuese të tregut botëror |
| ➢ Lufta sjell pakënaqësi | ➢ Cilat janë pakënaqësitë që shkaktoi Lufta I Botërore? | ➢ tronditje psikologjike<br>➢ zhgënjimi i punëtorëve për një jetë të re e më të mirë;<br>➢ fshatarët do të merrnin tokë;<br>➢ nuk u bë reforma agrare;<br>➢ kjo gjendje solli manifestime e protesta, të kryesuara nga lëvizjet e punëtorëve dhe partitë politike. |

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja bën pyetjet që jepen në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime", për të matur nivelin e njohurive të reja që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi. Ai/ajo synon të nxisë diskutime në klasë, duke bërë pyetjet e mëposhtme:

– Sipas mendimit tuaj, viktimat e mëdha të Luftës erdhën si pasojë e:
- shtrirjes botërore të Luftës?
- zbulimit të armëve të reja të dëmtimit në masë?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej të dhëna në internet për vepra artistike e letrare, që tregojnë për gjurmët e Luftës I Botërore në jetën e njeriut.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.1:<br>Lufta dhe Paqja (1914–1920)</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Lexim i drejtuar<br>Lufta e Parë Botërore filloi në korrik të vitit 1914. Ajo u zhvillua mes dy Blloqeve politike ushtarake: Antantës nga njëra anë dhe Bllokut Qendror nga ana tjetër. Kjo luftë zgjati rreth 4 vjet e gjysmë dhe përfundoi në nëntor 1918. Gjatë Luftës së Parë Botërore territoret shqiptare u pushtuan nga shtetet ndërluftuese Austro-Hungaria, Franca, Italia.<br>Pozicioni politik i Shqipërisë gjatë kësaj lufte ishte tepër i ndërlikuar. Fuqitë e Mëdha, të cilat në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, e kishin njohur shtetin shqiptar dhe kishin përcaktuar territoret e tij, tashmë ishin në luftë me njëri-tjetrin. Për më tepër, Princ Vilhelm Vidi, i caktuar nga Fuqitë e Mëdha si Princ i Shqipërisë, u largua nga Shqipëria sapo shpërtheu Lufta Botërore (shtator 1914).<br>Shtetet pjesëmarrëse në Luftën e Parë Botërore kishin drejtpërdrejt ose tërthorazi interesa ndaj territoreve shqiptare, të cilat u rrezikuan veçanërisht pas nënshkrimit të Traktatit të Fshehtë të Londrës në prill të vitit 1915. Në Konferencën e Paqes që u mbajt në Paris, u përcaktua edhe fati i Shqipërisë dhe i territoreve të saj. Në këtë konferencë u përfaqësuan edhe shqiptarët.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br><br>Shqipëria gjatë viteve 1914–1918 dhe Traktati i Fshehtë i Londrës (veprimtari praktike)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- përshkruan statusin politik të Shqipërisë në prag të Luftës së Parë Botërore;<br>- evidenton qëndrimin e shtetit shqiptar në konfliktin botëror;<br>- analizon interesat e shteteve ndërluftuese ndaj territoreve shqiptare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Shqipërinë gjatë Luftës I Botërore</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, komunikim,</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Fillimisht, mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë me vëmendje pjesën "Lexim i orientuar". Ai/ajo u kërkon nxënësve të përqendrohen në çështjet e mëposhtme për t'u dhënë përgjigje atyre, duke u bazuar edhe në njohuritë që marrë më parë.

– Cili ishte statusi politik i Shqipërisë kur nisi Lufta?
– Çfarë qëndrimi mbajti shteti shqiptar në konfliktin botëror?
– Si dhe pse u kthyen territoret shqiptare në shesh lufte mes shteteve ndërluftuese?
– Çfarë interesash kishin shtetet ndërluftuese ndaj territoreve shqiptare?
– Çfarë vendimesh mori Konferenca e Paqes në Paris, veçanërisht në lidhje me Shqipërinë?

**Hapi i dytë: Punë në grupe**

Mësuesi/ja e ndan klasën në pesë grupe dhe i cakton secilit grup të trajtojë një çështje.

**Grupi 1.** Përshkruan statusin politik të Shqipërisë në fillim të Luftës I Botërore. Për këtë detyrë grupi shfleton materiale të Historisë së Shqipërisë për të përcaktuar statusin politik e juridik të shtetit shqiptar sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (29 korrik 1913).

**Grupi 2.** Përcakton qëndrimin zyrtar të shtetit shqiptar ndaj shteteve ndërluftuese dhe vetë Luftës. Për këtë pyetje mund të shqyrtohen informacione për Krahinën Autonome të Korçës dhe veprimtarinë e Esat pashë Toptanit gjatë viteve të konfliktit botëror. Mësuesi/ja orienton nxënësit të përdorin internetin.

**Grupi 3.** Krijon hartën e veprimeve luftarake të ushtrive pushtuese në territoret shqiptare gjatë Luftës I Botërore. Grupi e ndërton këtë hartë duke përdorur materiale të internetit dhe shoqërohet me legjendën përkatëse, ku sqarohen me ngjyra dhe me fjalë ushtritë që kanë pushtuar ose që kanë kaluar në territoret shqiptare.

**Grupi 4.** Mbledh informacione për interesat e shteteve ndërluftuese ndaj territoreve shqiptare. Ky grup do të do të identifikojë anëtarët e blloqeve politiko-ushtarake, që u përfshinë në konfliktin botëror, interesat e tyre ndaj territoreve shqiptare, duke u fokusuar veçanërisht në interesat e Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. Duke u mbështetur në informacionet që mund të gjenden në internet apo burime të tjera, ndërtohet harta ku evidentohet se si do të ndaheshin territoret shqiptare sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës.

**Grupi 5.** Përcakton delegacionet kryesore të shqiptarëve që prezantuan dhe mbrojtën interesat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe evidenton vendimet që mori Konferenca për Shqipërinë, duke shfrytëzuar internetin ose tekstet e historisë së Shqipërisë për mbledhjen e informacionit për këtë pikë.

Mësuesi/ja orienton grupet për përgatitjen e materialeve. Sipas detyrës së dhënë, materiali duhet të përmbajë harta, dokumente, ngjarje, foto dhe fakte. Materiali i çdo grupi duhet të mos jetë më i gjatë se 15 rreshta dhe jo më shumë se 2-3 harta dhe 4-5 foto.

**Hapi i tretë: Prezantim**

Grupet zgjedhin përfaqësuesit e tyre që do të punojnë për ndërtimin e stendës "Shqipëria në vitet 1914–1920", me produktet e përzgjedhura të secilit grup. Këshillohet që stenda të përmbajë: harta, foto, dokumente, fakte dhe figura historike.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson punën e çdo grupi, kontributin e secilit anëtar dhe mënyrën e paraqitjes. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | L ë n d a : Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.1:** **Lufta dhe Paqja (1914–1920)**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Armëpushim 20-vjeçar apo paqe?** ***(veprimtari praktike)*** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja rikujton me nxënësit shkaqet, faktorët dhe pasojat e Luftës së Parë Botërore. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>rendit vendimet e Konferencës së Paqes në Paris;<br>krahason 14 pikat e Presidentit amerikan Uillson me vendimet e Konferencës së Paqes;<br>analizon faktorët që sollën nacionalizmin dhe përhapjen e tij në Europë. | | | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Shqipërinë gjatë Luftës I Botërore | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, komunikim | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** Përgatitja për diskutim

Fillimisht, mësuesi/ja përcakton objektivin e parë për diskutim.

1. Nxënësi kupton qartë që periudha 20-vjeçare, megjithëse në dukje e qetë, nuk kishte garanci për paqen europiane, por edhe botërore.

Më pas përcaktohen çështjet për diskutim dhe referuesit e tyre kryesorë:

- Vendimet e Konferencës së Paqes në Paris
- 14 pikat e presidentit amerikan Uillson dhe vendimet e Konferencës: a ka përputhje mes tyre?
- Faktorët që sollën nacionalizimin dhe përhapjen e tij në Europë
- Vendosja e totalitarizmit të Europë

Pas përcaktimit të çështjeve për diskutim dhe referuesit e tyre kryesorë, planifikohet zhvillimi i diskutimit. Rregullohen tavolinat në një formë të përshtatshme.

**Hapi i dytë: Diskutimi nga nxënësit**

Mësuesi/ja për të nisur diskutimin mund të përdorë një bisedë hyrëse, një referim, film, regjistrimet në magnetofon, një evidencë me të dhëna dhe pyetjet nxitëse. Caktohet një nxënës/e të drejtojë diskutimin. Ai/ajo paraqet ecurinë e diskutimit dhe bën të qartë rregullat e diskutimit, sipas të cilave njëri flet, të tjerët dëgjojnë; u jep fjalën referuesve të prezantojnë përmbledhtas çështjen përkatëse; u jep fjalën nxënësve që kërkojnë të diskutojnë; bën përmbledhjen e çështjes që është diskutuar.

Mësuesi/ja duhet të prezantohet si i paanshëm në çështjet që diskutohen. Disa nga pyetjet që bën mësuesi/ja, që ndihmojnë në nxitjen e diskutimit, mund të jenë:

- Si i vlerësoni vendimet e Konferencës së Paqes në Paris?
- Krahasoni programin e presidentit Uillson me vendimet e Konferencës së Paqes në Paris. Si mendoni ju për këtë program dhe për vendimet e Konferencës së Paqes?
- A mendoni se ka lidhje mes vendimeve të Konferencës, pakënaqësive dhe lindjes së nacionalizimit në Europë?
- A jeni dakord apo jo me shprehjen "Paqe e Gabuar" në lidhje me vendimet e Konferencës së Paqes në Paris?
- Sipas mendimit tuaj, në 20 vjetët 1919–1939 ishin një armëpushim apo një periudhë paqeje?

**Hapi i tretë: Prezantim**

Në këtë fazë nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi i diskutimit. Përmblidhen pikat kryesore.

- Renditen faktet e paraqitura.
- Tregohet ç'është realizuar.
- Bëhet vlerësimi i punës.

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve, kontributin e secilit anëtar dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.2:**<br>**Sistemet politike në vitet 1920–1939**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Përmbysja e regjimit carist në Rusi. Vendosja e plotë e regjimit totalitar komunist** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos foto të Car Nikollës, Leninit dhe të Revolucionit të Tetorit u kërkon nxënësve të thonë se çfarë i lidh këto foto. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- përshkruan me fjalët e tekstit përmbysjen e regjimit carist në Rusi;<br>- vë në dukje masat që mori Lenini për vendosjen e pushtetit sovjetik;<br>- analizon kultin e individit dhe të këqijat që sjell ai. | | **Fjalë kyç:**<br>regjim carist, revolucion demokratik, revolucion bolshevik, diktaturë e proletariatit, regjim totalitar | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Revolucionin Rus të vitit 1917 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë parullën "Paqe, bukë, tokë" dhe kërkon nga nxënësit të komentojnë kuptimin e saj me fjalët e tyre. Më pas, ai/ajo shkruan disa terma, si "regjim carist", "revolucion demokratik", "revolucion bolshevik", "diktaturë e proletariatit" dhe shtron pyetjet:

– Çfarë i lidh këta terma?

– Si i kuptoni ju ato?

Në përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja bën plotësimet përkatëse për të kaluar më pas në fazën tjetër të mësimit.

**Hapi i dytë: Punë në dyshe**

Mësuesi/ja përdor teknikën "Punë në dyshe" për ndërtimin e njohurive të reja. Nëpërmjet kësaj teknike, nxënësit ndahen në dyshe dhe lexojnë një nëntemë të tekstit. Me ndihmën e mësuesit/es bëjnë një përmbledhje të shkurtër për pjesën që lexojnë.

*Abdikimi i carit. Vendosja e Republikës*

- Kriza ekonomike dhe humbjet në luftë bënë që të akuzohet Car Nikolla për gjendjen e vështirë dhe të japë dorëheqjen
- Në shkurt 1917 nisi kryengritja kundër regjimit carist, që solli:

- abdikimin e carit;
- krijimin e një qeverie të përkohshme demokratike;
- shpalljen e republikës.

*Qeveria e përkohshme dhe përmbysja e saj. Vendosja e Diktaturës së Proletariatit*

- shpalli lirinë e fjalës, të shtypit, të fesë, të drejtën elektorale;
- vendosi të vazhdojë luftën;
- kjo gjendje u shfrytëzua nga partia bolshevike (komuniste) nën udhëheqjen e Leninit, i cili urdhëroi që në çdo qendër pune të krijoheshin sovjetët (këshilla), që merrnin vendime për probleme;
- u hodhën parullat revolucionare: "Paqe, bukë, tokë", "I gjithë pushteti sovjetëve", "Fabrikat punëtorëve", "Toka fshatarëve" duke hedhur bazat për revolucionin që do të pasonte, në 24-25 tetor në Shën Petërburg;
- Lenini shpalli vendosjen e Diktaturës së Proletariatit dhe formimin e Republikave Socialiste Sovjetike.

*Politika e brendshme dhe e jashtme e regjimit komunist*

- Politika e brendshme:
  - u bë shtetëzimi i industrisë, i minierave, i bankave dhe i tokës;
  - u godit prona private;
  - u krijua ushtria revolucionare;
  - Tri Republika (Ukraina, Bjellorusia, Transkaukazia) u bashkuan me Rusinë duke krijuar kështu Bashkimin Sovjetik;
  - u hartua kushtetuta që e shpalli Bashkimin Sovjetik shtet unik federal.
- Politika e jashtme:
  - u nënshkrua Dekreti i Paqes me gjermanët;
  - Rusia doli nga lufta.

*Vendosja e regjimit totalitar komunist*

- Shteti komunist mbështetej në luftën e klasave dhe në përdorimin e dhunës.
- U krijua policia sekrete, kundërshtarët politikë u shpallën armiq të pushtetit, u vranë, burgosën etj.
- U ndaluan liritë demokratike dhe veprimtaria e partive opozitare.
- U zbatua një politikë që synonte zhdukjen e pronës private plotësisht.
- Bashkimi Sovjetik u shndërrua në një shtet ku zotëronte frika e terrori pas vdekjes së Leninit dhe ardhjes në pushtet të Stalinit.
- U krijua kulti i individit, u vendos terrori me kampet e punës.
- Kultura, letërsia, arti e shkenca u shndërruan në vegla të propagandës komuniste.
- Në politikën e jashtme, Stalini goditi sistemin kapitalist, si formë e dështuar dhe antinjerëzore; vlerësoi sistemin socialist si triumfi i "demokracisë proletare".

**Hapi i tretë**

Për të evidentuar nivelin e nivelin e njohurive të reja që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi, mësuesi/ja bën pyetjet që jepen në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime".

– Çfarë përfaqësonin sovjetët dhe çfarë solli Revolucioni Socialist i Tetorit 1917?
– Cilat ishin masat që mori Lenini për vendosjen e pushtetit sovjetik?
– Si u forcua terrori në periudhën e Stalinit?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një ese të shkurtër për punën e detyruar në kampet e internimit në Shqipëri gjatë regjimit komunist, duke u mbështetur te të dhënat që mund të gjeni në internet.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.2:<br>Sistemet politike në vitet 1920–1939</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja vendos foto të Leninit, Stalinit, Hitlerit dhe Musolinit dhe kërkon nga nxënësit të thonë çfarë kanë të përbashkët ata.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Tiparet e regjimeve totalitare</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- përkufizon termin 'regjim totalitar';<br>- vë në dukje tiparet e përbashkëta të regjimeve totalitare;<br>- krahason regjimet totalitare të majta me ato të djathta.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>regjim totalitar, diktaturë e majtë, diktaturë e djathtë, burokraci</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për regjimet totalitare</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Në këtë hap të organizimit të orës së mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "marrëdhënie pyetje-përgjigje" duke bërë disa pyetje, si:

– Si u vendos regjimi totalitar në Rusi?
– Çfarë masash morën Lenini e Stalini për forcimin e pushtetit të tyre?
– Si shkeleshin të drejtat e njeriut në këtë sistem?
– Ç'kuptoni me kult individi dhe si u krijua ai?

Mësuesi/ja bën plotësimet përkatëse në përgjigjet e nxënësve, duke evidentuar disa tipare të regjimeve totalitare.

**Hapi i dytë: Shpjegim**

Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja nis shpjegimin duke evidentuar thelbin e regjimeve totalitare, ku pushteti është plotësisht në dorën e një partie dhe të udhëheqësit të saj, i cili kontrollon çdo pushtet. Në këtë regjim urdhërohet, dëgjohet e zbatohet. Çdo qëndrim tjetër ndëshkohet. Në Europë u vendosën diktatura e majtë (e kuqe), në Rusi e udhëhequr nga Lenini dhe diktatura e djathtë në Itali (e drejtuar nga Benito Musolini), Gjermani (Hitleri) dhe Spanjë (nga Gjenerali Franko).

Shkaqet:

➔ pakënaqësia, e shkaktuar nga vendimet e Konferencës së Paqes, nxiti te shoqëria gjermane e italiane nacionalizmin e skajshëm;
➔ prapambetja e shoqërisë ruse dhe dobësia e qeverisë cariste ushqyen lëvizjen komuniste.

Mësuesi/ja shtron pyetjet:

– Pse paqja e vendosur në Konferencën e Paqes u quajt e gabuar dhe ndëshkuese? Ku gaboi qeveria e përkohshme demokratike në Rusi?

*Tiparet e përbashkëta të regjimeve totalitare*

➔ Natyra demagogjike kontradiktore: propagandojnë demokracinë me fjalë dhe e mohojnë në praktikë;
➔ Goditja e demokracisë: mohojnë liritë demokratike, kontrollojnë çdo gjë;
➔ Përdorimi i dhunës: kundërshtarët goditen me ashpërsi, shoqëria detyrohet të bindet me anë të burgjeve, internimeve, frikës etj.

➔ Nxitja e burokracisë: krijohet një administratë e madhe "servile", që gëzon privilegje dhe i shërben regjimit, jo qytetarit;
➔ Kulti i individit: u thurin lavdi udhëheqësve të tyre, si i jashtëzakonshëm, të pagabueshëm;
➔ Mbivlerësimi i propagandës: përdoret arti, shkenca, shtypi etj., për të zbukuruar regjimin;
➔ Agresiviteti: regjimet përpiqen që të shtrihen edhe jashtë shtetit të tyre, me anë të formave të ndryshme, si: krijimi i partive komuniste, fashiste etj.

*Veçori dalluese të regjimeve totalitare:*

➔ Diktatura e majtë erdhi nëpërmjet revolucionit (lëvizja komuniste), e djathta nëpërmjet kompromisit (nacionalizmi i skajshëm);
➔ E djathta e ruajti regjimin kapitalist, që mbështetej në pronën, e majta punoi për ndërtimin e një regjimi të ri socialist e komunist, që mbështetej në pronën shtetërore dhe ekonominë e centralizuar.

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Pyetjet që jepen në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime" dhe teksti "Thelloni njohuritë" përmblidhen dhe përdoren për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi.

– Cilat janë tiparet e përbashkëta dhe veçoritë dalluese të regjimeve totalitare të majta e të djathta, që u vendosën në Europë?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hulumto të dhëna në libra, internet apo nga prindërit për veçoritë e regjimit totalitar në vendin tonë.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.2:**<br>**Sistemet politike në vitet 1920–1939**<br>**Tema mësimore:**<br>**Italia gjatë viteve 1918–1939. Vendosja e fashizmit** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos foto të Musolinit dhe kërkon nga nxënësit të thonë çfarë dinë apo kanë dëgjuar për të. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>□ përshkruan me fjalët e tekstit situatën e Italisë pas Luftës I Botërore;<br>□ analizon programin e Partisë Fashiste;<br>□ evidenton masat që mori Musolini për forcimin e pushtetit të tij. | | **Fjalë kyç:**<br>fashizëm, parti fashiste, diktaturë fashiste, skuadristë | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Italinë e pasluftës | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut, arte | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja përdor teknikën "stuhi mendimesh" në këtë hap të organizimit të orës së mësimit, duke bërë disa pyetje, si:

– Ç'është regjimi totalitar?
– Cilat janë disa nga tiparet e përbashkëta dhe dalluese të tyre?
– Çfarë regjimi u vendos në Itali pas Luftës I Botërore?
– Kush e mori pushtetin në Italinë e pasluftës?
Mësuesi/ja bën plotësimet përkatëse në përgjigjet e nxënësve.

**Hapi i dytë: Ditari dypjesësh**
Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja përdor teknikën "ditari dypjesësh".

| Çështja | **Komenti** |
|---|---|
| Vitet e para pas Luftës. Partia Fashiste dhe programi i saj | ➢ Italia kaloi një krizë të thellë ekonomike pas Luftës<br>➢ Rindërtimi i vendit ecte ngadalë, kishte varfëri e papunësi<br>➢ Punëtorët pushtuan fabrikat dhe fshatarët tokat e pronarëve<br>➢ Qeveria ishte e paaftë për të zgjidhur krizën<br>➢ Ekzistonte anarkia në të gjithë vendin.<br>➢ Më 1919 u formua Partia Fashiste e Musolinit, që premtonte:<br>o vendosjen e rregullit, sigurisë, mirëqenies;<br>o rikthimin e lavdisë së Romës së lashtë;<br>o zhdukjen e "rrezikut të kuq". |
| Vendosja e diktaturës fashiste | ➢ Më 28.10.1922 Partia Fashiste pushtoi ndërtesat qeveritare me një ushtri prej 40 000 skuadristë.<br>➢ Mbreti Viktor Emanueli III bëri kompromis; u krijua qeveria e koalicionit nën drejtimin e Duçes.<br>➢ Në vitin 1925 Musolini prishi koalicionin; krijoi një qeveri krejtësisht fashiste duke vendosur kështu diktaturën |
| Forcimi i diktaturës fashiste edhe veprimtaria agresive e saj | ➢ Musolini forcoi pushtetin personal e të partisë së tij duke marrë këto masa:<br>o krijoi institucione të reja fashiste; u formua Këshilli i Lartë Fashist; u krijua policia sekrete; u formua një gjykatë e veçantë; u rivendos dënimi me vdekje;<br>o u ndaluan veprimtaritë e të gjitha partive e sindikatave jofashiste; u mohuan liritë demokratike;<br>o shkolla u vu në shërbim të regjimit fashist; në to u krijuan organizata fashiste;<br>o iu dha shumë rëndësi propagandës fashiste, shtypi, radioja, arti e kultura u vunë në shërbim të fashizmit.<br>➢ Diktatura fashiste u tregua agresive në politikën e jashtme:<br>o mori nga Jugosllavia Rjekën;<br>o pushtoi Etiopinë në Afrikë;<br>o dërgoi trupa në Spanjë për të përkrahur gjeneralin Franko;<br>o u lidh me Gjermaninë dhe pushtoi Shqipërinë më 7 prill 1939. |

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**
Mësuesi/ja bën një përmbledhje dhe shtron disa nga pyetjet që jepen në rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime" për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi. Për të nxitur diskutime në klasë, mësuesi/ja pyet nxënësit:
– Pse diktatura fashiste qe sundim antidemokratik?
– Pse kulti i Duçes nuk ndryshonte nga kulti i individit në Rusi dhe vende të tjera?

## ► Vlerësimi
Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur
Hulumto të dhëna në libra dhe në internet për veçoritë e regjimit totalitar në Italinë e periudhës së Duçes.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.2:**<br>**Sistemet politike në vitet 1920–1939** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos foto të Hitlerit dhe kërkon nga nxënësit të thonë çfarë dinë apo kanë dëgjuar për të. | |
| **Tema mësimore:**<br>**Gjermania republikane dhe ardhja në pushtet e Hitlerit** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- përshkruan me fjalët e tekstit mënyrën e ardhjes në pushtet të Hitlerit;<br>- vë në dukje masat që mori Hitleri për vendosjen e diktaturës naziste;<br>- analizon politikën agresive naziste. | | **Fjalë kyç:**<br>Republika e Vajmarit, diktaturë naziste, antisemitizëm, nazizëm | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Gjermaninë e periudhës në fjalë | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut, arte | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja vendos një foto të Hitlerit dhe pyet nxënësit për diktatorin e Gjermanisë. Për të kanalizuar diskutimet, ai/ajo drejton disa pyetje:

– Ç'dini për figurën e Hitlerit në Gjermani?
– Çfarë diktature u vendos në kohën e Hitlerit në Gjermani?
– Ç'lloj diktature ishte ajo e Hitlerit: e majtë apo e djathtë?

Pasi dëgjon përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja bën një përmbledhje të shkurtër të tyre.

**Hapi i dytë: Kllaster**

Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja përdor teknikën "kllaster". Në këtë pjesë, ai/ajo e ndan tekstin në tri pjesë:

1. *Republika e Vajmarit. Ardhja e Hitlerit* në pushtet



2. *Vendosja e diktaturës naziste*

Me marrjen e pushtetit, Hitleri:

- krijoi një shtet totalitar;
- përqendroi në duart e tij të gjithë pushtetin nëpërmjet reparteve të mbrojtjes (SS) dhe Gestapos (policia sekrete);
- eliminoi kundërshtarët politikë;
- u ndalua veprimtaria e lirë e partive politike dhe e sindikatave;
- u vunë nën kontrollin nazist: shkollat, shtypi, radiot etj.;
- ekonomia gjermane iu nënshtrua plotësisht politikës hitleriane militariste.
- Ishte racist:
  - i quante hebrenjtë dhe sllavët "një racë e ulët" (inferiore), gjermanët "racë e pastër" ariane dhe e lartë (superiore);
  - hebrenjtë u veçuan nga populli, u detyruan të punonin si skllevër, u burgosën, u internuan në kampe përqendrimi, u shfarosën në krematoriume.

3. *Politika agresive naziste*

| **Drejtimet** | **kryesore** | **të politikës** | **u ndoqën këto rrugë:** |
| --- | --- | --- | --- |
| - të hidheshin poshtë vendimet e Konferencës së Paqes; | - të bashkonte me Gjermaninë territoret që banoheshin nga gjermanët dhe gjendeshin jashtë kufijve të shtetit gjerman; | - t'i siguronte racës gjermane drejtimin e Europës dhe të Botës. | - doli nga Lidhja e Kombeve;<br>- dërgoi forca ushtarake në Spanjë për Frankon;<br>- pushtoi zonën e Renit, bashkoi Austrinë me Gjermaninë dhe pushtoi Çekosllovakinë;<br>- krijoi aleancën me Italinë dhe Japoninë;<br>- nënshkroi Paktin e Mossulmimit (1939) me Bashkimin Sovjetik. |

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Rubrika "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime" përdoret nga mësuesi/ja për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi. Për të nxitur diskutime në klasë, mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera, që i ka hartuar paraprakisht:

– Si arrijnë regjimet totalitare të ngrenë masën e popullit në përkrahje të politikës së tyre agresive?
– Cilat janë ngjashmëritë mes nazizmit dhe fashizmit?
– Pse Gjermania nënshkroi Paktin e Mossulmimit me Bashkimin Sovjetik?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hulumto dhe zbulo të dhëna për veprimtarinë antisemite të nazizmit.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.2:**<br>**Sistemet politike në vitet 1920–1939** | | **Situata e të nxënit:**<br>Në tabelë vendoset një hartë e madhe e Shteteve të Bashkuara dhe nxënësit pyeten të thonë çfarë roli luajti ShBA-ja gjatë Luftës I Botërore. | |
| **Tema mësimore:**<br>**SHBA-ja në vitet 1920–1939** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon me fjalët e tekstit ardhjen në pushtet të republikanëve;<br>- evidenton politikën e brendshme dhe të jashtme të republikanëve;<br>- analizon Kursin e Ri të Ruzveltit si një program i qartë reformash. | | **Fjalë kyç:**<br>Kriza e Madhe Ekonomike, parime demokratike, Kursi i Ri i Ruzveltit, neutralitet | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë viteve 1920–1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja ka vendosur hartën e ShBA-së në tabelë dhe u drejton disa pyetje nxënësve, për të risjellë në mendjen e tyre njohuritë që kanë për ShBA-në dhe rolin e saj gjatë Luftës I Botërore:

– Çfarë roli luajti ShBA-ja në Luftën e Parë Botërore?
– Si ndikoi hyrja në luftë e ShBA-së në krah të Antantës?
– Cili ishte ndikimi i ShBA-së dhe i presidentit Uillson në krijimin e Lidhjes së Kombeve?

Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve dhe bën plotësimet përkatëse, duke evidentuar rolin kryesor të Shteteve të Bashkuara në drejtimin që mori Lufta I Botërore dhe në përfundimin e saj.

**Hapi i dytë: Lexim i orientuar**

Në fazën e dytë të mësimit mësuesi/ja përdor teknikën "lexim i orientuar" për ndërtimin e njohurive të reja. Ai/ajo orienton nxënësit të lexojnë tekstin, duke dhënë edhe nëntemat nëpërmjet të cilave parashikojnë atë që do të mësojnë

1. *Dështimi i demokratëve dhe ardhja në pushtet e republikanëve*
   - Partia Demokrate me president Uillsonin drejtonin ShBA-në.
   - Amerikanët ishin të pakënaqur nga politika e jashtme e pasuksesshme e Uillsonit.
   - Uillsoni u paraqit me programin prej 14 pikash në Konferencën e Paqes, që do ta shndërronte ShBA-në në lider të botës.
   - Dëmet e Luftës për shoqërinë amerikane dhe mossuksesi i Uillsonit dobësuan pozitat e Partisë Demokratike në SHBA.
   - Në zgjedhjet presidenciale të vitit 1920 fituan republikanët, me president Uoren Harding.

2. *Politika e brendshme dhe e jashtme e republikanëve.*

3. *Ardhja në pushtet e demokratëve*
   - Franklin Ruzvelt i Partisë Demokratike fitoi zgjedhjet e vitit 1932.
   - E drejtoi vendin gjatë periudhës 1932–1945.
   - Hartoi një program të qartë reformash për të nxjerrë vendin nga kriza.

- Programi "Kursi i Ri" i Ruzveltit synonte kapërcimin e krizës dhe krijimin e shtetit të mirëqenies sociale.
- Shteti do të plotësonte të gjitha nevojat e domosdoshme të shoqërisë.

**Politika e brendshme e republikanëve**

- 1920–1929, periudhë që njihet si "mrekullia amerikane"
  - pasojë e përfitimeve që SHBA-ja nxori gjatë Luftës së Parë Botërore
  - SHBA-ja e drejtoi vëmendjen kryesisht te problemet e brendshme
  - U vendosën taksa të larta doganore për mallrat e importit; u nxit shumë prodhimi vendas.
  - Dollari u bë monedha më me vlerë
  - SHBA-ja me pozitë neutrale ndaj problemeve të Europës dhe ruajtjen e ekuilibrit mes shteteve europiane.
- 1929–1933, periudha e krizës, e njohur si Depresioni i Madh
  - pasojë e përfitimeve që SHBA-ja nxori gjatë Luftës së Parë Botërore
  - SHBA-ja e drejtoi vëmendjen kryesisht te problemet e brendshme
  - U vendosën taksa të larta doganore për mallrat e importit; u nxit shumë prodhimi vendas.
  - Dollari u bë monedha më me vlerë
  - SHBA-ja me pozitë neutrale ndaj problemeve të Europës dhe ruajtjen e ekuilibrit mes shteteve europiane.

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit, në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera që i ka hartuar paraprakisht për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:

– Si e kuptonin thënien: "SHBA-ja, zotëruese e tregut financiar në botë"?
– Interpretoni parullat "Të fitojmë e të konsumojmë" (punëtori nuk vlerësohet vetëm si prodhues, por edhe si konsumator) dhe "Amerika e amerikanëve".

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Kërko në internet ose në libra të dhëna për Kursin e Ri të Ruzveltit.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.2:**<br>**Sistemet politike në vitet 1920–1939**<br>**Tema mësimore:**<br>**Britania e Madhe në vitet 1920–1939** | | **Situata e të nxënit:**<br>Në tabelë vendoset një hartë e madhe e Britanisë së Madhe dhe nxënësit pyeten të thonë çfarë roli luajti ky shtet gjatë Luftës I Botërore. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston tri fazat e ekonomisë së Britanisë së Madhe gjatë periudhës 1918–1939;<br>- përshkruan jetën politike të Britanisë pas Luftës I Botërore;<br>- analizon politikën e jashtme të Britanisë. | | **Fjalë kyç:**<br>Kriza e Madhe Ekonomike, parime demokratike, Kursi i Ri i Ruzveltit, neutralitet | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Britaninë e Madhe gjatë viteve 1920–1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut, | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja vendos hartën e Britanisë në tabelë dhe u drejton disa pyetje nxënësve për të risjellë në mendjen e tyre njohuritë që kanë për këtë shtet dhe rolin e tij gjatë Luftës I Botërore

– Çfarë roli luajti Britania e Madhe në Luftën e Parë Botërore?

– Në cilin koalicion bënte pjesë ajo dhe si përfundoi lufta për të?

Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve dhe bën plotësimet përkatëse, duke evidentuar rolin e Britanisë në koalicionin e Antantës dhe në Luftën I Botërore.

**Hapi i dytë: Të nxënit në bashkëpunim**

Duke orientuar nxënësit të lexojnë tekstin për disa minuta, mësuesi/ja nis ndërtimin e njohurive të reja nëpërmjet teknikës "të nxënit në bashkëpunim". Gjatë kohës që nxënësit lexojnë tekstin, ai/ajo shkruan në tabelë "Ekonomia e Britanisë së Madhe pas Luftës" dhe ndan tabelën në tri kolona. Së bashku me nxënësit, ai/ajo evidenton se ekonomia e Britanisë kaloi në tri faza gjatë periudhës 1918-1933 dhe shkruan pikat kryesore të secilës fazë.

| *Faza e parë (1918-1923)* | *Faza e dytë (1923-1929)* | *Faza e tretë (1929-1933)* |
|---|---|---|
| ➢ Eksporti u godit nga konkurrenca e ShBA-së dhe ajo japoneze.<br>➢ Ra vlera e sterlinës angleze.<br>➢ Shumë miniera dhe uzina u mbyllën.<br>➢ U rrit papunësia (mbi 20 milionë të papunë) dhe kushtet e jetesës u vështirësuan. | ➢ Ishte periudha e lulëzimit për tri arsye:<br>o energjia elektrike zëvendësoi qymyrgurin;<br>o përparimi me të rejat e shkencës dhe të teknologjisë;<br>o produktet filluan të shiten më shumë në tregun e brendshëm, sesa të eksportoheshin. | ➢ Forcat politike bashkëpunuan.<br>➢ Shteti ndërhyri në ekonomi<br>➢ U dhanë kredi lehtësuese për gjallërimin e industrisë dhe bujqësisë. |

Më pas kalohet në nëntemën e dytë, ku mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskutojnë:

*Jeta politike:*

➢ karakterizohej nga qëndrueshmëria politike;

➢ ndikimi i Revolucionit Rus ishte i dobët; pa parti të fortë komuniste;

➢ institucionet parlamentare u forcuan;

- Më 1918 u vendos e drejta elektorale e përgjithshme për meshkujt; për gratë më 1928;
- Mbretëri kushtetuese: pushteti i mbretit kufizohej nga Kushtetuta;
- qeverisnin dy partitë kryesore: Partia Konservatore dhe Partia Laburiste.
- Më 1931, partitë krijuan Qeverinë Kombëtare (qeveri koalicioni) për të përballuar krizën:
  - vendosi kontrollin e saj në jetën ekonomike;
  - ndihmoi me kredi uzinat, fabrikat, bankat dhe i ringjalli ato;
  - krijoi Këshillin e Asistencës për papunësinë.

Në nëntemën e tretë, mësuesi/ja shkruan në tabelë "politika e jashtme" dhe së bashku me nxënësit evidenton se *Politika e jashtme:*

- ishte e matur, e kujdesshme dhe me pikësynime të qarta;
- punonte për ruajtjen e ekuilibrit (baraspesha dhe paqja) mes shteteve, si Franca, Gjermania, Italia;
- pengonte zgjerimin e komunizmit në Perëndim;
- ishte tolerante ndaj politikës agresive së diktaturave të djathta, si pengesë ndaj komunizmit;
- më 1931 krijoi Komunuelthin (Bashkimi Britanik i Kombeve), ku bënin pjesë 7 shtete;
- njohu Republikën e Irlandës (e besimit katolik), por mbajti pjesën verilindore, Olsteri, (apo Irlanda e Veriut e besimit protestant.

**Hapi i tretë: Lexim i drejtuar**
Një nxënës lexon pjesën "Thelloni njohuritë", ku jepen fakte për zhvillimin ekonomik të Britanisë. Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera që i ka hartuar paraprakisht, për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:
– A ishte realiste politika e jashtme e Anglisë?
– Si e shpjegon qëndrimin e Mbretërisë së Bashkuar ndaj diktaturave të djathta e të majta?

## ► Vlerësimi
Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur
Hulumto dhe gjej të dhëna për marrëdhëniet e Mbretërisë së Bashkuar me Irlandën e Veriut.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.2:**<br>**Sistemet politike në vitet 1920–1939**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Franca në vitet 1920-1939** | | **Situata e të nxënit:**<br>Në tabelë vendoset një hartë e madhe e Francës dhe nxënësit pyeten për rolin e saj gjatë Luftës I Botërore. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- shpjegon gjendjen ekonomike të Francës pas Luftës së Parë Botërore;<br>- rendit karakteristikat e jetës politike në Francë;<br>- argumenton politikën e jashtme të Francës në këtë periudhë. | | **Fjalë kyç:**<br>republikë, pushtet legjislativ, jetë politike e paqëndrueshme | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Francën gjatë periudhës 1920–1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja ka vendosur hartën e Francës në tabelë dhe u drejton disa pyetje nxënësve, për të risjellë në kujtesë njohuritë që kanë për këtë shtet dhe rolin e tij gjatë Luftës I Botërore
– Çfarë roli luajti Franca në Luftën e Parë Botërore?
– Çfarë masash mori ky vend për t'u mbrojtur nga pushtimi gjerman?
– Në cilin koalicion bënte pjesë ajo dhe si përfundoi lufta për të?
Mësuesi/ja dëgjon përgjigjet e nxënësve dhe bën plotësimet përkatëse, duke evidentuar rolin e Francës në koalicionin e Antantës dhe në Luftën I Botërore.

**Hapi i dytë: Ditari dypjesësh**

Për ndërtimin e njohurive në këtë orë mësimi, mësuesi/ja përdor teknikën "ditari dypjesësh"

| Çështja | Komenti |
|---|---|
| ➢ Ekonomia franceze | ◆ Tre ishin faktorët kryesorë ndihmuan Francën për të kapërcyer pasojat e krizës gjatë viteve të para të pasluftës dhe gjallëruan ekonominë e saj:<br>1. ndihma financiare e SHBA-së;<br>2. pagesat vjetore që merrte Franca si dëmshpërblim nga vendet që humbën Luftën;<br>3. marrja e Alsas-Lorenës, dy zona të pasura me hekur e qymyr, nga Konferenca e Paqes.<br>◆ Kriza botërore e viteve 1929–1933 e preku edhe ekonominë e Francës, por nuk solli pasoja të rënda si në vende të tjera. |
| ➢ Karakteristikat e jetës politike | ◆ Franca ishte shtet republikan.<br>◆ Pushteti legjislativ i përbërë nga dy dhoma: Senati dhe Dhoma e Deputetëve, të cilat zgjidhnin presidentin për 7 vjet.<br>◆ Jeta politike e paqëndrueshme, qeveritë ndërroheshin shpesh. Ekzistonin shumë parti që përfaqësonin dy krahët e politikës.<br>◆ Asnjëra parti nuk gëzonte një përkrahje të madhe, krijoheshin aleanca e koalicione ndërpartiake.<br>◆ Partitë e djathta formuan aleancën Bashkimi Kombëtar, me qëndrim të qartë antisocialist, partitë e majta formuan Frontin Popullor.<br>◆ Lindën dhe organizatat fashiste e komuniste, që shkaktonin turbullira me protesta e manifestime.<br>◆ Franca u përball me mjaft vështirësi; rendi demokratik nuk u trondit e nuk u vu asnjëherë në rrezik.<br>◆ Më 1936 fitoi Fronti Popullor (fronti i majtë) me Leon Blumin, që dha dorëheqjen më 1938 pas akuzave të forcave të djathta, se me reformat e tij po sillte komunizmin në Francë.<br>◆ Në pushtet erdhi Bashkimi Kombëtar me Puankaren. |
| ➢ Politika e jashtme | ◆ përpiqej të ruante dhe zbatonte Vendimet e Versajës;<br>◆ bëri aleancë me shtetet që lindën nga kjo marrëveshje, si: Belgjika, Polonia, etj. Kjo aleancë njihet në histori si Antanta e Vogël;<br>◆ përpiqej të forconte pozitën e vet në Europë. |

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera, që i ka hartuar paraprakisht për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:

– Çfarë kanë të përbashkët Franca dhe Britania e Madhe të periudhës 1920–1939?
– Blumi dha dorëheqjen në vitin 1938. Si e vlerëson veprimin e tij?
– Stabiliteti politik i Europës pas Lufte ishte i qëndrueshëm apo i përkohshëm? Argumento mendimin tënd.

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hulumto dhe gjej të dhëna për Francën e periudhës pas Luftës së Parë Botërore.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.3:**<br>**Ekonomia në vitet 1920–1939**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Ekonomia në vendet totalitare në periudhën mes dy Luftërave** | | **Situata e të nxënit:**<br>Në tabelë vendoset një hartë e madhe e Europës, ku evidentohen shtetet me sistem demokratik dhe ato me diktaturë. Nxënësit tregojnë në hartë dhe flasin për to. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston strukturat shtetërore që u vendosën në Europë;<br>- përshkruan zhvillimin e ekonomisë në shtetet totalitare nazifashiste;<br>- analizon të përbashkëtat mes ekonomive totalitariste nazifashiste dhe komuniste. | | **Fjalë kyç:**<br>ekonomi e centralizuar, sistem korporativist, ekonomi socialiste | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për ekonominë e vendeve të Europës gjatë periudhës 1920–1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja vendos hartën e Europës të periudhës midis dy Luftërave Botërore, ku evidentohet ndarja e vendeve me regjime demokratike dhe ato regjime diktatoriale nazifashiste dhe komuniste. Ai/ajo pyet nxënësit në lidhje me këto vende:
– Cilat shtete kishin qeveri demokratike?
– Në cilat shtete u vendosën regjime diktatoriale?
– Si arritën regjimet diktatoriale të sundonin në këto vende?
– Pse në disa vende partitë ekstreme arritën të vinin në pushtet?
Pasi dëgjon përgjigjet e nxënësve, mësuesi/ja bën një përmbledhje të shkurtër të diktaturave të majta e të djathta që u vendosën në Europë.

**Hapi i dytë: Lexim i drejtuar**

Në fillim, mësuesi/ja shkruan në tabelë "Jeta politike e Europës pas Luftës I Botërore". Duke iu referuar hartës së Europës, ai/ajo e ndan tabelën në katër kolona ku shkruan:

| *Demokraci liberale* | *Diktatura nazifashiste* | *Pushtet autoritarist* | *Regjim totalitar komunist* |
|---|---|---|---|
| Britania e Madhe, Franca, Vendet Skandinave etj. | Gjermania e Italia | Polonia, shtetet ballka- nike në Europën Lindore | Bashkimi Sovjetik |

Më pas, mësuesi/ja shkruan në tabelë "Zhvillimi i ekonomisë në shtetet totalitariste nazifashiste". Ai/ajo evidenton karakteristikat e përbashkëta të ekonomisë në këto shtete, si:

- shteti luante rol kryesor në drejtimin e ekonomisë;
- kishin forma të njëjta në organizimin e ekonomisë;
- ekonomitë e tyre mbështeteshin në sistemin "korporativist";
- ekonomia e tyre kishte drejtim militarist;
- bënin investime të mëdha në objektet publike, të cilat shoqëroheshin me një propagandë të fuqishme;
- ruajtën pronën private;
- mbështetën dhe përkrahën zhvillimin e shkencës, teknikës dhe teknologjisë, për t'i përdorur arritjet e tyre në shërbim të modernizimit të ushtrisë.

Në këtë pikë, mësuesi/ja u thotë nxënësve se *Ekonomia në Italinë fashiste* ecte me plan për zhvillimin e saj. U bënë investime për ndërtime rrugësh, urash, hekurudhash, për tharje kënetash, për sistemim fushash etj., duke ulur kështu numrin e të papunëve. Këtu mësuesi/ja i referohet hartës 'Ekonomia italiane në vitet '20-'30'. Edhe në *Ekonominë* në Gjermaninë naziste u kushtohej një vëmendje e veçantë investimeve. U ndërtuan rrugë, hekurudha, porte e aeroporte dhe u modernizua ushtria. Këtu mësuesi/ja i referohet edhe hartës ekonomike të Gjermanisë naziste, duke treguar qytetet me industri, hekurudha etj.

Më pas, mësuesi/ja tregon në hartë Bashkimin Sovjetik, duke thënë se ekonomia në Rusinë sovjetike pësoi ndryshime të thella. U godit ekonomia kapitaliste e trashëguar, që mbështetej në pronën private dhe u krijua një model i ri ekonomik: *ekonomia socialiste*. Themeli i kësaj ekonomie ishte prona publike (pronë e shoqërisë), që administrohej nga shteti e që u krijua duke zhdukur dhe shndërruar pronën private. Nëpërmjet përdorimit të dhunës u ndoqën dy rrugë për krijimin e ekonomisë:

1. kolektivizimi në bujqësi;
2. shtetëzimi në industri.

Ekonomia drejtohej nga shteti nëpërmjet planeve 5-vjeçare, që përcaktonin objektivat e ekonomisë. BRSS-ja përpiqej t'i tregonte botës se ishte shteti që përcaktonte prodhimin, cilësinë dhe çmimin, dhe jo "loja" e tregut kërkesë-ofertë, si në vendet kapitaliste. Në fshat u krijuan ekonomi të mëdha bujqësore: kolkozet dhe sovkozet, ku fshatarët punonin tokën, por nuk ishin pronarë të saj. BRSS-ja i kushtoi vëmendje të veçantë industrisë, veçanërisht industrisë së rëndë, ndaj së cilës bëri investime kolosale, për të konkurruar me ekonominë kapitaliste të vendeve demokratike dhe për t'i treguar botës modelin e jetës së re sovjetike.

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera, që i ka hartuar paraprakisht për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:

– Pse investimet publike në vendet totalitare shoqëroheshin me propagandë të madhe?
– Si e kuptoni termin "militarizëm ekonomik"?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Vizatoni një hartë të Europës së periudhës midis dy luftërave, duke evidentuar shtetet me regjime demokratike, nazifashiste dhe komuniste.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.3:<br>Ekonomia në vitet 1920–1939<br><br>Tema mësimore:<br>Ekonomia në vendet e demokracisë në vitet 1920–1939</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Në tabelë vendoset një hartë e madhe e Europës dhe e ShBA-së dhe pyeten nxënësit për rolin e këtyre shteteve në Luftën I Botërore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- liston veçoritë e tregut botëror;<br>- shtjellon zhvillimin ekonomik në ShBA gjatë kësaj periudhe;<br>- analizon të përbashkëtat mes ekonomisë angleze dhe asaj franceze.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>treg botëror, politikë proteksioniste, liberalizim</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për ekonominë e ShBA-së, Britanisë dhe Francës gjatë periudhës 1920–1939.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja vendos hartën e Europës dhe ShBA-së dhe u kërkon nxënësve të flasin për rolin e këtyre vendeve në Luftën e Parë Botërore. Për të kanalizuar diskutimet dhe përgjigjet e nxënësve, ajo shtron disa pyetje, si:

– Në cilin koalicion bënin pjesë këto shtete dhe si dolën ato nga lufta?
– Çfarë regjimesh qeverisjeje patën këto shtete?
– Pse në këto shtete nuk u vendosën diktatura?

Mësuesi/ja bën plotësimet përkatëse dhe së bashku me nxënësit bëjnë një përmbledhje të rolit të këtyre vendeve në Luftën e Parë Botërore dhe format e qeverisjes që kishin ato gjatë kësaj periudhe.

**Hapi i dytë: Përvijimi i të menduarit**

Në fillim, mësuesi/ja shkruan në tabelë "Tregu botëror dhe veçoritë e tij". Ai/ajo përdor teknikën "përvijimi i të menduarit" për ndërtimin e njohurive të reja. Klasa ndahet në disa grupe dhe secili grup lexon një nëntemë të tekstit dhe diskuton atë që kanë lexuar.



Më pas, mësuesi/ja duke treguar hartën e SHBA-së pyet nxënësit pse ekonomia amerikane nuk u dëmtua gjatë Luftës I Botërore. Ata përgjigjen duke thënë se lufta nuk u zhvillua në territorin e saj dhe se nga lufta doli shtet fitues, fuqi dominuese industriale, me një ekonomi të fortë.

**Ekonomia u mbështet në:**

- politika proteksioniste (mbronte prodhimin vendas nga mallrat e huaja)
- Në vitet '30 lindën kompanitë e mëdha, korporatat e trustet që drejtonin industrinë dhe ekonominë bujqësore; u mekanizua ekonomia; rritja e vlerës së dollarit
- politika liberale në zhvillimin e brendshëm ekonomik (mosndërhyrjen e shtetit në tregun ekonomik dhe në krijimin e kushteve për funksionimin e tregut të lirë sipas kërkesës dhe ofertës)

Duke vendosur hartën e Europës në tabelë, mësuesi/ja kalon në pjesën e tretë dhe evidenton dy shtetet kryesore fituese europiane: Britania dhe Franca.

| **Franca** | **Britania** |
|---|---|
| ➢ u realizua rindërtimi i menjëhershëm i ekonomisë;<br>➢ u kthyen në Francë kapitalet që ishin investuar jashtë saj;<br>➢ falë punës së madhe të popullit francez dhe kthimit të dy territoreve të pasura;<br>➢ shteti francez realizoi reforma sociale. | ➢ nuk pati ritmet e zhvillimit të ekonomisë franceze.<br>➢ ndikonte shumë aristokracia dhe zhvillimi i ekonomisë mbështetej në traditën e trashëguar;<br>➢ nuk përqafuan frymën e re që shtronte koha<br>➢ projektet e industrialistëve nuk merreshin shumë në konsideratë. |

| **Të përbashkëta e këtyre dy ekonomive** |
|---|
| ➢ Depresioni i Madh nuk e goditi me ashpërsi ekonominë franceze dhe angleze.<br>➢ Këto shtete ishin perandori koloniale.<br>➢ Kishin mundësi të shkëmbenin mallra dhe lëndë të para, gjë që i zbuste pasojat e krizës.<br>➢ Ekonomia në të dyja këto vende mori drejtim militarist.<br>➢ Shoqëria franceze dhe ajo angleze rritën nivelin e jetesës, edhe pse ky nivel ishte larg atij amerikan. |

**Hapi i tretë (diskutim)**

Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera, që i ka hartuar paraprakisht për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:

– Cilat ishin faktorët pengues dhe favorizues të ekonomisë angleze?
– Si lidhen vendimet e Konferencës së Paqes me zhvillimin e ekonomisë franceze?
– Cilat janë të përbashkëtat në ekonomi midis demokracive perëndimore europiane dhe asaj amerikane në periudhën 1935–1939?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Vëzhgo tablonë "Modeli amerikan i jetës" (f. 41) dhe bëj një ese duke u ndalur në karakterin kontradiktor të saj.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.3:**<br>**Ekonomia në vitet 1920–1939**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Kriza e Madhe ekonomike e viteve 1929–1933.**<br>**Politikat e daljes nga kriza (SHBA, Britani, Francë)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Në tabelë vendoset një foto e madhe/ poster i një radhe të gjatë me të papunë apo mensë sociale në ShBA ose Britani/Francë. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston shkaqet e krizës në ShBA, Britani dhe Francë;<br>- përshkruan format e daljes nga kriza të Anglisë dhe Francës;<br>- vlerëson rolin e shtetit në eliminimin e krizës në SHBA. | | **Fjalë kyç:**<br>Depresioni i Madh, Kursi i Ri i Ruzveltit, shteti i mirëqenies sociale, reforma sociale | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për ekonominë e ShBA-së, Britanisë dhe Francës gjatë periudhës 1920-1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, të drejtat e njeriut, ekonomi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja vendos hartën e Europës dhe SHBA-së dhe u kërkon nxënësve të flasin për zhvillimin ekonomik të këtyre dy kontinenteve. Për të përforcuar dhe risjellë në kujtesë njohuritë e mëparshme për ShBA-në dhe vendet kryesore të Europës, mësuesi/ja bën pyetje, si:

– Pse ShBA patën një zhvillim të madh ekonomik? Si u arrit ky zhvillim?
– Si ndikuan vendimet e Konferencës së Paqes në zhvillimin ekonomik në Francë?
– Pse zhvillimi ekonomik në Britani nuk kishte ritmin e atij në Francë?

Mësuesi/ja bën plotësimet përkatëse dhe së bashku me nxënësit bëjnë një përmbledhje të zhvillimit ekonomik të ShBA-së, Britanisë dhe Francës.

**Hapi i dytë: Pema e mendjes**

Pasi ka bërë një përmbledhje të përgjigjeve të nxënësve, mësuesi/ja shton se ky zhvillim pati edhe ndërprerje. Këtu ai/ajo ndërton një tabelë të madhe dhe shkruan:

| | |
|---|---|
| Kriza dhe shkaqet e saj | ➢ filloi në SHBA e më pas u përhap në Europë;<br>➢ u shfaq në bujqësi, pastaj në degët e tjera të ekonomisë;<br>➢ ra fuqia blerëse; u krijua mbiprodhimi; u mbyllën shumë ferma, fabrika etj.; u rrit papunësia;<br>➢ ra vlera e dollarit; u rritën çmimet. |

**Dy qëndrime ndaj krizës**

- Partia Republikane në pushtet: shteti nuk duhet të ndërhynte në jetën ekonomike dhe kriza do të zhdukej vetvetiu
- Partia Demokratike në opozitë kërkonte ndërhyrjen e menjëhershme të shtetit, për të kapërcyer krizën.

*Kursi i Ri i Ruzveltit:*

➔ ulja e papunësisë

- shteti bëri investime për nevoja publike: u ndërtuan autostrada, hekurudha e ndërtesa banimi; u pyllëzuan dhe u sistemuan territore bujqësore,
- u hapën shumë vende pune dhe u ul ndjeshëm papunësia.

➔ ringjallja e ekonomisë

- Shteti bleu mallrat e tepërta, zhduku mbiprodhimin dhe ofroi kredi; u rihapën banka, uzina etj.

➔ përmirësimi i jetesës

- U morën masa për përmirësimin e gjendjes së punonjësve; koha e punës u kufizua në 35 orë në javë; u caktua minimumi i pagës, u vendos asistenca (ndihma) për të papunët, invalidët, të moshuarit etj.

*Dalja nga kriza në Angli dhe Francë*




**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike dhe të tjera që i ka hartuar paraprakisht për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:

– Pse kishte rëndësi qëndrimi që mbajtën partitë politike për zgjidhjen e krizës në Britani?
– Pse ishte e domosdoshme ndërhyrja e shtetit në ekonomi në ShBA?
– Si lidhen vendimet e Konferencës së Paqes me zhvillimin e ekonomisë franceze?
– Pse reformat e bëra në SHBA, Britani e Francë kishin karakter demokratik komunist?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni në internet materiale për Depresionin e Madh në ShBA dhe krizën në Britani e Francë dhe krijoni një minialbum (3-4 faqe A4) me to.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.4:**<br>**Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca në vitet 1920–1939**<br>**Tema mësimore:**<br>**Kultura, arti dhe shkenca në vitet 1929–1933** | | **Situata e të nxënit:** Mësuesi/ja vendos foto të Heminguejit, Remarkut, Pikaso, Kandinsky, Veber etj. Ajo thotë emrat e tyre dhe pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për krijimet e tyre letrare e artistike. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon rrymat e lëvizjeve kulturore-artistike;<br>- përcakton veçoritë e letërsisë dhe artit sipas drejtimeve;<br>- arsyeton çfarë u përdor në letërsinë ruse. | | **Fjalë kyç:**<br>modernizimi letrar-artistik, Brezi i Humbur, modernistët, censurë | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për artin, kulturën dhe letërsinë e viteve 1920–1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>qytetari, arte, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja ka vendosur foto të Heminguejit, Remarkut, Pikasos, Kandinskyt etj. Ajo thotë emrat e tyre dhe pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për krijimet e tyre letrare e artistike. Ai/ajo u thotë se ata janë shkrimtarë, piktorë e kompozitorë të periudhës mes dy Luftërave (1920–1939), që solli ndryshime të mëdha, duke përfshirë dhe vetë shoqërinë e kohës. Ajo bën pyetje që evidentojnë kapërcimin e krizës dhe zhvillimin ekonomik.

– Si u kapërcye kriza ekonomike dhe Depresioni i Madh në Britani, Francë dhe ShBA?

– Si ndryshoi zhvillimi ekonomik në këto vende pas ndërhyrjeve të shtetit?

Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe mësuesi/ja bën plotësime dhe shton se me zhvillimin ekonomik u zhvillua edhe letërsia, arti dhe kultura.

**Hapi i dytë: Lexim i drejtuar**

Në këtë pjesë të mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "lexim i drejtuar". Ai/ajo orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje dy pjesët e para të temës "Shoqëria dhe lëvizja kulturore-artistike në botën demokratike. Drejtimet kryesore" dhe "Veçoritë e letërsisë dhe artit sipas drejtimeve" dhe u kërkon të gjejnë përgjigjet për pyetjet:

– Cilat janë disa nga rrjedhojat e daljes së vendeve nga kriza ekonomike?
– Cili ishte ndikimi i rritjeve dhe zbritjeve në kulturën dhe artin e kësaj periudhe?
– Cilat ishin tri drejtimet kryesore që mbizotëronin në lëvizjen kulturore artistike të viteve 1920–1930?
– Cilat ishin disa nga veçoritë e letërsisë dhe artit sipas drejtimeve?
– Cilat janë disa nga rrymat që krijuan modernistët dhe kush bënin pjesë në të?
– Çfarë pasqyronin tradicionalistët në veprat e tyre dhe cilët artistë bënin pjesë në këtë drejtim?
– Cilët janë dy nga përfaqësuesit e "Brezit të humbur" dhe çfarë përfaqëson ky drejtim në letërsi?

Më pas mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë dy pjesët e fundit, "Kultura dhe arti në Rusinë Sovjetike (komuniste)" dhe "Zhvillimi i shkencës dhe i teknikës para dhe gjatë Luftës II Botërore".

– Çfarë bëri sistemi komunist me artin dhe kulturën? Për çfarë i përdori ai ato?
– Çfarë masash mori qeveria komuniste për të mbytur fjalën e lirë, për të nënshtruar shkrimtarët e artistët sovjetikë?
– Cilat janë disa nga zhvillimet e teknologjisë, shkencës dhe teknikës gjatë periudhës mes dy LB?

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Për të përforcuar njohuritë që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën disa pyetje të kësaj rubrike

dhe të tjera, që i ka hartuar paraprakisht për të nxitur diskutime në klasë. Me këto pyetje synohet që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e temës:
– Pse brezi i shkrimtarëve të viteve 1920-1939 u quajt "Brezi i humbur"?
– Pse në sistemet diktatoriale arti, kultura dhe letërsia janë një armë e fortë propagande?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni në internet dhe krijoni një listë të veprave letrare të shkrimtarëve të "Brezit të humbur".

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5:**<br>**Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos pamje me video ose foto nga Lufta e Dytë Botërore dhe diskuton me nxënësit se kjo ishte lufta më e përgjakshme në historinë e njerëzimit. | |
| **Tema mësimore:**<br>**Shpërthimi i Luftës II Botërore. Fitoret e para** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston shkaqet e fillimit të Luftës II Botërore;<br>- vë në dukje operacionet luftarake të Frontit Lindor;<br>- analizon zgjerimin e veprimeve luftarake në veri, perëndim e jug të viteve (1940–1941). | | **Fjalë kyç:**<br>Lufta II Botërore, karakter agresiv, Boshti i Çeliktë, Pakti i Mossulmimit | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për artin, kulturën dhe letërsinë e viteve 1920-1939 | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>qytetari, arte, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja e nis orën e mësimit, duke risjellë në kujtesë së bashku me nxënësit shkaqet e Luftës I Botërore, taktikat e përdorura nga palët ndërluftuese, si Gjermania me luftën rrufe, blloqet përbërëse në këtë luftë, dy blloqet luftarake, dhe rrjedhojat e kësaj lufte.

**Hapi i dytë (shkak-pasojë)**

Në këtë pjesë të mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "shkak-pasojë". Ai/ajo orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje duke nënvizuar shkaqet dhe pasojat dhe mësuesi/ja i shkruan ato në tabelën që ka ndërtuar paraprakisht.

| Shkaku | Pasoja |
|---|---|
| ➢ ndarja e botës në zona ndikimi | ➢ karakter agresiv nga shtetet diktatoriale |
| ➢ Vendimet e Konferencës së Paqes pas Luftës së Parë Botërore nuk morën parasysh interesat e disa shteteve. | ➢ Kjo gjë që shkaktoi pakënaqësi, sidomos te shtetet humbëse. |
| ➢ Në Europë u vendosën diktaturat totalitare me politika agresive dhe imperialiste. | ➢ U dha mundësi këtyre diktaturave të realizonin synimet e tyre. |
| ➢ Qëndrimi neutral i Anglisë dhe i Francës ndaj rritjes së agresivitetit të diktaturave në fazën e paraluftës | |

Edhe në pjesën e dytë e të tretë të tekstit të mësimit, mësuesi/ja orienton nxënësit të evidentojnë, shkaqet dhe pasojat duke i shkruar ato në tabelë.

| Shkaku | Pasoja |
|---|---|
| ➢ Gjermania sulmoi Poloninë. | ➢ Franca e Anglia i shpallën luftë Gjermanisë. |
| ➢ Veprimet luftarake u zhvilluan në Lindje<br>➢ Pakti i Mossulmimit mes Gjermanisë e Bashkimit Sovjetik. | ➢ Territoret polake u ndanë në dy pjesë: pjesa perëndimore u pushtua nga Gjermania dhe ajo lindore nga Bashkimi Sovjetik. |
| ➢ U vunë përballë njëri-tjetrit dy kampet kundërshtare: Anglia e Franca, nga njëra anë, dhe Gjermania e Italia, nga ana tjetër. | ➢ Gjermania dhe Italia krijuan Boshtin e Çeliktë. |
| ➢ Gjermania kishte hartuar planin e luftës "sulmi rrufe". | ➢ Mobilizoi forcat ushtarake tokësore, ajrore e detare. |
| ➢ Plani francez parashikonte zhvillimin e një lufte mbrojtëse. | ➢ Kishte ndërtuar një vijë të fortifikuar (vija Mazhino) përgjatë kufirit me Gjermaninë. |

Në pjesën e fundit, mësuesi/ja dhe nxënësit përqendrohen te zgjerimi i veprimeve luftarake në vitet 1940-1941. Edhe këtu evidentohen shkaqet dhe pasojat.

| Shkaku | Pasoja |
|---|---|
| ➢ Në 1940 ushtria gjermane sulmoi drejt veriut. | ➢ Pushtoi Danimarkën dhe Norvegjinë, më pas Luksemburgun, Holandën dhe Belgjikën, |
| ➢ Nazistët filluan sulmin ndaj Francës dhe pushtuan Parisin<br>➢ Musolini i shpalli luftë Francës. | ➢ E gjetur mes dy goditjeve, Franca nuk mund të rezistonte dhe nënshkroi armëpushimin; u nda në dy pjesë: territoret veriore administroheshin nga ushtria gjermane dhe ato jugore nga një qeveri kukull e gjeneralit Peten. |
| ➢ Hitleri filloi sulmet ajrore ndaj Anglisë | ➢ Çërçilli organizoi mbrojtjen kundërajrore; vendi u mbrojt dhe sulmi ajror gjerman u thye. |
| ➢ Gjermania synonte Europën, Italia Mesdheun e Japonia Azinë. | ➢ Ushtritë hitleriane pushtuan Jugosllavinë, ato italiane me ndihmën e gjermanëve pushtuan Greqinë dhe i gjithë territori i Ballkanit ra nën forcat e Boshtit. |
| ➢ Lufta u zhvillua edhe jashtë kufijve të Europës | ➢ Ajo u përhap në oqeanin Atlantik, oqeanin Paqësor dhe në Afrikën Veriore; zhvillohej në shtatë fronte: katër fronte brenda Europës dhe tri fronte jashtë saj. |

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Me qëllim përforcimin e njohurive që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën pyetje për të nxitur diskutime në klasë:

– Çfarë ndikimi patën faktorët e mëposhtëm në Luftën e Dytë Botërore:
  - vendimet e Konferencës së Paqes;
  - vendosja e diktaturave në Europë;
  - rritja e nacionalizmit dhe e militarizmit;
  - Depresioni i Madh;
  - qëndrimi neutral i vendeve demokratike (Anglia e Franca)?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Lexo hartat që ka teksti dhe nxirr përfundime prej tyre.

# Test i tremujorit I

**1. Vendosni brenda kuadrateve vendet pjesëmarrëse për secilin bllok:**




**2. Rrethoni alternativën e saktë.**

Konferenca e Paqes së Parisit i çeli punimet në:
a. janar 1919; b. prill 1919; c. shkurt 1920; d. qershor 1920

**3. Plotësoni.**
Si pretekst për fillimin e Luftës së Parë Botërore shërbeu vrasja e ______________________. Më ____________________ Perandoria Austro-Hungareze i shpalli luftë _________________.

**4. Qarkoni shtetet më të fuqishme pas Luftës së Parë Botërore.**
a. SHBA-ja dhe Franca b. SHBA-ja dhe Japonia
c. Franca dhe Anglia d. Italia dhe Belgjika

**5. Plotësoni.**
Plani prej 14 pikash i propozuar nga presidenti Uillson synonte ______________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

**6. Shënoni me V (e vërtetë) ose G (e gabuar):**
a. Diktaturën e djathtë e solli në pushtet lëvizja komuniste. ______
b. OKB u krijua pas Luftës së Parë Botërore. ______
c. Ndërhyrja e shtetit në ekonomi i dha fund krizës së 1929–1933. ______
d. Paqja e vendosur nga Konferenca e Paqes në 1919 u quajt "paqe e gabuar dhe ndëshkuese" ______
e. Traktati i Fshehtë i Londrës rrezikoi territoret shqiptare. ______

**7. Cilat ishin pasojat/treguesit e krizës ekonomike në ShBA?**
a. ______________________________________________________________________
b. ______________________________________________________________________
c. ______________________________________________________________________

**8. Çfarë përmbante kursi i ri i Ruzveltit?**
a. ______________________________________________________________________
b. ______________________________________________________________________
c. ______________________________________________________________________

**9. Shpjegoni kuptimin e shprehjes "qeveri kukull ose kolaboracioniste".**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**10. Lidhni me shigjetë.**

| | |
|---|---|
| a. Fundi i Luftës së Parë Botërore | ___ 7 prill 1939 |
| b. Shqipëria u shpall monarki | ___ prill 1915 |
| c. Shqipëria u pushtua nga Italia Fashiste | ___ 1 shtator 1928 |
| d. Traktati i Fshehtë i Londrës u mbajt në | ___ nëntor 1918 |

**11. Cilat ishin vendimet kryesore të Konferencës së Paqes në Paris të vitit 1919?**

a. ______________________________________________

b. ______________________________________________

c. ______________________________________________

**12. Cilat janë tri nga shkaqet e Luftës së Parë Botërore?**

a. ______________________________________________

b. ______________________________________________

c. ______________________________________________

**13. Cilat janë drejtimet kryesore të politikës së Gjermanisë naziste?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**14. Tregoni tiparet e totalitarizmi në Itali.**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

# FORMULAR VETËVLERËSIMI

*(Tremujori i parë)*

**Lënda: Histori** **Klasa: 8** **Emër mbiemër: ________________________________**

| | Nëntematika | Niveli i vetëvlerësimit | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Nëntematika 1.1 Lufta dhe paqja 1914-1920** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përcaktoj dhe përdor këto koncepte e terma historikë: luftë botërore, blloqe ndërluftuese, fronte luftimi, rend i ri botëror, vetëvendosje, Konferencës së Paqes Paris, Lidhjes së Kombeve; | | | |
| 2 | Përcaktoj aleancat politike e ushtarake në prag të luftës; | | | |
| 3 | Shpjegoj rritjen e tensionit në Europë, duke evidentuar shkaqet e Luftës së Parë Botërore; | | | |
| 4 | Evidentoj ndryshimin midis shkaqeve dhe pretekstit të luftës; | | | |
| 5 | Tregoj dhe gjykoj rrjedhojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të luftës; | | | |
| 6 | Analizoj vendimet më të rëndësishme të Konferencës së Paqes; | | | |
| 7 | Gjykoj arsyet dhe vlerëson rëndësinë e krijimit të Lidhjes së Kombeve. | | | |
| 8 | Përshkruaj gjendjen e Shqipërisë gjatë viteve 1914-1918, përcakton karakterin e këtij traktati; | | | |
| 9 | Kuptoj dhe gjykoj vendimet e tij për Shqipërinë; | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 1.2 Sistemet politike në vitet 1920-1939** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përcaktoj dhe përdor këto koncepte e terma historikë: komunizëm, fashizëm, totalitarizëm, diktaturë, liberalizëm, demokraci; | | | |
| 2 | Shpjegoj dhe gjykoj rrugët dhe shkaqet e ardhjes në pushtet të qeverisjeve totalitare; | | | |
| 3 | Evidentoj tiparet e sistemeve kryesore politike në vitet 1920-1939; (Gjermani; BRSS; SHBA); | | | |
| 4 | Portretizoj figurat e sistemeve kryesore politike në vitet 1920-1939 duke përshkruar drejtimet e politikës së brendshme e të jashtme të këtyre figurave. | | | |
| 5 | Shqyrtoj dhe gjykoj natyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare në periudhën midis dy Luftërave Botërore | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 1.3 Ekonomia në periudhën në vitet 1920-1939** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përcaktoj dhe përdor këta terma historikë e koncepte: Depresioni i Madh, "marrëveshja e re", shteti i mirëqenies, mbiprodhim, klasë e mesme; | | | |
| 2 | Përshkruaj dhe gjykoj gjendjen ekonomike pas Luftës së Parë Botërore; | | | |
| 3 | Evidentoj dhe gjykoj shkaqet dhe pasojat e krizës 1929-1933; | | | |
| 4 | Vlerësoj politikat e ndryshme që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike: shteti i mirëqenies në Angli, Fronti Popullor në Francë, marrëveshja e re (Kursi i Ri i Ruzveltit në SHBA). | | | |
| 5 | Evidentoj ndikimin e krizës botërore në aspekte të ndryshme të jetës shqiptare; | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 1.4 Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca në vitet 1920-1939** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Shpjegoj ndryshimet sociale, kulturore dhe shkencore që pësoi shoqëria në periudhën midis dy luftërave botërore; | | | |
| 2 | Dalloj ndryshimet ndërmjet tipareve të shoqërive totalitare me ato të shoqërive demokratike; | | | |
| 3 | Evidentoj karakteristikat e artit dhe,kulturës në vitet 1920-1939. | | | |
| 4 | Portretizoj qytetin shqiptar; | | | |
| 5 | Përshkruaj ndikimet e jetës moderne europiane në qytetin shqiptar të viteve '30; | | | |
| 6 | Ndërtoj një album fotografik të kohës. | | | |

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Historia 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5:** **Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Sulmi kundër Bashkimit Sovjetik (BS)** | | **Situata e të nxënit:** Mësuesi/ja vendos pamje me video ose foto nga sulmi gjerman mbi Rusinë ose nga filmi *Pearl Harbor* (sulmi japonez ndaj bazës ushtarake amerikane në Paqësor) dhe diskuton me nxënësit për to. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- përshkruan me fjalët e tekstit ofensivën gjermane në Lindje;<br>- përcakton fitoret e shteteve aleate dhe tatëpjetën e ushtrisë gjermane;<br>- analizon karakterin botëror të luftës. | | **Fjalë kyç:**<br>ofensivë, "Operacioni Barbaroza", karakter botëror | |
| **Burimet:** teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme Luftën II Botërore | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjeografi, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Diskutim**

Orën e mësimit, mësuesi/ja e nis orën duke risjellë në kujtesë së bashku me nxënësit shkaqet e Luftës II Botërore, marrëveshjet mes shteteve, si Pakti i Mossulmimit dhe arsyet e shkeljes së këtij pakti, taktikat e përdorura nga palët ndërluftuese, si Gjermania me luftën rrufe, kampet kundërshtare në këtë luftë. Mësuesi/ja i shkruan disa nga përgjigjet e përmbledhura në tabelë dhe krijon terrenin për të kaluar në hapin e dytë të mësimit, ndërtimin e njohurive.

**Hapi i dytë: Çështja dhe komenti**

Në këtë pjesë të mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "çështja dhe komenti". Ai/ajo orienton nxënësit që të lexojnë tekstin dhe, sipas nëntemave, të bëjnë komentet përkatëse. E nis me nëntemën "Ofensiva në Lindje".

| Çështja | Komenti |
|---|---|
| ➢ Ofensiva në Lindje (operacioni Barbaroza) | ➢ Nisi më 22 qershor 1941.<br>➢ Gjermanët shpresonin në sulmin e befasishëm dhe besonin se do ta mposhtnin Rusinë përpara dimrit.<br>➢ Kishin nevojë për grurin e fushave ruse dhe naftën e Kaukazit.<br>➢ Hitleri përdori të gjithë fuqinë luftarake dhe përparimi qe i shpejtë; u fut thellë në territoret ruse.<br>➢ Në pak muaj nazistët iu afruan Moskës, por u detyruan të ndalojnë nga kundërveprimi i ushtrisë ruse. |
| ➢ Karakteri botëror i luftës | ➢ Stalini mori masa të jashtëzakonshme për të përballuar gjendjen.<br>➢ BS-ja ruajti aftësinë prodhuese të armëve.<br>➢ Forcat japoneze pushtuan Filipinet, Indonezinë, Malajzinë, Indokinën dhe kërcënuan Indinë e Australinë.<br>➢ Më 7 dhjetor 1941 japonezët sulmuan në befasi bazën luftarake amerikane në ishullin Përl Harbër dhe e shkatërruan flotën e saj.<br>➢ Menjëherë SHBA-ja hyri në luftë ndaj Japonisë e aleatëve të saj. |
| ➢ Tatëpjeta e ushtrisë naziste dhe fitoret e shteteve aleate | ➢ Më 1942 nazistët e përqendruan sulmin në Stalingrad, e rrethuan atë; luftimet e ashpra zgjatën 6 muaj; Kundërsulmi i ushtrisë ruse solli fitoren.<br>➢ Ushtria gjermane u rrethua dhe u detyrua të dorëzohej me afro 400 mijë ushtarë; nazistët rrethuan edhe Moskën, por dështuan.<br>➢ Në Lindjen e Largët, japonezët pësuan disfata në betejat detare e ajrore. Amerikanët filluan t'i dëbonin japonezët nga Paqësori.<br>➢ Në Afrikën Veriore ushtria italo-gjermane pësoi disfatë; forcat anglo-amerikane arritën të çlironin territoret e Afrikës Veriore. |

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Me qëllim përforcimin e njohurive që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi, përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën pyetje për të nxitur diskutime në klasë:

– Cilat janë arsyet e ofensivës së gjermanëve në Frontin Lindor dhe me cilën mund të krahasohet kjo ofensivë?
– Cilat ishin betejat kryesore gjatë viteve 1942–1943 dhe si përfunduan ato?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Interpreto hartat e tekstit duke u mbështetur në legjendat e tyre.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5:**<br>**Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Në tabelë vendoset harta e Ballkanit dhe nxënësit së bashku me mësuesin/en diskutojnë pushtimin e gadishullit nga forcat nazifashiste. | |
| **Tema mësimore:**<br>**Veprimet ushtarake në Ballkan** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston interesat naziste në Ballkan;<br>- përshkruan veprimet luftarake për pushtimin e Ballkanit;<br>- analizon rëndësinë e rezistencës antifashiste. | | **Fjalë kyç:**<br>qeveri kukull, shtete ballkanike, luftëra civile | |
| **Burimet:**<br>Teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme Luftën II Botërore | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Diskutim**

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskutojnë për pushtimin e Europës nga ushtritë e Boshtit dhe për aleancat e krijuara. Ai/ajo bën disa pyetje për të risjellë në vëmendje të nxënësve veprimet luftarake të Luftës së Dytë Botërore.

– Cilat ishin aleancat ushtarake në Luftën II Botërore?
– Çfarë veprimesh ndërmori Gjermania për pushtimin e Bashkimit Sovjetik?
– Cilat shtete nga Ballkani bënin pjesë në Boshtin Qendror?

Mësuesi/ja përmbledh dhe shkruan në tabelë disa nga përgjigjet e nxënësve, duke bërë plotësimet përkatëse.

**Hapi i dytë: Skema e mendjes**

Në këtë pjesë të mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "skema e mendjes". Sipas kësaj teknike, nxënësit orientohen të lexojnë tekstin sipas nëntemave, ndërsa mësuesi/ja ndërton dhe plotëson skemën. Ai/ajo e nis me nëntemën e parë "Ofensiva në Lindje".

**Interesat nazistë në Ballkan**

- Pushtimi i Ballkanit si prapavijë e sigurt
- Kontrolli i Mesdheut Lindor
- Ballkani vlerësohej nga ana ushtarake dhe ekonomike
- Do të krijonte nga popujt e Ballkanit reparte ushtarake për fushatën e Lindjes
- Nafta rumune dhe gruri e mineralet e Jugosllavisë dhe Bullgarisë përbënin një rezervë për nazistët

**Shtete aleate me Boshtin**

- Rumania, Hungaria dhe Bullgaria
- Shqipëria ishte e paanshme, e pushtuar nga Italia
- Greqia e Jugosllavia mbetën jashtë paktit

Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën "Pushtimi i Ballkanit" dhe plotëson skemën së bashku me nxënësit.

**Pushtimi i Ballkanit**

- Operacioni Marita - sulm ndaj Greqisë e Jugoslavisë njëkohësisht
- Veprimet luftarake filluan më 6 prill 1941
- Ushtria gjermane hyri në Kroaci, italianët në Slloveni, hungarezët në Vojvodinë, rumunët në Banat dhe bullgarët në Maqedoni
- Më 6 prill 1941, Gjermania i shpalli luftë Greqisë, divizionet gjermane hynë në territoret greke
- Brenda prillit Ballkani hyri nën varësinë e Boshtit.

Me të përfunduar skemën e nëntemës së dytë, mësuesi/ja shton se pas kalimit të Ballkanit në varësinë e Boshtit, ishte e kuptueshme që popujt të luftonin për lirinë e vendit të tyre. Ato krijuan rezistencën e tyre antifashiste. Këtu, mësuesi/ja ndërton skemën dhe e plotëson së bashku me nxënësit.

**Rezistenca antifashiste**

- Në vendet e Ballkanit filloi lëvizja antifashiste, e drejtuar nga nacionalistët e komunistët.
- Lëvizja antifashiste me ushtri çlirimtare ishte e fuqishme në Jugosllavi, Greqi e Shqipëri.
- Komunistët, krahas luftës për çlirim, kërkonin të merrnin pushtetin pas luftës; në Jugosllavi Tito, në Shqipëri E. Hoxha; Kjo solli përçarje dhe luftë civile.
- Forcat sovjetike pas kundërsulmit hynë në Rumani, Bullgari dhe Jugosllavi;
- Shqipëria fitoi vetë lirinë nga Ushtria Nacionalçlirimtare.
- Në vendet e Ballkanit u vendosën regjime komuniste, përveç Greqisë (ku vepruan divizionet angleze).

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Me qëllim përforcimin e njohurive që kanë përftuar nxënësit në këtë orë mësimi përdoren pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Mësuesi/ja bën pyetje për të nxitur diskutime në klasë:

– Në vendet e Ballkanit lufta antifashiste u kthye në luftë civile. Cili ishte shkaku?

– Si përfundoi Lufta II Botërore në Ballkan?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruaj një ese ku të zbërthesh idetë e të dy karikaturave të tekstit (në f. 52).

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5:**<br>**Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)**<br>**Tema mësimore:**<br>**Veprimtaria diplomatike gjatë Luftës II Botërore** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos një foto të Ruzveltit, Stalinit dhe Çërçillit dhe diskuton me nxënësit për këta tre udhëheqës të Aleancës kundër nazifashistëve. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston emrat e dy koalicioneve dhe shteteve përbërëse të tyre;<br>- vë në dukje vendimet e tri konferencave të aleancës kundër nazifashizmit;<br>- analizon rëndësinë e krijimit të Gjykatës Ushtarake për dënimin e krimeve të nazizmit. | | **Fjalë kyç:**<br>E drejta për vetëvendosje, Karta e Adriatikut, Konferenca e Teheranit, Konferenca e Jaltës, | |
| **Burimet:** teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme Luftën II Botërore, për Gjykatën Ushtarake, për konferencën e Jaltës, Teheranit dhe Potsdamit | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Për të evidentuar edhe një herë forcat aleate në luftën kundër nazifashistëve, mësuesi/ja ka hartuar disa pyetje:

– Cilat shtete bënin pjesë në aleancën ushtarake kundër nazifashistëve dhe cilët ishin udhëheqësit e tyre?
– Cilat ishin disa nga betejat e mëdha që u zhvilluan në Luftën II Botërore?
– Çfarë po ndodhte në kontinentin aziatik në atë kohë?
– Cilat shtete po përballonin barrën më të madhe të Luftës?

Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe mësuesi/ja, pasi bën plotësimet, i përmbledh ato dhe i shkruan në tabelë.

**Hapi i dytë: Shpjegim**

Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja evidenton se shtetet kryesore të Aleancës Antifashiste ishin SHBA-ja, BS-ja, Britania e Madhe dhe Franca. Ai/ajo ndërton një tabelë, ku shkruan emrat e shteteve përbërëse në aleancat ndërluftuese:

*Aleanca ushtarake:*

1. Aleanca Trepalëshe (Gjermani-Itali-Japoni) me veprimtari agresive edhe jashtë Europës
2. Koalicioni i Madh Antifashist (ShBA-Angli-Francë-Bashkimi Sovjetik dhe më pas 26 shtete të tjera).

*Shtetet e Koalicionit të Madh:*

- nënshkruan një deklaratë të përbashkët, që u quajt Karta e Atlantikut;
- ky dokument mbështetet mbi parimin universal të të drejtave të popujve për vendvendosje.

*Konferenca e Teheranit: 28 nëntor–1 dhjetor 1943.* Vendimet:

- goditja e Aleancës Trepalëshe;
- luftë në territorin europian dhe goditja e Gjermanisë;
- hapja e Frontit të Dytë të Luftës në Europën Perëndimore për ta vendosur Gjermaninë në darën e një goditjeje të dyfishtë;
- u kërkua që BRSS-ja, pas mbarimit të luftës në Europë, t'i shpallte luftë Japonisë.

*Konferenca e Jaltës: shkurt 1945.* Vendimet:

- të vendoseshin regjimet demokratike në vendet e çliruara, ku qeveritë të dilnin nga zgjedhjet e lira;

- të çarmatosej pas mbarimit të Luftës Gjermania, territori i saj të ndahej mes shteteve fituese dhe populli gjerman, i lirë, të vendoste për të ardhmen e tij;
- të krijohej Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në botë;
- Europa Lindore të mbetej nën ndikimin rus, ndërsa Europa Perëndimore, duke përfshirë edhe Austrinë e Greqinë, nën ndikimin anglo-amerikan.

*Konferenca e Postdamit: korrik–gusht 1945.* Vendimet:
- u trajtua çështja gjermane;
- territori gjerman përkohësisht të ndahej në 4 zona, të cilat të administroheshin nga shtetet fituese: SHBA-ja, Anglia, Franca e BS-ja;
- u diskutua edhe çështja e krimeve të nazizmit; u krijua Gjykata Ushtarake Ndërkombëtare për të dënuar krerët nazistë si kriminelë të luftës;
- në shërbim të forcimit të paqes u krijua OKB-ja dhe u zhvillua Konferenca e Paqes në Paris.

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Për të siguruar që njohuritë e reja janë përthithur nga nxënësit, mësuesi/ja përdor pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Pas përgjigjeve, mësuesi/ja bën pyetje të tjera për të nxitur diskutime në klasë. Me këto diskutime synohet që nxënësit të aftësohen në përvetësimin jo vetëm të njohurive, por edhe të koncepteve dhe çështjeve kryesore të analizuara në klasë.

– Pse kishte rëndësi krijimi i Gjykatës Ushtarake me përfundimin e Luftës?
– Sipas mendimit tuaj, krimet e nazizmit ishin krime lufte apo gjenocid? Pse?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjeni të dhëna në internet për qëndrimin e shteteve të Europës Lindore ndaj ndihmës amerikane. Diskutoni në klasë për përfundimet që nxorët.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5: Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos foto të një kampi përqendrimi, dhe të Hiroshimës pas bombardimit dhe diskuton me nxënësit për këto foto. | |
| **Tema mësimore:**<br>**Disfata e Gjermanisë dhe e Japonisë. Mbarimi i Luftës II Botërore** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>□ tregon arsyet e kapitullimit të Italisë;<br>□ përshkruan veprimet luftarake gjatë viteve 1943-1944;<br>□ analizon pasojat e Luftës II Botërore. | | **Fjalë kyç:**<br>kapitullimi i Italisë fashiste dhe i Gjermanisë naziste | |
| **Burimet:** teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Luftën II Botërore, për kampet naziste, për bombardimin e Hiroshimës dhe Nagasakit | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Bashkëbisedim**

Për të nisur diskutimet në klasë dhe për të risjellë në kujtesë blloqet ndërluftuese dhe zhvillimin e luftës,

mësuesi/ja u drejton nxënësve disa pyetje:
– Çfarë ndodhi në rrethimin e qyteteve të mëdha ruse, si Stalingradi dhe Moska?
– Cilat territore kishin pushtuar ushtritë e Bllokut Qendror (Gjermani, Itali, Japoni)?
– Çfarë masash morën forcat aleate për të zmbrapsur ushtritë pushtuese?
Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe mësuesi/ja, pasi bën plotësimet e duhura, i përmbledh ato dhe i shkruan në tabelë.

**Hapi i dytë: Lexim i drejtuar**
Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja përdor teknikën "lexim i drejtuar", ku nxënësit orientohen të lexojnë nëntemat një nga një dhe më pas i komentojnë ato me mësuesin/en. Fillohet me nëntemën "*Kapitullimi (dorëzimi i Italisë fashiste)*".
- Në vitin 1943 ushtritë aleate anglo-amerikane zbarkuan në ishullin e Sicilisë; u mbështetën edhe nga repartet vullnetare partizane.
- Më 25 korrik 1943 Viktor Emanueli III, mbreti i Italisë, arrestoi Musolinin; krijoi një qeveri të re nën drejtimin e gjeneralit Badolio.
- Më 8 shtator 1943 qeveria nënshkroi kapitullimin dhe Italia doli nga lufta.
- Ushtria gjermane pushtoi Italinë Veriore dhe liroi nga burgu Musolinin, që krijoi në veri, një shtet të ri fashist, Republikën Sociale Italiane.
- Gjatë viteve 1943–1944 ushtritë aleate çliruan Italinë Qendrore; qytetet veriore, u çliruan nga forcat partizane.
- Musolini u kap nga forcat partizane antifashiste, të cilat e dënuan me vdekje dhe e varën.

Më pas, nxënësit lexojnë nëntemën e dytë "Gjermania naziste ndërmjet dy goditjeve" dhe së bashku me mësuesin/en evidentojnë çështjet kryesore:
- Kapitullimi i Italisë e dëmtoi rëndë Gjermaninë naziste.
- Ushtria ruse filloi kundërsulmin, kaloi kufirin e saj, hyri në territoret polake dhe u përgatit për goditjen përfundimtare.
- Në perëndim, në territoret franceze të Normandisë, zbarkuan forcat anglo-amerikane.
- U bombarduan qendrat industriale, rrugët e komunikacionit, duke shkaktuar vështirësi në furnizimin e lëvizjen e ushtrisë naziste.
- Forcat aleate në perëndim çliruan Francën, Holandën, Belgjikën dhe arritën në kufirin gjerman.
- Në Frontin Lindor rusët çliruan Poloninë, Rumaninë Bullgarinë, Hungarinë dhe iu drejtuan Berlinit.
- Komanda gjermane nënshkroi kapitullimin me aleatët perëndimorë më 7 maj, ndërsa me komandën sovjetike më 8 maj; Hitleri i dëshpëruar vrau veten.

Pika e fundit çon në nëntemën "Mbarimi i Luftës dhe pasojat e saj":
- Në Europë Lufta kishte mbaruar
- Japonia vazhdonte të luftonte në Lindjen e Largët duke përdorur pilotët e vdekjes
- Në 6 dhe 9 gusht 1945 ShBA-ja përdori bombën atomike në Hiroshima dhe Nagasaki; Më 2 shtator Japonia nënshkroi kapitullimin.

Pasojat e luftës:
- Vdiqën rreth 55 milionë njerëz, nga të cilët 49 milionë qenë në Europë.
- U rrafshuan qytete, ekonomia europiane pësoi dëme të pallogaritshme.
- Dëme të jashtëzakonshme pësoi popullsia hebre – Holokausti.
- Pati pasoja edhe në planin psikologjik.
- Popujt e ndryshëm që pësuan dhunën nazifashiste u goditën rëndë edhe në aspektin shëndetësor, si depresione mendore, vetëvrasje, sëmundjeve të ndryshme etj.

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**
Për të siguruar që njohuritë e reja janë përthithur nga nxënësit, mësuesi/ja përdor pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Pas përgjigjeve, mësuesi/ja bën pyetje të

tjera për të nxitur diskutime në klasë. Me këto diskutime synohet që nxënësit të aftësohen në përvetësimin jo vetëm të njohurive, por edhe të koncepteve dhe çështjeve kryesore të analizuara në klasë.

- Në Europën Lindore pas luftës u vendosën regjimet komuniste. Sipas mendimit tënd, çfarë ndikoi për vendosjen e tyre?
- Pse Japonia ishte vendi i fundit që nënshkroi kapitullimin? Çfarë e detyroi atë?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej të dhëna për pasojat e përdorimit të bombës atomike kundër Japonisë në Luftën II Botërore.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.5:<br>Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Nxënësit kanë lexuar intervistën me aktoren kryesore të filmit "Koncert në vitin 1936", zonjën Manushaqe Qinami.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Jeta qytetare shqiptare në vitet '30 (Veprimtari praktike)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>□ përshkruan jetën politike të Shqipërisë në prag të Luftës së Dytë Botërore;<br>□ eksploron dhe njeh jetën e Shqipërisë në vitet '30 të shekullit XX.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, materiale të ndryshme për Shqipërinë para Luftës së Dytë Botërore</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, komunikim, arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Përgatitja për diskutim dhe përcaktimi i tematikës së diskutimit**

Fillimisht, mësuesi/ja paraqet përmbledhtas temën ose çështjen e diskutimit. Disa nga detyrat që mund të jenë:

a. të lexojnë në mënyrë të pavarur intervistën e rubrikës *Leximi i orientuar*;
b. të shohin nëpërmjet internetit filmin "Koncert në vitin 1936";
c. të përgatisin një ese rreth jetës në Shqipëri në vitet '30 të shekullit XX.

Pas përcaktimit të çështjeve për diskutim dhe referuesit e tyre kryesorë, planifikohet zhvillimi i diskutimit. Rregullohen tavolinat në një formë të përshtatshme.

**Hapi i dytë: Diskutimi nga nxënësit**

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja zgjedh drejtuesit/et e diskutimit, të cilët drejtojnë diskutimin sipas këtij rendi:

- prezantojnë përmbledhtas temën dhe çështjet e diskutimit;
- nxënësit diskutojnë për çështjet e veçanta duke pasur parasysh materialet e mbledhura paraprakisht;
- drejtuesi i çështjes bën përmbledhjen e çështjes që u diskutuan dhe përfundimet shkruhen në tabelë. (Është mirë që çdo çështje ta drejtojë një drejtues i veçantë.)

Mësuesi/ja ose drejtuesi i parë i kujton klasës rregullat e diskutimit, sipas të cilave: njëri flet, të tjerët dëgjojnë. Diskutimi në klasë mund të kombinohet me teknikën e lojës me role: dialogu (shkurt batuta, dialektizmi i kohës) referuar personazheve të filmit (beut, prefektit, këngëtareve etj.). Mjedisi i klasës mund të përmbajë elemente të jetës qytetare të atyre viteve: vizatime, skicime për veshjet, foto, materiale të ndryshme vizuale të nxjerra nga interneti.

**Hapi i tretë: Përmbledhja dhe vlerësimi**
Në këtë fazë nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi i diskutimit. Përmblidhen pikat kryesore.
- Renditen faktet e paraqitura.
- Tregohet ç'është realizuar.
- Bëhet vlerësimi i punës.

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve, kontributin e secilit anëtar dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5:**<br>**Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)**<br><br>**Tema mësimore:**<br><br>**Republika, Mbretëria Shqiptare dhe Kriza Botërore *(Veprimtari praktike)*** | | **Situata e të nxënit:**<br>Nxënësit lexojnë pjesën "lexim i orientuar"<br>Statusi politik i shtetit shqiptar nga viti 1913 deri në vitin 1939, kalon në tri forma të organizimit politik:<br>• mbizotëron forma e Principatës (1913–1925);<br>• Republika (1925–1928)<br>• Mbretëria (1928–1939)<br>Në fazën e parë, princ Vilhelm Vidi caktohet nga Fuqitë e Mëdha si Princ i Shqipërisë. Princi largohet me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Kjo la një vakum në statusin politik të shtetit shqiptar. Rolin e Kryetarit të Shtetit të Shqipërisë e luajti Këshilli i Lartë. Në vitin 1925 Shqipëria u shpall Republikë Parlamentare, me president Ahmet Zogun dhe Këshilli i Lartë u shpërnda. Më 1 shtator 1928 Shqipëria shpallet Mbretëri me mbret Zogun e Parë si Mbret i Shqiptarëve. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br> përshkruan shkurtimisht jetën politike të Shqipërisë gjatë periudhës së Mbretërisë. | | | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, materiale të ndryshme për Shqipërinë para Luftës së Dytë Botërore | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, komunikim, arte | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Përgatitja e ligjëratës**
Në fillim, mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën "Lexim i orientuar". Më pas, ai/ajo përcakton se duhet të kryhen këto veprime:
- ➢ Caktohet tema e ligjëratës dhe qëllimi i saj.
- ➢ Parapërgatitet ligjërata sipas një rendi logjik të përshtatshëm për nxënësit. Rekomandohet ndarja e tri tematikave: 1) periudha 1912–1925; 2) 1925–1928; 3) 1928–1939 dhe caktohen tri deri në gjashtë nxënës (dy për secilën tematikë) për të punuar.

- Mësuesi/ja rekomandon strukturën e çdo ligjërate.
- Rekomandohen që burimet për secilën periudhë të jenë:
  - tekstet e Historisë së Shqipërisë (klasa 9 dhe 12), botime shkollore Albas;
  - Fjalori Enciklopedik Shqiptar (vëllimi 1-3, sipas tematikës);
  - interneti.
- Mësuesi nxit referuesit të gjejnë mjetet mësimore interesante për konkretizimin e ligjëratës.
- Parashikohet kohëzgjatja e ligjëratës.

**Hapi i dytë: Prezantimi i ligjëratës**
Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja evidenton:
- Çdo ligjërues prezanton temën dhe qëllimin e ligjëratës.
- Shtjellohet tema sipas një plani, i cili shkruhet në dërrasën e zezë.

Mësuesi/ja siguron që ligjërata të paraqitet me një gjuhë të qartë, të thjeshtë të saktë dhe me një zë tërheqës. Për këtë përdoren mjete të ndryshme mësimore sipas temës, si fletëpalosje, postera etj. Pas shtjellimit të ligjëratës mund të kryhen veprimtari të tjera mbështetëse, që lidhen me temën e ligjëruar, si: diskutimi, konkursi, teste etj. Ato mund të vazhdojnë gjatë asaj ore mësimi, të jepen si detyra shtëpie ose të realizohen në orët e mësimit që do të vijojnë. Për këtë veprimtari mund të përdoret konkursi ose loja me role. Konkursi mund të mos përmbajë vetëm pyetje teorike, por edhe prezantim materialesh të punuara paraprakisht nga nxënësit.

**Hapi i tretë: Përmbledhja dhe vlerësimi**
Në këtë fazë nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi i diskutimit. Përmblidhen pikat kryesore.
- Renditen faktet e paraqitura.
- Tregohet ç'është realizuar.
- Bëhet vlerësimi i punës.

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve, kontributin e secilit anëtar dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 1.5:**<br>**Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)** | | **Situata e të nxënit:**<br>Nxënësit lexojnë pjesën "lexim i orientuar"<br>Shtypi i viteve '30 mori zhvillim në periudhën e Mbretërisë Shqiptare (1928–1939). Mbreti Zog luajti rolin e vet në këtë zhvillim. Duke u gjendur përballë kritikave të mëdha nga forcat demokrate intelektuale të vendit, që kërkonin reforma demokratike, ai solli në qeverisje elementë me pikëpamje perëndimore, ose siç quheshin "oksidentalistë". Në tetor 1935 u formua qeveria nën kryesinë e Mehdi Frashërit. Në programin e tij ishin ndërmarrja e disa reformave demokratike, si: liria e fjalës, e shtypit; zhvillimi i ekonomisë, i arsimit; reforma agrare etj.. Këto reforma u trajtuan nga shtypi i kohës, shtypi i viteve '30. U rrit numri i gazetave me profile të ndryshme, si politike, kulturore, shoqërore, fetare etj. Kësaj periudhe i takojnë gazetat: "Arbënia", "Besa", "Bota e Re", "Illyria", "Përpjekja Shqiptare", "Rilindja", "Rilindja e Arbërisë", "Shtypi", "Vatra", "Vullneti i Popullit", "Leka" etj. | |
| **Tema mësimore:**<br><br>**Shtypi shqiptar në vitet '30 *(Veprimtari praktike)*** | | | |

<table>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br> përshkruan gjendjen e shtypit shqiptar në periudhës para Luftës së Dytë Botërore.</td></tr>
<tr><td>Burimet: teksti, interneti, materiale të ndryshme për gjendjen e shtypit në Shqipëri në periudhën para Luftës së Dytë Botërore</td><td>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, komunikim, arte</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Përgatitja e materialit për diskutim**

Mësuesi/ja udhëzon një nxënës të lexojë pjesën "lexim i drejtuar". Nxënësit zgjedhin një nga gazetat që përmenden te pjesa e lexuar nga nxënësi i parë. Në varësi të numrit të gazetave të përzgjedhura bëhet ndarja në grupe.

Për të përgatitur materialin, grupeve u rekomandohen këto pika orientuese:

- Lloji i gazetës: tematika që zë vendin kryesor në të: politike, shoqërore, kulturore, fetare etj.
- Periudha e daljes së saj në treg.
- Vërtetësia e të dhënave (lajmi, kronika etj.).
- Emrat e gazetarëve që bien në sy (autorët kryesorë që kanë shkruar në këto gazeta).
- Gjuha e përdorur në shkrime.

Mësuesi/ja u rekomandon burimet nga do të merret informacioni:

a. interneti, ku shkruhet adresa, titulli i gazetës dhe lexohet në shqip përmbajtja;
b. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, ku në tri vëllime, sipas rendit alfabetik, kërkohet secila gazetë.

Mësuesi/ja bën të qartë formën e prezantimit të produktit të çdo grupi.

**Hapi i dytë: Prezantimi i ligjëratës**

Në fazën e dytë, rregullohen tavolinat në formë U-je. Gjatë kësaj faze, zgjidhet nxënësi/ja që do të luajë rolin e moderatorit. Ai përcakton "rregullat" e prezantimit, kohën dhe planifikon edhe seancë pyetjesh dhe debati. Çdo grup bën prezantimin e produktit të vet dhe u përgjigjet pyetjeve nga grupet e tjera. Mësuesi/ja përpiqet gjithmonë të krijojë një atmosferë mbështetëse, duke pranuar çdo kontribut të nxënësve, edhe sikur të mos jetë shumë i vlefshëm.

**Hapi i tretë: Përmbledhja dhe vlerësimi**

Në këtë fazë nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi i diskutimit. Përmblidhen pikat kryesore.

- Renditen faktet e paraqitura.
- Tregohet ç'është realizuar.
- Bëhet vlerësimi i punës.

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve, kontributin e secilit anëtar dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë.
Po ashtu, mësuesi/ja, me ndihmën e një jurie, bën vlerësimin e punës së çdo grupi dhe inkurajon anëtarët e grupit të bëjnë vlerësimin për çdo anëtar të grupit përkatës.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Historì 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.5:<br>Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Nxënësit lexojnë pjesën "lexim i orientuar"<br>Nazizmi hitlerian zbatoi një politikë të egër gjenocidi ndaj popullit hebre në të gjitha territoret e pushtuara prej tij. Në thelb, kjo politikë synonte zhdukjen e këtij populli dhe njihet me termin Holokaust. Në kujtimet, jo vetëm të popullit hebre, por edhe të popujve të tjerë, bën përjashtim, nderohet dhe çmohet populli shqiptar me qëndrimin e vet heroik, besnik e dashamirës ndaj hebrenjve. Historia njeh shumë fakte që dëshmojnë këtë qëndrim, i cili pohohet dhe çmohet edhe sot nga vetë komuniteti hebre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br><br>Qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore (Veprimtari praktike)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan qëndrimin e shqiptarëve ndaj hebrenjve në Luftën e Dytë Botërore duke u bazuar në dëshmi të vërteta (historia e hebrenjve të Elbasanit etj.);<br>• evidenton bujarinë, mikpritjen dhe besën e shqiptarëve në ndihmë të hebrenjve të rrezikuar nga shfarosja prej nazistëve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, materiale të ndryshme për gjendjen e shtypit në Shqipëri në periudhën para Luftës së Dytë Botërore</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, komunikim, arte</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## Ora I

***ECURIA METODIKE***

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Përgatitja për projektin**

Fillimisht mësuesi/ja i kërkon një nxënësi të lexojë pjesën "lexim i drejtuar". Tematikat për t'u trajtuar në këtë veprimtari praktike, për të cilat nxënësit të mbledhin materiale, që do të ndriçojnë temën kryesore të projektit, janë:

1. Historia e shfaqjes së hebrenjve në Shqipëri, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore.
2. Hebrenjtë që u kthyen në katolikë.
3. Historia e hebrenjve të Elbasanit.
4. Dëshmi për qëndrimin e familjeve shqiptare ndaj hebrenjve. Besa e artë.
5. Familja mbretërore shqiptare dhe hebrenjtë.
6. Histori personale nga shqiptarë që mbrojtën hebrenjtë.
7. Qëndrimi i institucioneve shtetërore shqiptare ndaj hebrenjve në periudhën 1939–1943 dhe 1943–1945.
8. Titull mirënjohjeje nga Izraeli për qëndrimin e shqiptarëve dhe shtetit shqiptar ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Mësuesi/ja e ndan klasën në aq grupe sa janë tematikat. Çdo grup do të realizojë veprimtari hulumtuese në këto burime:

a. Shfrytëzimi i Fjalorit Enciklopedik Shqiptar;

b. Shfrytëzimi i burimeve nga interneti tek adresa: Hebrenjtë në Shqipëri.

c. Mund të realizohen edhe intervista me familje të tilla ose persona të veçantë.

## Ora II

***ECURIA METODIKE***

**Faza II: Puna rreth projektit**

Në orën e dytë, mësuesi/ja siguron që çdo grup të ketë shfrytëzuar burimet e rekomanduara në përputhje me tematikën e paracaktuar. Çdo grup duhet të pasqyrojë një produkt të vetëm, në emër të grupit, ku të shkrihen së bashku të dhënat e marra nga burimet e ndryshme. Secili nga anëtarët paraqit punën e bërë në grup: në formë të një eseje prej 10-12 rreshtash, të albumit me foto, të fakteve dhe dëshmive, kujtime, montazh citimesh, *PowerPoint* etj. Mësuesi/ja ndjek në vazhdimësi punën dhe nxit kryetarët e grupeve të raportojnë rreth ecurisë së procesit të hulumtimit, vështirësive, aspekteve të veçanta të hulumtimit, paqartësive të mundshme dhe bën orientimin dhe rekomandimin përkatës për të garantuar përfundimin me sukses të produktit përfundimtar.

## Ora III

***ECURIA METODIKE***

**Faza III: Raportimi i përfundimeve**

Në këtë orë rekomandohet të raportohet rreth çdo tematike. Mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit bën vlerësimin e çdo grupi dhe nxënësit ftohen të bëjnë vlerësimin e çdo nxënësi brenda grupit.

Në këtë fazë nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi i diskutimit. Përmblidhen pikat kryesore.

- Renditen faktet e paraqitura.
- Tregohet ç'është realizuar.
- Bëhet vlerësimi i punës.

Mësuesi/ja vlerëson punën e nxënësve, kontributin e secilit anëtar dhe mënyrën e paraqitjes së informacionit. Nxënësit vlerësohen për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna dhe në pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë. Po ashtu, mësuesi/ja, me ndihmën e një jurie, bën vlerësimin e punës së çdo grupi dhe inkurajon anëtarët e grupit të bëjnë vlerësimin për çdo anëtar të grupit përkatës.

Në përfundim të projektit, grupet përgatitin një stendë me titull: "Qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore".

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 1.5:<br>Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Në këtë orë mësimi bëhet një përsëritje e tre kapitujve.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Përsëritje: Periudha e tronditjeve të mëdha (1914 –1945)</td></tr>
<tr><td colspan="4">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- ripërshkruan ngjarjet kryesore, shkaqet, blloqet ndërluftuese, veprimet luftarake dhe pasojat e dy luftërave botërore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>gjeografi, komunikim, arte, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit – punë në grupe dhe prezantim

❍ *Çështja 1:* **Lufta dhe paqja (1914–1920)**

**Hapi i parë:**

Fillimisht, jep një përmbledhje të shkurtër të kreut duke thënë: *Përplasja e interesave ndërmjet blloqeve ushtarake, ashpërsimi i rivaliteteve në mes tyre sollën Luftën e Parë Botërore, që i kushtoi Europës mbi 8 milionë të vdekur dhe vendosjen e një* paqeje që krijoi pakënaqësi e *tensione të mëdha.*

**Hapi i dytë:**

➢ Mësuesi/ja i ndan nxënësit në dy grupe dhe kërkon të plotësojnë tabelën e mëposhtme, të cilën e ka përgatitur më parë dhe ia shpërndan grupeve.

➢ Mësuesi/ja sqaron përmbajtjen e tabelës dhe mënyrën si do të plotësohet.

**Grupi 1**

| *Çfarë ka ndodhur?* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Vritet trashëgimtari i fronit të Austrisë | | | | |
| Austria i shpall luftë Serbisë. Fillon Lufta I Botërore | | | | |
| Hyrja e Italisë në luftë përkrah Antantës | | | | |

**Grupi 2**

| *Çfarë ka ndodhur?* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Hyrja e SHBA-së në Luftë | | | | |
| Armëpushimi i Rusisë me Bllokun Qendror | | | | |
| Fundi i Luftës | | | | |
| Konferenca e Paqes | | | | |

**Hapi i tretë:**

- Pas përfundimit të detyrës, një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.
- Diskutohen përgjigjet

❍ *Çështja* **2: Sistemet politike në vitet 1920–1939**

**Hapi i parë:**

Këtu mësuesi/ja jep idenë kryesore: *Gjatë periudhës 1920–1939 lindën shtetet diktatoriale të djathta (fashizmi e nazizmi) dhe të majta (stalinizmi) nga njëra anë dhe nga tjetra shtetet demokratike, me lider SHBA-në.*

**Hapi i dytë:**

➢ Mësuesi/ja i ndan nxënësit në tri grupe dhe kërkon të plotësojnë tabelën e mëposhtëm të cilën e ka përgatitur më parë dhe ia shpërndan grupeve.

**Grupi 1.**

| *Çfarë ka ndodhur* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| a – Revolucioni demokratik<br>b – Revolucioni proletar<br>c – Vendosja e regjimit totalitar komunist | | | | |
| Italia, 1918–1939<br>Vendosja e fashizmit | | | | |

**Grupi 2.**

| *Çfarë ka ndodhur* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Vendosja e diktaturës naziste | | | | |
| SHBA në vitet 1918–1939<br>a. Partia demokratike në pushtet<br>b. Partia Republikane në pushtet<br>c. Rivendosja në pushtet e demokratëve | | | | |

**Grupi 3.**

| *Çfarë ka ndodhur* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Britania e Madhe 1918–1939. Jeta politike | | | | |
| Franca në vitet 1918–1939<br>- Alternimi i partive | | | | |

**Hapi i tretë:**

- Pas përfundimit të detyrës, një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.

❍ *Çështja **3:*** **Lufta e Dytë Botërore (1939–1945)**

**Hapi i parë:**

Pasi ka dhënë idenë kryesore se projektet nazifashiste për zotërim botëror dështuan përpara rezistencës së forcave demokratike: Britanisë së Madhe, ndërhyrjes së SHBA-së, kundërsulmit të BS-së dhe luftës partizane në të gjithë Europën, mësuesi/ja e ndan përsëri klasën në pesë grupe.

**Hapi i dytë:**

- Mësuesi/ja u kërkon grupeve të plotësojnë tabelën e mëposhtme, të cilën e ka përgatitur më parë.

**Grupi 1.**

| *Çfarë ka ndodhur?* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Dy kampe kundërshtare:<br>a - Boshti i Çeliktë<br>b - Aleanca e Demokracive Perëndimore | | | | |
| Pakti i Mossulmimit | | | | |
| Shpërthimi i Luftës (sulmi ndaj Polonisë) | | | | |

**Grupi 2.**

| *Çfarë ka ndodhur?* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Zgjerimi i veprimeve ushtarake në veri, perëndim e jug | | | | |
| Sulmi ndaj BS-së | | | | |
| Sulmi në Përl Harbër | | | | |

**Grupi 3.**

| Çfarë ka ndodhur**?** | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Kombet e Bashkuara | | | | |
| Pushtimi i Ballkanit | | | | |
| Tatëpjeta e ushtrisë naziste | | | | |

**Grupi 4.**

| *Çfarë ka ndodhur?* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Konferenca e Teheranit | | | | |
| Konferenca e Jaltës | | | | |
| Konferenca e Potsdamit | | | | |

**Grupi 5.**

| *Çfarë ka ndodhur?* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Kapitullimi i Italisë fashiste | | | | |
| Kapitullimi i Gjermanisë naziste | | | | |
| Dorëzimi i Japonisë dhe mbarimi i Luftës II Botërore | | | | |

**Hapi i tretë:**

- Pas përfundimit të detyrës një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.
- Diskutohen përgjigjet.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: III** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.1:**<br>**Bota pas Luftës së Dytë Botërore**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**Përpjekja për konsolidimin e paqes. Konferenca e Paqes e Parisit** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos hartën e re të Europës së Pasluftës dhe diskuton me nxënësit për ndryshimin e kufijve. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- liston vendimet kryesore të Konferencës së Paqes;<br>- përshkruan vendimet e Konferencës në lidhje me shtetet humbëse të Luftës së Dytë Botërore;<br>- argumenton rëndësinë e Gjyqit të Nurembergut. | | **Fjalë kyç:**<br>Konferenca e Paqes, vendimet, Gjyqi i Nurembergut, kriminelë lufte, dëmshpërblim | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për Luftën II Botërore, për Konferencën e Paqes në Paris dhe për Gjyqin e Nurembergut | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, të drejtat e njeriut, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Stuhi mendimesh**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të risjellin në mendje vendimet e Konferencës së Jaltës dhe Potsdamit, duke evidentuar krijimin e Gjykatës Ushtarake të Nurembergut për të dënuar krimet e kryera nga drejtuesit e ushtrisë naziste dhe për krijimin e OKB-së, me qëllim sigurimin e paqes në të ardhmen. Ai/ajo bën disa pyetje:

– Cilat ishin disa nga vendimet e konferencave që u mbajtën në Jaltë dhe Potsdam?

– Kur kapitulloi Gjermania naziste dhe si përfundoi shteti gjerman?

– Çfarë roli luajtën aleatët (ShBA, Angli, Francë, BS) në përfundimin e luftës?
Nxënësit japin përgjigjet e tyre dhe mësuesi/ja, pasi bën plotësimet e duhura, i përmbledh ato dhe i shkruan në tabelë.

**Hapi i dytë: Ditari dypjesësh**
Për ndërtimin e njohurive të reja, mësuesi/ja përdor teknikën "ditari dypjesësh", ku nxënësit dhe mësuesi/ja lexojnë nëntemat, ndërkohë që tabela ndahet në dy pjesë dhe shkruhet:

| Nëntema | Diskutime |
|---|---|
| - Konferenca e Paqes dhe pjesëmarrësit e saj | ➢ U mbajt në Paris nga 29 korriku deri në 15 tetor të vitit 1946.<br>➢ U organizua nga Fuqitë e Mëdha.<br>➢ Morën pjesë shtetet fituese; u thirrën edhe shtetet e Bllokut (Italia, Bullgaria, Hungaria, Rumania, Finlanda).<br>➢ U diskutuan shumë probleme që lidheshin me të ardhmen e Europës:<br>1. çështja e kufijve të shteteve;<br>2. dëmshpërblimi;<br>3. probleme të sigurimit të një paqeje të qëndrueshme. |
| - Vendimet e Konferencës së Paqes | ➢ U morën vendime dhe u nënshkruan disa traktate (traktati i paqes me Italinë dhe aleatët e saj).<br>➢ Çështja e kufijve: Kufijtë e Bashkimit Sovjetik u zgjeruan nga perëndimi, drejt Vendeve Baltike e rajoneve lindore të Polonisë, Finlandës dhe Rumanisë; ndryshime ndodhën edhe në territorin bullgar, rumun, italian etj.<br>➢ *Dëmshpërblimet*: Konferenca ngarkoi me dëmshpërblime Italinë dhe shtetet aleate të Bllokut. Përfituan nga dëmshpërblimet BS-ja, Greqia, Jugosllavia, Etiopia e Shqipëria.<br>➢ U vendos që Gjermania të çarmatosej dhe të ndahej në katër zona pushtimi nga vendet fituese (BS-ja, Britania e madhe, SHBA-ja dhe Franca); shtetet e Bllokut të kufizonin në maksimum forcat e tyre ushtarake. |
| - Gjyqi i Nurembergut | ➢ Gjyqi ushtarak dënoi krimet e nazizmit.<br>➢ U zhvillua nga 20 nëntori i vitit 1945 deri më 1 tetor 1946.<br>➢ U gjykuan 24 krerë të lartë nazistë (funksionarë të lartë të partisë naziste, të qeverisë, të ushtrisë, që akuzoheshin për krime ndaj njerëzimit dhe gjenocid.<br>➢ Ata u dënuan me vdekje, me burgosje të përjetshme ose me disa vite burgim. |

**Hapi i tretë: Diskutim**
Mësuesi/ja lexon pjesën "Thelloni njohuritë" së bashku me nxënësit, për të evidentuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në Konferencën e Paqes dhe të drejtën e saj për dëmshpërblim. Gjithashtu, për të siguruar që njohuritë e reja janë përthithur nga nxënësit, mësuesi/ja përdor pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Pas përgjigjeve, mësuesi/ja bën pyetje të tjera për të nxitur diskutime në klasë. Me këto diskutime synohet që nxënësit të aftësohen në përvetësimin jo vetëm të njohurive, por edhe të koncepteve dhe çështjeve kryesore të analizuara në klasë.

– A mendon se Gjyqi i Nurembergut ishte një proces i ligjshëm, që shënon fillimin e një procesi për denazifikimin e shoqërisë gjermane, apo një akt hakmarrjeje i fituesve kundër të mundurve? Pse?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Kërko të dhëna (në internet a në libra) për gjykatën që dënon krimet kundër njerëzimit sot.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: III | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.1:**<br>**Bota pas Luftës së Dytë Botërore**<br><br>**Tema mësimore:**<br>**OKB-ja dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos një foto të Eleonor Ruzveltit, me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut në dorë dhe diskuton me nxënësit rreth fotos (adresa e fotos me cilësi: *http://www.vmps.us/sites/default/files/eleanor_roosevelt_human_rights.jpg)* | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>- tregon me fjalët e tekstit krijimin e OKB-së dhe qëllimin e saj;<br>- përshkruan strukturën e OKB-së;<br>- analizon rëndësinë e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. | | **Fjalë kyç:**<br>OKB, karakter politik, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut | |
| **Burimet:**<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për OKB-në dhe DUDNJ | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>qytetari, të drejtat e njeriut | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Bashkëbisedim**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të rikujtojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore me miliona viktima nga të dyja kampet ndërluftuese, qytete e fshatra të shkatërruara krejtësisht, humbje të mëdha ekonomike dhe sociale. Po ashtu, mësuesi/ja pyet nxënësit të thonë ç'kanë dëgjuar për Organizatën e Kombeve të Bashkuara, rolin e saj në sigurimin e paqes, respektimin e të drejtave të njeriut dhe praninë e saj në vende të ndryshme të botës nëpërmjet programeve të ndryshme.

Mësuesi/ja së bashku me nxënësit diskutojnë për përfundimin dhe pasojat e Luftës II Botërore.

**Hapi i dytë: Skema e mendjes**

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "skema e mendjes" për ndërtimin e njohurive. Ai/ajo ndërton grafikun dhe e plotëson së bashku me nxënësit.



Më pas, mësuesi/ja kalon në nëntemën "Strukturat e OKB-së" dhe së bashku me nxënësit plotëson skemën e mëposhtme:




Pas plotësimit të skemës për strukturat e OKB-së, mësuesi/ja ritheksonse tmerret e Luftës së Dytë Botërore e kishin tronditur shumë shoqërinë. Kështu lindi nevoja për hartimin e një dokumenti të ri, që do t'i siguronte dhe garantonte njeriut të drejtat themelore, veçanërisht lirinë e tij. Më 10 dhjetor 1948, Asambleja e Përgjithshme miratoi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Ky dokument:

- u hartua nga një komision i përbërë nga 18 anëtarë me kombësi të ndryshme;
- përmban 30 artikuj dhe mbështetet në parimet e Revolucionit Amerikan dhe atij Francez;
- është plotësuar më pas me akte të tjera;
- ngrihet mbi parimin: "Njerëzit lindin të lirë e të barabartë";
- në mbrojtje të lirisë së individit, dënon çdo sjellje raciste apo persekutim ndaj ngjyrës, gjuhës, besimit, mendimit politik, diferencimit pasuror e çdo lloj qëndrimi diskriminues;
- vlerëson familjen si qelizën natyrore dhe themelin e shoqërisë;
- i shërbeu dhe i shërben edhe sot njerëzimit për vendosjen kudo të një sistemi të vërtetë demokratik të mbështetur në barazi, në respektimin e dinjitetit, në arsyen, vetëdijen dhe vëllazërimin mbarëbotëror.

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Mësuesi/ja për të siguruar që njohuritë e reja janë përthithur nga nxënësit përdor pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Pas përgjigjeve, mësuesi/ja bën pyetje të tjera për të nxitur diskutime në klasë. Me këto diskutime synohet që nxënësit të aftësohen në përvetësimin jo vetëm të njohurive, por edhe të koncepteve dhe çështjeve kryesore të analizuara në klasë.

– Si i ndihmon OKB-ja vendet me vështirësi dhe dobësi ekonomike?
– Pse kjo Deklaratë ka vlerë universale?
– Si e kuptoni shprehjen e Deklaratës se: "Familja vlerësohet si qeliza natyrore e shoqërisë"?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Ndahuni në dy grupe.

- *Grupi I.* Gjeni të dhëna për organizatën e UNESCO-s dhe UNICEF-it dhe bëni një përmbledhje për rolin dhe vlerën e tyre në mbështetje të fëmijëve dhe trashëgimisë kulturore.
- *Grupi II.* Gjeni të dhëna për organizatën e BERZH-it dhe FMN-së dhe bëni një përmbledhje për rolin e tyre.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.1:<br>Bota pas Luftës së Dytë Botërore</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja vendos foto me pamje nga qytete të djegura e të shkatërruara të Europës pas Luftës II Botërore dhe diskuton me nxënësit për pasojat shkatërrimtare të kësaj Lufte.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Rindërtimi i Europës pas Luftës. Roli i UNRRA-s, Planit Marshall dhe Doktrinës Truman</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- përshkruan planin e rimëkëmbjes ekonomike të Europës pas Luftës II Botërore;<br>- vë në dukje situatën e paqëndrueshmërisë politike pas Luftës II Botërore në Europën Lindore;<br>- analizon rolin e UNRRA-s, Planit Marshall dhe Doktrinës Truman për të ndihmuar Europën.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>Plani Marshall, UNRRA, Doktrina Truman</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për UNRRA-n, Planin Marshall, Doktrinën Truman</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>qytetari, të drejtat e njeriut</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Diskutim**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të rikujtojnë pasojat e Luftës së Dytë Botërore me miliona viktima nga të dyja kampet ndërluftuese, qytete të shkatërruara krejtësisht nga bombardimet dhe djegiet, humbje të mëdha ekonomike dhe sociale. Ai/ajo pyet:

– Cilat janë disa nga pasojat e Luftës së Dytë Botërore?

– Çfarë regjimesh u vendosën në Europën Perëndimore dhe Lindore?

– Sipas mendimit tuaj, çfarë nevojash kishin tashmë shtetet ndërluftuese pas përfundimit të Luftës?

Nxënësit japin përgjigjet dhe mendimet e tyre pasojat e Luftës II Botërore, nevojat për rindërtim të Europës, regjimet që u vendosën në Europën Perëndimore dhe Lindore. Mësuesi/ja mund të bëjë plotësime në përgjigjet e nxënësve, nëse është e nevojshme, dhe përfundon këtë pjesë të orës së mësimit, duke thënë se Europa kishte tashmë nevoja urgjente për rindërtimin dhe rimëkëmbjen ekonomike.

**Hapi i dytë: Ditari dypjesësh**

Mësuesi/ja, në këtë fazë të mësimit, përdor teknikën "Ditari dypjesësh" për ndërtimin e njohurive. Ai/ajo orienton nxënësit të lexojnë nëntemën e parë "Rindërtimi ekonomik dhe Plani Marshall" dhe ndërton tabelën e mëposhtme, të cilën e plotëson së bashku me nxënësit.

| Çështja | Komenti |
|---|---|
| Faktori i brendshëm | ➢ Që të gjitha shtresat e popullsisë dhe forcat politike punuan për rindërtimin e vendit të tyre.<br>➢ Në këtë transformim të madh ndihmoi dhe shkenca e teknika. |
| Faktori i jashtëm. | ➢ Vendet e pasura, të padëmtuara nga lufta, kryesisht SHBA-ja, u erdhën në ndihmë shteteve të dëmtuara të Europës.<br>➢ U krijua një organizatë ndërkombëtare (UNRRA), për të ndihmuar vendet e dëmtuara:<br>- shpërndau materiale që u nevojiteshin popujve për të kapërcyer gjendjen e jashtëzakonshme, si: ushqime, veshmbathje, ilaçe etj. |

| | |
|---|---|
| Plani Marshall | ➢ U miratua nga Kongresi Amerikan.<br>➢ Synonte që me anë të ndihmave financiare të riforconte shpejt ekonominë e Europës demokratike.<br>➢ Pengonte përhapjen e komunizmit dhe shtrirjen e ndikimit sovjetik në Europë.<br>➢ E përfituan vetëm shtetet e Europës Perëndimore.<br>➢ Europa Lindore nën ndikimin e BS-së e kundërshtoi dhe e refuzoi ndihmën amerikane. |

Më pas, mësuesi/ja kalon nëntemën e dytë "Europa Lindore, Blloku i vendeve socialiste" dhe ndërton përsëri tabelën e mësipërme:

| Çështja | Komenti |
|---|---|
| Regjimet e Europës Lindore dhe Jugore | ➢ Regjimet komuniste u vendosën menjëherë vetëm në Shqipëri dhe Jugosllavi.<br>➢ Në Bullgari, Rumani, Hungari u krijuan qeveri koalicioni.<br>➢ Në Greqi kishte shpërthyer lufta civile; komunistët pësuan disfatë.<br>➢ Nga rivaliteti ndërmjet forcave politike, partitë komuniste nuk erdhën menjëherë në pushtet; (në Poloni, Çekosllovaki, Hungari, Bullgari e Rumani) u ndihmuan nga ushtria sovjetike për të marrë pushtetin.<br>➢ Partitë komuniste në këto vende vendosën diktaturën nën një vel demokratik; u quajtën "demokraci popullore".<br>➢ U krijua tabloja politike e shteteve në Lindje. |

Nëntema "Doktrina Truman" është nëntema e fundit që mësuesi/ja dhe nxënësit trajtojnë me komente.

| Çështja | Komenti |
|---|---|
| Doktrina Truman | ➢ Platformë për ndihmë ekonomike dhe ushtarake<br>➢ SHBA-ja angazhohej të ndihmonte financiarisht dhe ushtarakisht të gjitha vendet, qeveritë e të cilave përballeshin me rrezikun komunist.<br>➢ Do të ndërhynte për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë e vendeve të Europës Perëndimore, që nuk bënin pjesë në Bllokun Socialist.<br>➢ Shënon edhe fillimin e Luftës së Ftohtë. |

**Hapi i tretë: Punë me tekstin**

Me qëllim përforcimin e njohurive të reja nga nxënësit, mësuesi/ja përdor pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Pas përgjigjeve, mësuesi/ja bën pyetje të tjera për të nxitur diskutime në klasë. Me këto diskutime synohet që nxënësit të aftësohen në përvetësimin jo vetëm të njohurive, por edhe të koncepteve dhe çështjeve kryesore të analizuara në klasë.

– Pse Plani Marshall do të ndikonte për të penguar përhapjen e komunizmit?

– A ishte një shans i humbur për Europën Plani Marshall?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Kërko dhe gjej të dhëna për programet ekonomike nga të cilat përfitoi Shqipëria dhe bëj një përmbledhje.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: III</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.2:<br>Lufta e Ftohtë<br><br>Tema mësimore:<br>SHBA-ja dhe Bashkimi Sovjetik. Lufta e Ftohtë</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Mësuesi/ja vendos hartën e Europës (f. 74) dhe diskuton me nxënësit për ndarjen e saj në dy kampe politike (shtete me demokraci dhe ato nën ndikimin e BRSS-së).</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>- përkufizon termin "Luftë e Ftohtë";<br>- evidenton dallimin mes dy blloqeve kundërshtare;<br>- argumenton epërsitë e sistemit demokratik në Europën Perëndimore ndaj sistemit totalitar në Europën Lindore.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>ekonomi kapitaliste, ekonomi e centralizuar, shtrirje ndikimi, Luftë e Ftohtë, superfuqi</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti, interneti, enciklopedia, materiale të ndryshme për UNRRA-n, Planin Marshall, Doktrinën Truman</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>qytetari, të drejtat e njeriut, ekonomi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Diskutim me përmbledhje**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të thonë çfarë dinë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe për Bashkimin Sovjetik. Ai/ajo ndërton një tabelë dhe u kërkon nxënësve të plotësojnë atë.

| Përshkrimi | ShBA | BS |
|---|---|---|
| Qeverisja | | |
| Sistemi ekonomik | | |
| Roli që luajtën në LIIB | | |
| Vendimet e udhëheqësve të tyre në Konferencat e Jaltës dhe Potsdamit | | |
| Plani Marshall dhe UNRRA | | |
| Koalicioni Antifashist | | |

Pas plotësimit të kësaj tabelë së bashku me nxënësit, mësuesi/ja kalon në hapin e dytë të mësimit, ndërtimit të njohurive.

**Hapi i dytë: Di-dua të di-mësova**

Në këtë fazë të mësimit, mësuesi/ja përdor teknikën "Di-Dua të di-Mësova" për ndërtimin e njohurive. Ai/ajo orienton nxënësit të tekstin për disa minuta dhe plotëson së bashku me ta tabelën e mëposhtme.

| Di | Dua të di | Mësova |
|---|---|---|
| Njohuritë që kanë nxënësit për këto dy superfuqi botërore, zhvillimin e | ➢ Ç'ndodh me këto dy superfuqi pas Luftës së Dytë Botërore, duke u nisur edhe nga vendimet e Konferencës së Paqes; | ➢ Europa u varfërua, u shkatërrua, u dobësua pas Luftës; humbi forcën koloniale nga lindja e shteteve të pavarura<br>➢ Fatin e botës e vendosën dy superfuqitë (ShBA, BS), që dallonin shumë nga njëra-tjetra, si në jetën ekonomike, ashtu edhe në fushën politike e sociale.<br>➢ Aleate të Luftës kundër fashizmit u bënë kundërshtare. |

| | | |
|---|---|---|
| tyre ekonomik, sistemin politik dhe qeverisjen; aleancat dhe rolin e tyre në Luftën e Dytë Botërore | ➢ Sistemet politike që u vendosën;<br>➢ Si u nda Europa në kampe politike pas Luftës<br>➢ Çfarë ishte Lufta e Ftohtë | ➢ **ShBA-ja** shtet demokratik, pluralist, me ekonomi kapitaliste. Baza e ekonomisë ishte prona private dhe tregu i lirë që zhvillohej mbi bazën e konkurrencës së lirë.<br>➢ **BS-ja**, shtet totalitar, monist (pushteti ishte në duart e një partie që kontrollonte të gjithë jetën e vendit). Baza e ekonomisë mbështetej në ekonominë shtetërore, të centralizuar. |
| Europa u nda në dy kampe politike | ➢ Cilat ishin kampet kundërshtare | ➢ BS-ja kishte krijuar në Europën Lindore një varg shtetesh me regjime komuniste, si Polonia, Çekosllovakia, Hungaria, Rumania, Bullgaria e Shqipëria, që vareshin politikisht e ekonomikisht prej saj; krijuan Traktatin e Varshavës për t'u përballur me NATO-n (përjashtim bënte Jugosllavia, që iu shmang varësisë nga BS-ja).<br>➢ Shtetet e Europës Perëndimore gjendeshin vazhdimisht të kërcënuara nga komunizmi; u krijua një aleancë ushtarake, NATO-ja, që kishte qëllime mbrojtëse; me armik të përbashkët, që ishte komunizmi dhe rreziku i përhapjes së tij. |
| Nisi Lufta e Ftohtë mes dy blloqeve kundërshtare | ➢ Çfarë ishte Lufta e Ftohtë?<br>➢ Si nisi ajo dhe pse vazhdoi për më shumë se 40 vjet?<br>➢ Çfarë e ushqente këtë luftë? | ➢ Një gjendje plot tensione e presione, që u zhvillua ndërmjet dy blloqeve për afro 40 vjet rresht; nuk u shndërrua asnjëherë në ndeshje drejtpërdrejt të armatosur; herë acarohej, herë zbutej.<br>➢ Të dyja blloqet kërcënonin, akuzonin e shpifnin për njëri-tjetrin.<br>➢ Ndarja e Europës në Lindore e Perëndimore, krijimi i blloqeve, ushtarake, gara e armatimeve dhe konfliktet lokale e mbanin gjallë Luftën e Ftohtë. |

**Hapi i tretë: Marrëdhënie pyetje-përgjigje**

Me qëllim përforcimin e njohurive të reja nga nxënësit, mësuesi/ja përdor pyetjet e rubrikës "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime". Pas përgjigjeve, mësuesi/ja bën pyetje të tjera për të nxitur diskutime në klasë. Me këto diskutime synohet që nxënësit të aftësohen në përvetësimin jo vetëm të njohurive, por edhe të koncepteve dhe çështjeve kryesore të analizuara në klasë.

– Pse quhet "Lufta e Ftohtë"?

– Pse në shtetet e Europës Lindore u vendosën regjimet komuniste. Cilët faktorë ndikuan?

## ► Vlerësimi

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrjen në diskutime që zhvillohen në klasë, për kontributin dhe aktivizimin e tyre në ndërtimin e njohurive të reja, në saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruani një ese të shkurtër me 10-15 fjali me temë "Pse Lufta e Ftohtë nuk u shndërrua në një konflikt të armatosur".

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.2:**<br>**Lufta e Ftohtë**<br>**Tema mësimore:**<br>**Momentet kryesore gjatë Luftës së Ftohtë** | | **Situata e të nxënit:**<br>Foto nga "momentet e nxehta" të përballjes mes dy blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon mënyrat e përballjes të dy blloqeve;<br>• analizon krizat gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë;<br>• rendit në radhë kronologjike krizat mes dy blloqeve;<br>• shfaq qëndrimin e tij për Luftën e Ftohtë. | | **Fjalë kyç:**<br>ballafaqime në distancë, përballje forcash, "Lufta e Yjeve" | |
| **Burimet:**<br>Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime nga përballja mes dy blloqeve | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, fizikë | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimi**

Mësuesi/ja i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur për Luftën e Ftohtë:

– Pse lufta mes dy blloqeve u quajt "Luftë e Ftohtë"?
– Analizoni fjalinë "SHBA-ja dhe BS-ja vendosnin fatin e botës".
– Cilat ishin përpjekjet e dy superfuqive për të rritur ndikimin e tyre në Europë dhe botë?
– Përshkruaj tiparet e Luftës së Ftohtë?

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* - **Lexim i drejtuar**

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje dy pjesët e para të temës: "Ashpërsime dhe vetëpërmbajtje" dhe "Ballafaqime në distancë" dhe të gjejnë përgjigjet për pyetjet:

– Pse dy superfuqitë shpenzonin për armatime?
– Pse nuk u zhvillua një luftë të armatosur mes tyre?
– Cilat janë veçoritë e konkurencës në planin ushtarak?
– Cilat janë veçoritë e konkurencës në planin politik dhe ekonomik?

Pasi nxënësit kanë përfunduar leximin japin përgjigjet për pyetjet. Mësuesi/ja i kërkon që nxënësit të lexojnë fjalitë që vërtetojnë përgjigjet e tyre.

Ai/ajo i orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje pjesën e tretë të temës: "Përballja e forcave të të dy blloqeve" dhe të gjejnë përgjigjet për pyetjet:

– Cilat ishin ballafaqimet më të ashpra mes dy blloqeve?
– Cilat ishin tiparet e krizës greke? Kur përfundoi ajo?
– Pse u shkaktua kriza e Berlinit?
– Pse bllokada ekonomike e Berlinit nuk ia arriti qëllimit?
– Në cilën nga krizat arriti kulmin ballafaqimi i dy superfuqive?
– Cilat janë pasojat e ballafaqimeve?

Rendisni sipas kronologjisë ngjarjet, si: kriza greke, Kriza e Berlinit, Kriza koreane, Kriza e Vietnamit dhe e Kubës.

Pasi nxënësit kanë përfunduar leximin japin përgjigjet për pyetjet. Mësuesi/ja u kërkon atyre që të lexojnë fjalitë që vërtetojnë përgjigjet e tyre.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Ditarët e të nxënit**
Mësuesi/ja fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes, në njërën anë ata të shkruajnë ngjarjet dhe në anën tjetër të shkruajnë një koment. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja përdor teknikën e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për pikat e nxehta të luftës së ftohtë.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Bëj një ese ku të interpretosh shprehjen e Armstrongut drejtuar njerëzimit: "Ky është një hap i vogël për një njeri, por një hap gjigant për njerëzimin."

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3:**<br>**Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë**<br>**Tema mësimore:**<br>**Britania e Madhe në vitet 1945–1974** | | **Situata e të nxënit:**<br>Foto nga "momentet e nxehta" të përballjes mes dy blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan tiparet kryesore të organizimit ekonomik të Britanisë së Madhe;<br>• krahason programin e Partisë Laburiste me atë të Partisë Konservatore dhe evidenton ndryshimet mes tyre;<br>• analizon shkaqet e dështimit të programit laburist;<br>• argumenton rëndësinë e ndërrimit të pushteteve. | | **Fjalë kyç:**<br>ballafaqime në distancë, përballje forcash, "Lufta e Yjeve" | |
| **Burimet:**<br>Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimi**
Mësuesi/ja i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur për Luftën e Ftohtë:
– Britania e Madhe u rendit ndër vendet fituese apo humbëse të Luftës I Botërore?
– Cili ishte roli i Britanisë në këtë luftë?
– Cili ishte qëndrimi i Britanisë ndaj Luftës së Ftohtë?

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Mbajtja e strukturuar e shënimeve**
Mësuesi/ja orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Mbajtja e strukturuar e shënimeve", e cila ka si qëllim mbajten në mënyrë efikase të shënimeve dhe realizohet me anë të skemës (organizuesit grafik). Mësuesi/ja bën skemën në tabelë dhe orienton nxënësit se çfarë duhet të përfshihet në skemë. Cilat janë pasojat e ballafaqimeve?

**Britania e Madhe**

*Problemi/Zgjidhja*
**Ndërtimi i shtetit të mirëqenies:** Programi i Partisë Laburiste që u premtua në zgjedhjet e vitit 1945.
**Realizimi:** shtetëzimi i degëve kryesore të ekonomisë dhe përmirësimi i thellë i shërbimit social.
**Zhgënjimi i elektoratit:** erdhi si pasojë e masave të rrepta në ekonomi dhe veçanërisht në sistemin e taksave, siç ishin taksat progresive. Partia Konservatore mbështeste lirinë ekonomike dhe privatizimin e sektorit shtetëror.

*Ngjashmëri/ Ndryshime*
- Programi laburist
- Programi konservator

**Partia Laburiste** ndërmori masa të rrepta në ekonomi dhe veçanërisht në sistemin e taksave.

**Partia Konservatore** ndoqi një politikë të matur, të kombinuar, ku privatizimi i sektorëve shtetërorë u bë me ngadalë dhe vazhduan ndërtimet për të plotësuar nevojat e banimit të shtresave të ndryshme sociale.

*Shkak/pasojë*
**Partia Laburiste** nuk fitoi zgjedhjet e vitit 1951. Masat e marra (shtetëzimet dhe taksat) ishin të ashpra.
**Partia Konservatore** qëndroi në pushtet nga viti 1951–1964, ndoqi një politikë të matur, të kombinuar, ku privatizimi i sektorëve shtetërorë u bë më ngadalë dhe vazhduan ndërtimet për të plotësuar nevojat e banimit të shtresave të ndryshme sociale.
Afërsia në programe dhe politikat e ndjekura nga dy partitë sollën alternimin e pushteteve midis tyre.

*Qëllimi/Veprimi/Përfundimi*

Ndërtimi i shtetit të mirëqenies sociale.

Gara mes dy partive për të fituar zgjedhjet bëri që këto parti të përafroheshin në programe dhe mënyrën e qeverisjes.

Pavarësisht ndryshimeve në programin e dy partive, të dyja ndërtuan dhe ruajtën shtetin e mirëqenies sociale.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**
Mësuesi/ja fton nxënësit që të diskutojnë rreth çështjeve:
- drejtimet kryesore të programit të laburistëve për shtetin e mirëqenies;
- grupet shoqërore që ndihmonte shteti i mirëqenies sociale;
- veçoritë e politikës së jashtme të Britanisë etj.

## ► Vlerësimi
Mësuesi mban shënime në evidencë për disa nxënës që demostrojnë njohuri rreth programeve dhe mënyrës së qeverisjes së dy partive në Britaninë e Madhe, aftësi për të kuptuar, për të interpretuar dhe për të analizuar informacionin.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur
Gjeni të dhëna në internet për rolin e Çërçillit në Luftën II Botërore. Shiko dhe pamjen e pritjes madhështore të tij dhe bëj një ese, ku të argumentosh pse populli i dha votën Partisë Laburiste.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.3:<br>Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Informacion për figurën e Sharl de Golit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Franca në vitet 1945–1974</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan Francën në vitet 1944–1953;<br>• identifikon masat e marra për rimëkëmbjen e ekonomisë;<br>• analizon situatën politike në Francë;<br>• krahason Republikën e IV me Republikën e V dhe evidenton ndryshimet;<br>• shfaq qëndrimin e tij për jetën politike në Francë.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>ballafaqime në distancë, përballje forcash, "Lufta e Yjeve"</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* - **Di-Dua të di-Mësova**

Mësuesi/ja pasi shënon temën në tabelë, u bën me dije nxënësve se metodën me të cilën do të realizojnë këtë temë mësimore. Gjithashtu ndërton organizuesin grafik në tabelë. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të japin mendimin e tyre për çfarë dinë ose mendojnë se dinë për Francën. Për të ndihmuar nxënësit, ai/ajo i orienton me anë të pyetjeve:
– Ç'qëndrim mbajti Franca gjatë Luftës II Botërore?
– Cilat ishin goditjet që mori gjatë kësaj lufte?
– Në ç'gjendje ishte Franca pas Luftës II Botërore?

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* - **Di-Dua të di-Mësova**

Pasi është plotësuar kolona **Di**, mësuesi/ja i pyet nxënësit se çfarë do të donit të dinit për Francën në vitet 1945–1974 dhe nxënësit japin mendimet e tyre si:
– A mundi Franca të kapërcejë pasojat e luftës?
– Cilat janë forcat politike që qeverisën Francën pas Lufte?
– Cilat janë figurat historike të kësaj periudhe?
– Tiparet e jetës politike dhe ekonomike në Francë.

Mësuesi/ja shënon në kolonën **Dua të di** çështjet apo pyetjet e nxëësve.

Mësuesi/ja fton nxënësit që të gjejnë informacionin që u përgjigjet pyetjeve të tyre në tekst ose që i ndihmon për të kuptuar. Kur nxënësit përfundojnë leximin, mësuesi/ja i pyet nxënësit për informacionin e gjetur dhe e shkruan atë në kolonën e tretë **Mësova**.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**

Punohet me rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime".

### ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi/ja ka fituar njohuri dhe aftësi për situatën politike dhe ekonomike në Francën e viteve 1945–1974.

### ► Detyrat dhe puna e pavarur

Kërkoni të dhëna për planifikimin e ekonomisë në BS dhe në Francë dhe nxirrni dallimet.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3:**<br>**Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë**<br>**Tema mësimore:**<br>**Republika Federale Gjermane në vitet 1945-1974** | | **Situata e të nxënit:**<br>Mësuesi/ja vendos hartën e Gjermanisë, ku pasqyrohet ndarja e saj në dy shtete: RFGJ dhe RDGJ. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan Gjermaninë e dalë nga lufta;<br>• identifikon ndarjet territoriale dhe politike të Gjermanisë;<br>• analizon faktorët që ndikuan në zhvillimin ekonomik e politik të RFGJ-së. | | **Fjalë kyç:**<br>Gjermania pas Luftës, zhvillimi ekonomik, RFGJ-ja, shtet i lirë, i pavarur | |
| **Burimet:**<br>teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

### ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Përvijim i të menduarit**

- Mësuesi/ja pasi shënon temën në tabelë, nxit diskutimin për situatën ekonomike e politike në Gjermaninë e Pasluftës II Botërore.
- Më pas mësuesi/ja i kërkon nxënësve që të lexojnë për disa minuta pjesën "Gjermania pas Luftës" dhe i fton ata në diskutim, ndërkohë që ka ndërtuar në tabelë skemën e përvijimit të të menduarit.
- Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe dhe i shpërndan fletë A4 dhe i udhëzon të plotësojnë tabelën.
- Grupet plotësojnë tabelën.




**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Shënime mbi shënime**

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të ndarë në grupe të lexojnë për pak minuta "Zhvillimi i shpejtë ekonomik i

RFGj-së" dhe "RFGj-ja, shtet i lirë dhe i pavarur". Pas leximit, mësuesi/ja i udhëzon të plotësojnë skemën. Ideve ose kategorive kryesore u vendos treguesin 1 në radhitje, ndërsa detajeve u vendos treguesit 2, 3.

**1. RFGJ**
2. Rimëkëmbja:
3. Hartoi një plan për zhvillimin ekonomik.
3. Ndërmori reforma të rëndësishme ekonomike, shoqërore e financiare.
3. Populli gjerman u mobilizua dhe iu nënshtrua një disipline të hekurt për të kaluar vështirësitë.
3. Plani Marshall.
2. Mrekullia ekonomike gjermane:
3. u ul papunësia,
3. dyqanet u mbushën me mallra;
3. u zhvillua tregu i lirë;
3. u zhvilluan shumë degë të industrisë.
2. Shtet i lirë dhe i pavarur
3. Në vitin 1951, RFGJ-ja u pranua në Këshillin e Europës.
3. Në vitin 1952 u hoq gjendja e pushtimit dhe mori fund kontrolli ushtarak prej aleatëve.
3. Në vitin 1955, RFGJ-ja u pranua në NATO.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Diskutimi**
Punohet me rubrikën "Kontrolloni-Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime".

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për situatën politike dhe ekonomike në Republikën Federale Gjermane.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Lexo hartën *Pushtimi i Gjermanisë nga aleatët dhe Kriza e Berlinit*. Duke u mbështetur në legjendën e saj gjurmo dhe nxirr të dhënat historike që zbulon në këtë hartë.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Historì 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3:**<br>**Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë**<br>**Tema mësimore:**<br>**Italia në vitet 1945-1974** | | **Situata e të nxënit:**<br>Nxënësit sjellin informacion për ndryshimet në zhvillimin ekonomik mes Veriut dhe Jugut të Italisë, të shoqëruar me foto. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan situatën politike dhe ekonomike në Italinë e Pasluftës;<br>• analizon faktorët që ndikuan në zhvillimin ekonomik e politik të Italisë;<br>• rendit shkaqet e ndryshimit në zhvillimin ekonomik mes Veriut dhe Jugut të Italisë. | | **Fjalë kyç:**<br>Italia pas Luftës, zhvillim ekonomik, republikë | |
| **Burimet:**<br>teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Përvijim i të menduarit**

- Mësuesi/ja pasi shënon temën në tabelë, nxit diskutimin për situatën ekonomike e politike në Gjermaninë e Pasluftës II Botërore.
- Më pas mësuesi/ja i kërkon nxënësve që të lexojnë për disa minuta pjesën "Gjermania pas Luftës" dhe i fton ata në diskutim, ndërkohë që ka ndërtuar në tabelë skemën e përvijimit të të menduarit.
- Mësuesi/ja e ndan klasën në grupe dhe i shpërndan fletë A4 dhe i udhëzon të plotësojnë tabelën.
- Grupet plotësojnë tabelën.

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* - **Shkrimi i lirë**
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që bazuar në njohuritë që kanë, të përshkruajnë gjendjen në Italisë në përfundim të Luftës II Botërore.
Pas përfundimit të detyrës nxënësit diskutojnë rreth përgjigjeve dhe krijohet një panoramë rreth gjendjes së Italisë në përfundim të Luftës së II Botërore.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* - **Sistemi ndërveprues i shënimeve – INSERT**
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në një fletë A4 apo fletoreje të ndërtojnë skemën e INSERT-it dhe e ndan klasën në 4 grupe. Mësuesi/ja sqaron nxënësit se do të lexojnë "Italia pas Luftës dhe forma e regjimit" "Zhvillimi i shpejtë ekonomik" dhe do të vendosin në tekst shenjat:

- ✓ Për informacionin që njohin; (-) në rastet kur informacioni që ata dinin është i ndryshëm nga ai në tekst apo që e kundërshton atë; (+) për informacionin e ri; (?) për informacionin e paqartë.

Nxënësit lexojnë individualisht tekstin dhe vendosin përbri shenjat. Më pas nxënësit diskutojnë për shenjat e vendosura dhe në fund ndërtojnë tabelën e mëposhtme:

| ✓ | – | + | ? |
|---|---|---|---|
| Italia doli nga lufta me një ekonomi të dëmtuar rëndë.<br><br>Monarkia italiane kishte bashkëpunuar me fashizmin.<br><br>Italia vuante dhe nga mungesa e organizimit politik brenda vendit.<br><br>Paqëndrueshmëri politike<br>Turizmi pati zhvillime të vrullshme.<br>Lëvizja e popullsisë nga Jugu drejt Veriut. | Përfshirja e Italisë në Planin Marshall.<br>............................ | Kishte shumë parti politike dhe qeveritë ndërroheshin shpesh.<br>Partia Kristiandemokrate luante rol kryesor në jetën politike.<br><br>Në referendumin e 2 qershorit të vitit 1946 italianët votuan për republikën.<br><br>Ekonomia italiane e pasluftës njohu ritme shumë të larta zhvillimi. | Hendeku mes Veriut e Jugut u thellua gjatë viteve '50–'60.<br>............................ |

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Diskutimi**
Një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.
Punohet me rubrikën "Kontrolloni–Mendoni–Arsyetoni–Gjurmoni–Nxirrni përfundime".

## ► Vlerësimi

Vlerësimi i punës në grup. Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për situatën politike dhe ekonomike në Italinë e Pasluftës.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Komento hartën *Lëvizja e popullsisë drejt Veriut,* duke përcaktuar territoret më të zhvilluara dhe më të prapambetura.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.3:<br>Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Foto të presidentëve të SHBA-së: Truman, Kenedi, Xhonson, Nikson</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>SHBA në vitet 1945–1974</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton veçoritë ekonomike e politike të SHBA-së në vitet 1945-1960;<br>• analizon tiparet e politikës së brendshme dhe të jashtme të presidentëve të SHBA-së;<br>• rendit presidentët e SHBA-së sipas kohës që kanë qeverisur.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>qëndrueshmëri politike, Plani Marshall, Doktrina Truman</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:<br>qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimesh**

Për të bërë lidhjen e temës me njohuritë që kanë nxënësit, mësuesi/ja u drejton atyre pyetje:

– Pse ekonomia e SHBA-së nuk u shkatërrua nga Lufta e II Botërore?

– Cila ishte forma e qeverisjes së SHBA-së para dhe pas Luftës?

– Cili ishte roli i SHBA-së pas Luftës?

Përgjigjet e nxënësve diskutohen dhe, për informacionet e pasakta që nxënësit kanë, mësuesi/ja bën sqarimet e nevojshme.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Analiza e tipareve semantike**

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të lexojnë tekstin dhe të shënojnë në fletore emrat e presidentëve të SHBA-së dhe veçoritë e politikës së brendshme dhe të jashtme të saj.

Më pas, mësuesi/ja së bashku me nxënësit modelojnë analizën e tipareve semantike, duke vendosur në shtyllën vertikale emrat e presidentëve të SHBA-së në vitet 1945–1974 dhe në secilën nga shtyllat horizontale shënojnë veçoritë e politikës së brendshme dhe të jashtme të SHBA-së.

Përgjigjet e nxënësve diskutohen dhe, për informacionet e pasakta që nxënësit kanë, mësuesi/ja bën sqarimet e nevojshme.

| Kategoria: Presidentë | Koha e qeverisjes | Rritje ekonomike | Shteti i mirëqenies | Ndihmoi vendet e tjera të rimëkëmbeshin pas Luftës | Shpenzimet ushtarake dhe për hapësirën kozmike | Njohu barazinë dhe të drejtat e njerëzve me ngjyrë | Luftë kundër përhapjes së komu-nizmit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Hari Truman | 1945–1953 | + | + | + | - | - | + |
| Duajt Ajzenhauer | 1953–1961 | + | + | - | + | - | + |
| Xhon Kenedi | 1961–1963 | + | + | - | + | - | + |
| Lindon Xhonson | 1963–1968 | + | + | - | + | + | + |
| Riçard Nikson | 1968–1974 | | | | - | | - |

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Rrjeti i diskutimit**
Nxënës të ndryshëm prezantojnë dhe argumentojnë punën e bërë për karakteristikat e qeverisjes së SHBA nga presidentët H. Truman, D. Ajzenhauer, Xh. Kenedi, L. Xhonson, R. Nikson.
Punohet në grup me rubrikën "Kontrolloni-Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime".

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për SHBA-në në vitet 1945–1974.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Përcakto dhe jep vlerësimin tënd për tiparin themelor të jetës politike në SHBA. Argumento mendimin tënd.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3:** **Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë**<br>**Tema mësimore:** **Zhvillimet në vendet e tjera të Europës Perëndimore** | | **Situata e të nxënit:** Foto që pasqyrojnë zhvillimin ekonomik të vendeve, si: Holanda, Belgjika, Zvicra, Austria, Suedia, Norvegjia e Danimarka. | |
| **Rezultatet e të nxënit:** Nxënësi/ja:<br>• evidenton dallimet në zhvillimin e ekonomik të vendeve të tjera të Europës;<br>• tregon faktorët që ndikuan në këtë ndryshim;<br>• përshkruan veçoritë e këtyre shteteve gjatë viteve të krizës së viteve '70-'80. | | **Fjalë kyç:** qëndrueshmëri ekonomike, kriza e naftës | |
| **Burimet:** teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:** gjeografi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimesh**
– Cili ishte pozicioni i Holandës e Belgjikës në Luftën e II Botërore?
– Pse Zvicra nuk pasoja të rënda nga lufta?
– A morën pjesë në luftë vendet si Austria, Suedia, Norvegjia e Danimarka?
– Pse Suedia, Norvegjia nuk patën pasoja të rënda nga lufta?
– A mundën Holanda e Belgjika të ruanin kolonitë e tyre pas Luftës? Po/jo, pse?

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Ditarët e të nxënit**
Mësuesi/ja i orienton nxënësit të lexojnë në tekst pjesën "Zhvillimi ekonomik në vendet e tjera të Europës Perëndimore në vitet '50–'60" dhe të nënvizojnë çështjet dhe treguesit e zhvillimit të këtyre shteteve në vitet '50–'60 e më pas t'i shënojnë në kolonën "Çështjet".
Pas nxjerrjes së çështjeve mësuesi/ja iu jep kohë nxënëxsve të bëjnë komentet dhe ti shënojnë në kolonën "komente".

| **Çështja** | **Komenti** |
|---|---|
| Pse zhvillimi ekonomik në Holandës e Belgjikës ishte i ngadaltë? | - Holanda dhe Belgjika u dëmtuan më shumë, ndërsa vendet e tjera më pak.<br>- Në vitet e para ato punuan për rimëkëmbjen e vendit. |
| Ritmi i zhvillimit të ekonomisë në Zvicër ishte i shpejtë. | - Zvicra ishte shtet neutral, prandaj nuk u dëmtua shumë nga Lufta.<br>- Ritmet e saj të zhvillimit ekonomik u përshpejtuan në fund të viteve '50. |
| Pse në Austri ritmet e shpejta të zhvillimit ekonomik zgjatën më shumë se në vendet e tjera? | - Gjatë viteve '50 pati një zhvendosje drejt zhvillimit industrial. |
| Faktorët që ndikuan në zhvillimin e Suedisë, Norvegjisë dhe Danimarkës në vitet 1958–1964 | - Suedia dyfishoi eksportin e mallrave të saj.<br>- Norvegjia kishte shumë të zhvilluar flotën tregtare dhe atë të peshkimit.<br>- Bujqësia ishte shumë e zhvilluar. |

- Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për "Zhvillimi ekonomik i këtyre vendeve në vitet '70–'80".

**Hapi i tretë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Punë në grupe**
Pas përfundimit të detyrës nxënësit diskutojnë dhe vlerësojnë çështjet e ngritura dhe komentet për çdo çështje. Punohet në grupe me rubrikën "Kontrolloni- Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime".

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për të evidentuar dhe për të analizuar veçoritë e zhvillimit ekonomik të vendeve të tjera të Europës Perëndimore pas Luftës II Botërore dhe në vitet '70–'80.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Analizoni veçoritë e zhvillimit ekonomik në vendet e tjera të Europës Perëndimore.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3:**<br>**Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë**<br>**Tema mësimore:**<br>**Bashkimi Sovjetik gjatë viteve 1945–1990** | | **Situata e të nxënit:**<br>Foto të udhëheqësve të BS-së në vitet 1945-1990, Stalinit, Hrushovit, Brezhnjevit, dhe përshkrimi i figurës së tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan situatën ekonomike në BS pas Lufte;<br>• evidenton masat e marra për rimëkëmbjen e ekonomisë pas luftës;<br>• analizon qeverisjen e BS-së nga Stalini;<br>• krahason dhe evidenton ndryshimet në qeverisjen e vendit nga Stalini, Hrushovi, Brezhnjevi. | | **Fjalë kyç:**<br>Dorë e hekurt, Kursi i Ri i Hrushovit, shtet totalitar, polici sekrete, kult individi, bashkekzistencë paqësore. | |
| **Burimet:**<br>teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Di-Dua të di-Mësova**

**Stuhi mendimi**

Mësuesi/ja pyet nxënësit për të evidentuar njohuritë që kanë nxënësit, që do t'i shërbejnë lidhjes së njohurive që kanë me njohuritë e reja.

– Cili ishte roli i BS-së në Luftën e II Botërore?
– Pse BS-ja pati pasoja të rënda nga lufta?
– Cilat degë të ekonomisë u prekën më shumë? Pse?
– Cili ishte roli i BS në Luftën e Ftohtë?
– Sa dhe si ndikoi Lufta e Ftohtë në zhvillimin ekonomik të BS-së?

Nxënësit japin mendimet e tyre rreth pyetjeve.
Diskutohen përgjigjet e dhëna dhe përgjigjet e sakta shënohen në kolonën **"Di"**.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Di-Dua të di-Mësova**

Mësuesi/ja pyet nxënësit se cilat janë informacionet që do të duan të dinë për temën. Nxënësit përgjigjen:

– Pasojat e luftës për BS-në.
– Masat që u morën për kapërcimin e tyre dhe rindërtimin e ekonomisë.
– Qeverisjen e BS-së nga Stalini.
– A pati ndryshime në mënyrën e qeverisjes së BS-së?
– Cilët ishin udhëheqësit e BS-së në vitet 1945-1990?

Të gjitha pyetjet/çështjet e ngritura nga nxënësit shënohen në kolonën **"Dua të di"**.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Di-Dua të di-Mësova**

Nxënësit lexojnë në tekst dhe gjejnë përgjigjet e pyetjeve apo çështjeve të ngritura dhe këto i vendosin në kolonën **"Mësova"**.

Nxënësit prezantojnë punën e bërë.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për të evidentuar dhe analizuar veçoritë e zhvillimit ekonomik e politik në BS në vitet 1945-1990.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej të dhëna në internet për kultin e individit të Stalinit dhe, me ndihmën e prindërve, kërko figura të tjera në histori që janë të ngjashme me të.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3:**<br>**Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë** | | **Situata e të nxënit:**<br>Informacion për marrëdhëniet e BS-së me vendet e Europës Lindore | |
| **Tema mësimore:**<br>**Marrëdhëniet ekonomike: Europa Lindore - BS** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• tregon strukturën e ekonomisë në vendet e Europës Lindore;<br>• evidenton ndryshimet në politikën e këtyre vendeve nën ndikimin e BS-së;<br>• analizon ndërhyrjen e Moskës në lëvizjet popullore në vendet e lindjes;<br>• krahason vijën politike të Gomulkës në Poloni me atë të Kadarit në Hungari dhe gjej ndryshimet. | | **Fjalë kyç:**<br>planifikim dhe centralizim i ekonomisë, KNER, rebelim, politikë liberale. | |
| **Burimet:**<br>informacioni që nxënësit kanë, teksti, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:**<br>gjeografi, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimi**
Mësuesi/ja i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur për Luftën e Ftohtë:
– Cilat janë vendet që bëjnë pjesë në Europën Lindore?
– Cili ishte qëndrimi i tyre në Luftën e Dytë Botërore?
– Pse në vendet e Europës Lindore u vendos komunizmi?
– Shpjego lidhjen mes këtyre vendeve dhe BS-së.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Mbajtja e strukturuar e shënimeve**
Mësuesi/ja orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Mbajtja e strukturuar e shënimeve", e cila ka si qëllim mbajtjen në mënyrë efikase të shënimeve dhe realizohet me anë të skemës (organizuesit grafik). Mësuesi/ja bën skemën në tabelë dhe orienton nxënësit se çfarë duhet të përfshihet në skemë. Mësuesi/ja në bashkëpunim me nxënësit evidentojnë në tekst çështjet dhe më pas kërkon nga ata që të gjejnë faktet në tekst dhe t'i vendosin në organizuesin grafik.

| Ndikimi i Moskës në ekonomi dhe politikën e vendeve të Europës Lindore | Masat e marra nga Moska | Rebelime të vendeve të Europës Lindore |
|---|---|---|
| - **Në politikë:** u vendosën regjimet komuniste;<br>- **Në ekonomi:** zbatuan modelin sovjetik, në themel të të cilit ishte planifikimi dhe centralizimi i ekonomisë; shtetëzimi i industrisë dhe u morën masa për kolektivizimin e bujqësisë. Ekonomia e këtyre vendeve u përdor nga BS-ja edhe si "hambar" për të mbështetur ekonominë e saj. | - Krijimi i Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke (KNER).<br>BS-ja importonte nga vendet e Europës Lindore produkte me çmime më të lira se në tregjet e tjera dhe eksportonte lëndë të para me çmime më të larta se në këto tregje. Kjo solli kontradikta e kundërshtime nga vendet e Europës Lindore. | **Poloni:** Në vitin 1956 populli kërkonte liri dhe të drejta demokratike kjo solli një politikë më liberale, e cila më vonë u zbeh.<br>**Hungari:** Në vitin 1956 shpërtheu zemërimi popullor. Si rrjedhojë u krijua qeveri e re, por Moska ndërhyri ushtarakisht dhe shtypi lëvizjen. Çekosllovakia, populli çekosllovak, nuk u pajtua me qeverinë e re prosovjetike dhe u ngrit për liri dhe demokraci. Si pasojë u krijua qeveria e re. Në gusht të vitit 1968 ushtria sovjetike pushtoi Çekosllovakinë. Udhëheqja çekosllovake e vënë nën terror e presion, pranoi e detyruar kushtet sovjetike. |

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Ditarët e të nxënit**

Mësuesi/ja fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes, në njërën anë të shkruajnë ngjarjet dhe në anën tjetër të shkruajnë një koment. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja përdor teknikën e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për ndikimin e Moskës në drejtimin e ekonomisë dhe politikës së vendeve të Europës Lindore.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej të dhëna në internet për ngjarjet në Hungari dhe Çekosllovaki dhe bëj një përmbledhje për brutalitetin e ushtrisë sovjetike ndaj vendeve satelite.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.3: Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë** | | **Situata e të nxënit:**<br>Informacion për veçoritë e ekonomisë së Jugosllavisë | |
| **Tema mësimore: Jugosllavia gjatë viteve 1945–1990** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan në Jugosllavi në vitet 1945–1963;<br>• përdor konceptet *shtet i pavarur, shtet federativ, krahinë autonome, vetadministrim, vende të paangazhuara;*<br>• analizon tiparet e politikës së brendshme dhe të jashtme të Jugosllavisë;<br>• krahason zhvillimet në Jugosllavi me vendet e Europës Lindore dhe gjen të përbashkëtat e dallimet. | | **Fjalë kyç:**<br>shtet federativ, sistem vetadministrimi, vende "të paangazhuara". | |
| **Burimet:** informacioni që nxënësit kanë, teksti, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjeografi, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Parashikimi me terma paraprakë**
Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat:

**Kosovë**
**Shtet federativ**
**Bosnjë-Hercegovinë**
**Mali i Zi**
**Krahinë autonome**
**Kroaci**
**Slloveni**
**Republika të pavarura**
**Vojvodinë**
**Luftë Civile**
**shpërbërje**

Nxënësit, në mënyrë individuale, do të shkruajnë nga një fjali me këta terma.
Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe shënohen në tabelë ato që përcjellin informacion të saktë.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Mbajtja e strukturuar e shënimeve**
Mësuesi/ja i orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Mbajtja e strukturuar e shënimeve". Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë në tekst temën dhe të japin mendim se çfarë duhet të përfshihet në skemë. Nxënësit propozojnë që skema të përmbajë çështjet, si: Jugosllavia në vitet 1945-1963; Politika e brendshme dhe e jashtme e saj; Jugosllavia gjatë "Luftës së Ftohtë".

- Mësuesi/ja së bashku me nxënësit ndërton skemën në tabelë.
- Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë tekstin dhe të nënvizojnë informacionin që do të vendosin në skemë sipas çështjeve.

### Mbajtja e strukturuar e shënimeve

**Jugosllavia në vitet 1945-1963**

- Më 29 nëntor 1945 Jugosllavia u çlirua dhe u shpall Republika Popullore Federative e Jugosllavisë.
- Pushtetin e mori në dorë Partia Komuniste.
  Më 1963 Kushtetuta e re ia ndryshoi emrin në Republika Socialiste Federative Jugosllave.

**Politika e brendshme dhe e jashtme e Jugosllavisë**

*Politika e brendshme*
- Nga viti 1945–1948, Jugosllavia ishte nën ndikimin stalinist dhe e ndërtoi jetën ekonomike, sociale dhe kulturore sipas modelit sovjetik.
- Gjatë viteve 1950–1990 Jugosllavia u shkëput nga ndikimi sovjetik.
- Në ndërmarrjet industriale shtetërore u vendos *sistemi i vetadministrimit.*

*Politika e jashtme*
- Gjatë viteve 1945–1948, ajo kishte marrëdhënie miqësore me BS-në dhe vendet e Bllokut Socialist.
  Pas vitit 1948, Jugosllavia i prishi marrëdhëniet me Moskën dhe u orientua drejt vendeve perëndimore, si Italia, Franca dhe Vendet e Paangazhuara.

**Jugosllavia gjatë "Luftës së Ftohtë"**

- Përkrah shteteve të Paangazhuara.
- Në vitin 1961 u mbajt në Beograd, Konferenca e Parë e Shteteve të Paangazhuara, ku morën pjesë 25 shtete.
- Sipas udhëheqësve jugosllavë lëvizja e shteteve të paangazhuara synonte krijimin e një "Bote të re", i kundërvihej ashpërsimit të Luftës së Ftohtë, që zhvillonin dy superfuqitë.
- Në këtë strukturë të re, me një politikë të re do të sigurohej bashkëjetesa paqësore ndërmjet shoqërive me sisteme të ndryshme dhe çdo shtet do të ruante sovranitetin.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Diagrami i Venit**
Mësuesi/ja fton nxënësit që në një fletë fletoreje të krijojnë skemën e diagramit dhe të krahasojnë Jugosllavinë me vendet e tjera të Europës Lindore në aspektet e politikës së brendshme dhe të jashtme.




## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për ndikimin e Moskës në drejtimin e ekonomisë dhe politikës së vendeve të Europës Lindore.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej informacion për situatën në Kosovë gjatë viteve 1974–1990.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.3:<br>Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Informacion për shkaqet dhe përfundimin e Luftës Civile në Greqi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br><br>Greqia gjatë viteve 1945–1990</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton shkaqet e Luftës Civile;<br>• përcakton rolin e Britanisë dhe SHBA në Luftën Civile;<br>• analizon situatën politike në Greqinë e pas Luftës Civile;<br>• përdor konceptet: regjim ushtarak, monarki, republikë, luftë civile, grusht shteti;<br>• evidenton arsyet e zhvillimit ekonomik në Greqi;<br>• tregon sukseset e saj në politikën e jashtme.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>ELAS, regjim ushtarak, monarki, republikë, luftë civile, grusht shteti.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:<br>gjeografi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Përmbledhje e strukturuar**
Mësuesi/ja fillon me një "Përmbledhje të strukturuar", një bisedë paraprake për Greqinë në prag të përfundimit të Luftës II Botërore.
Ai/ajo kërkon nga nxënësit të japin mendimet e tyre për pasojat e luftës dhe gjendjen në Greqi pas lufte.
Mësuesi/ja shënon në tabelë disa nga mendimet e nxënësve.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Ditarët e të nxënit**
Mësuesi/ja i orienton nxënësit që, të vendosur në çifte, të lexojnë temën në tekst dhe nxënësi i parë identifikon çështjet që interesojnë, nënvizon dhe shënon në fletore çështjet që i duken më të rëndësishme për t'u diskutuar, ndërsa tjetri bën komentet për çdo çështje të evidentuar.
Më pas mësuesi/ja ndërton skemën në tabelë dhe kërkon nga nxënësit ta plotësojnë atë (një nxënës shënon vetëm një çështje apo koment).

| Çështjet | Komente |
|---|---|
| Pse shpërtheu Lufta civile në Greqi? | - Mbreti me qeverinë e tij kërkonte të rikthehej në fron.<br>- ELAS-i kontrollonte shumicën e territorit të vendi dhe synonte të merrte në dorë drejtimin e vendit. |
| Përfshirja e forcave britanike në konflikt | - Të mbështesnin forcat e djathta që të mos vendosej regjimi komunist në Greqi. |
| Partitë politike pas Luftës Civile | - Demokracia e Re, e udhëhequr nga Kostandin Karamanlisi, - PASOK-u (Lëvizja Socialiste Panhelenike). |
| "Regjimi i Kolonelëve" | - Grusht shteti. |
| Çështja qipriote | - Acarim i marrëdhënieve mes Turqisë dhe Greqisë.<br>- Shkaktoi krizë politike në vend. |
| Referendumin për formën e regjimit | - Solli rrëzimin e monarkisë dhe vendosjen e republikës. |
| Rritja ekonomike | - Përfitoi nga Plani Marshall për të kapërcyer pasojat e Luftës Botërore dhe të Luftës Civile.<br>- Zhvillimi i sektorit të turizmit. |
| Arritjet në politikën e jashtme | - Që në vitin 1952 ajo iu bashkua NATO-s.<br>- Në janar të vitit 1981 Greqia u bë anëtare e Komunitetit Europian. |

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Diskutim**
- Pasi kanë përfunduar detyrën, nxënësit shkëmbejnë mendime, identifikojnë dhe listojnë veçoritë e zhvillimit politik në Greqi në vitet 1945-1990.
- Pas përfundimit të detyrës nxënësit diskutojnë dhe vlerësojnë çështjet e ngritura dhe komentet për çdo çështje.
- Punohet në grupe me rubrikën "Kontrolloni- Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime.

## ► Vlerësimi
Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit, lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për të evidentuar dhe për të analizuar veçoritë e zhvillimit politik dhe ekonomik të Greqisë në vitet 1945-1990.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur
Krijo një ese me temë "Lufta e Ftohtë dhe ballafaqimi i dy forcave në Luftën Civile greke".

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.3:<br>Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë<br><br>Tema mësimore: Bullgaria dhe Rumania</td><td colspan="2">Situata e të nxënit:<br>Informacion për të drejtat dhe liritë gjatë regjimit komunist në Bullgari dhe Rumani</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton faktorët që çuan në vendosjen e regjimeve komuniste;<br>• përshkruan ndikimin sovjetik në ekonominë e këtyre vendeve;<br>• krahason zhvillimet në ekonomi dhe politikë në Bullgari dhe Rumani.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>monarki, republikë, ndryshime demokratike, kolektivizimi i bujqësisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Informacioni që kanë nxënësit, teksti, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjeografi, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Parashikimi me terma paraprakë**
Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat:

***monarki komunistë pushtet republikë modeli sovjetik shtetëzime***

Nxënësit, në mënyrë individuale do të shkruajnë nga një fjali me këta terma.
Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe shënohen në tabelë ato që përcjellin informacion të saktë.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Diagrami i Venit**
Mësuesi/ja orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Diagrami i Venit". Ai/ajo i orienton nxënësit që të lexojnë në tekst temën *Bullgaria* dhe *Rumania.*
Ndërton skemën në tabelë dhe orienton nxënësit që të ndërtojnë të njëjtën skemë në fletore.

***Bullgaria*** ***Të përbashkëtat*** ***Rumania***

**Veçoritë dalluese**

**Bullgaria** - Pas vdekjes së Stalinit *ndodhën ndryshime politike dhe ekonomike*. Në krye të vendit u vu Teodor Zhivkovi. Në ekonomi pati përpjekje për decentralizimin e industrisë dhe për rritjen e pronës private në bujqësi.
**Rumania** - nuk u fut kurrë nën varësinë e plotë të BS-së. Ekonomia rumune u zhvillua pak a shumë në mënyrë të pavarur.

**Të përbashkëtat**

*Monarkia u përmbys* dhe u zëvendësua me Republikën. Ndikimi i sovjetikëve në politikë: ardhja në pushtet e komunistëve;
Ndikimi sovjetik në ekonomi: u krijua prona shtetërore nëpërmjet shtetëzimit të pronave në qytete dhe kolektivizimit të bujqësisë në fshat. Ekonomia ishte e centralizuar dhe kontrollohej plotësisht nga shteti.
Kriza ekonomike në vitet '80.
Në vitin 1989 largohet Zhivkovi dhe përmbysja e Çausheskut u hapi rrugën ndryshimeve të tjera politike, që sollën *ndryshime të thella demokratike* në këto vende.

Mësuesi/ja i orienton nxënësit që të lexojnë tekstin dhe të nënvizojnë informacionin që do të vendosin në skemë.
Ai/ajo i fton nxënësit që të diskutojnë rreth veçorive dalluese dhe tipareve të përbashkëta në zhvillimin ekonomik e politik të Bullgarisë dhe Rumanisë.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Diskutim**
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve t'i rikthehen tekstit dhe të evidentojnë ekzistencën ose jo të lirive në këto dy vende. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit diskutojnë rreth përgjigjeve të dhëna.

## ► Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit nga nxënësi. Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për veçoritë dalluese dhe tiparet e përbashkëta në zhvillimin ekonomik e politik të Bullgarisë dhe Rumanisë

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hulumto dhe gjej të dhëna si u përmbys regjimi komunist në këto dy vende. Përgatit një përmbledhje me këto të dhëna.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.3:<br>Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Foto nga Shqipëria pas Luftës II Botërore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore (1945–1946) (Veprimtari praktike)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon masat që mori Partia komuniste për të marrë pushtetin;<br>• tregon politikën e ndjekur nga PKSH për eleminimin e kundërshtarëve politikë;<br>• analizon karakterin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit të vitit 1945 dhe përmbajtjen e Kushtetutës së vitit 1946.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>Partia komuniste, këshilla nacionalçlirimtarë, reaksionarë, Fronti nacionalçlirimtar</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjuhët dhe komunikimi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**
Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin në tekst.

**Hapi i dytë:**
Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe i cakton çështjet mbi të cilat do të përqëndrohet diskutimi dhe burimet e informacionit:

**Grupi 1:** Veprimtaria e PKSH-së për marrjen e pushtetit politik (forcimi i këshillave nacionalçlirimtarë);

**Grupi 2:** Politika e PKSH-së për eliminimin e kundërshtarëve politikë (bashkëpunëtorët me pushtuesin dhe kundërshtarët e regjimit);

**Grupi 3:** Krijimi i administratës së re: qeveri, administratë e re civile dhe ushtarake, gjykata, policia, forcat e mbrojtjes popullore;

**Grupi 4:** Zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, rezultatet dhe farsa demokratike e tyre;

**Grupi 5:** Shpallja e Republikës Popullore të Shqipërisë, Kushtetuta e vitit 1946 dhe Kuvendi Popullor.

Mësuesi/ja orienton nxënësit për burimet e informacionit ku do të mbështeten:

- FESH-i, Vëllimi III, faqe 2576-2577; • Internet: Historia e Shqipërisë 1945–1950;
- Tekstet e historisë së klasës së 9-të dhe 12-të; • Valentina Duka: "Historia e Shqipërisë 1912-2000", Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2007, faqe 229–238

**Hapi i tretë:**
Mësuesi/ja përzgjidh nxënësin/en që do të luajë rolin e moderatorit. Ai/Ajo përcakton "rregullat" e prezantimit, kohën dhe planifikon edhe një seancë pyetjesh dhe përgjigjet pyetjeve nga grupet e tjera.
Disa nga pyetjet që nxënësit mund të bëjnë janë:

- Cilat janë masat që mori Partia komuniste për të ardhur në pushtet?
- Çfarë roli luajtën këshillat nacionalçlirimtarë?
- Cilët quheshin reaksionarë dhe pse?
- Cila ishte përbërja e administratës në vitet 1945-1946?
- Pse zgjedhjet e 2 dhjetorit të 1945 nuk janë demokratike? etj.

Mësuesi/ja ndihmon në formulimin e saktë të informacionit.
Çdo grup prezanton punën e bërë dhe i përgjigjet pyetjeve të bëra nga grupet e tjera.

**Hapi i katërt:**
Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi i diskutimit.
Moderatori bën një përmbledhje të pikave kryesore të diskutimit, të fakteve më të rëndësishme të paraqitura.
Mësuesi/ja, me ndihmën e një jurie, bën vlerësimin e punës së çdo grupi dhe inkurajon anëtarët e grupit të bëjnë vlerësimin për çdo anëtar të grupit përkatës.

## ► Vlerësimi

Mësuesi vlerëson punën në grup. Mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.3:<br>Organizimi ekonomiko-politik gjatë viteve të Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Pjesë nga libri i I. Kadaresë "Dimri i vetmisë së madhe"</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shteti shqiptar dhe politika e tij e jashtme gjatë Luftës së Ftohtë (Veprimtari praktike)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon veçoritë e marrëdhënieve diplomatike me vendet e Bllokut Komunist;<br>• rendit sipas kronologjisë vendosjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë, BS-në, Kinën;<br>• krahason politikën e jashtme të shtetit shqiptar me atë jugosllav.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>marrëdhënie diplomatike, integrim, Blloku Komunist</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjuhët dhe komunikimi, TIK</td></tr>
</table>

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**
Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin në tekst.

**Hapi i dytë:**
Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe i cakton çështjet mbi të cilat do të përqendrohet diskutimi dhe burimet e informacionit:

**Grupi 1:** Marrëdhëniet diplomatike me shtetet komuniste, veçanërisht me Jugosllavinë (1944–1948);

**Grupi 2:** Integrimi i plotë në Bllokun komunist. Orientimi i plotë drejt Bashkimit Sovjetik (1949–1960);

**Grupi 3:** Marrëdhëniet e reja me Kinën komuniste (1961–1978) ;

**Grupi 4:** Në rrugën e socializmit stalinist (Izolimi 1979–1989);

Mësuesi/ja orienton nxënësit për burimet e informacionit ku do të mbështeten:
- FESH, vëllimi III, faqe 2576–2577;
- Interneti: Politika e jashtme e Shqipërisë në vitet 1945–1990;
- Tekstet e historisë së klasës së 9-të dhe 12-të; botime shkollore Albas;
- Valentina Duka: "Historia e Shqipërisë 1912–2000", Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2007, faqe 238–242; 279–293; Pjesë të shkëputura nga vepra e Ismail Kadaresë "Dimri i vetmisë së madhe".

**Hapi i tretë:**
Për të nisur diskutimin, mësuesi/ja mund të përdoret një bisedë hyrëse (mund të vendosë të shohin një pjesë nga filmi "Ballë përballë").
Mësuesi/ja ndihmon në formulimin e saktë të informacionit dhe sqarimin e paqartësive..
Nxënësit diskutojnë duke pasur parasysh materialet e mbledhura paraprakisht.
Çdo grup prezanton punën e bërë dhe i përgjigjet pyetjeve të bëra nga grupet e tjera.

**Hapi i katërt:**
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë thelbin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar në periudhën e Luftës së Ftohtë.
Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson punën në grup. Mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

# Test i tremujorit II

1. **Hitleri synonte pushtimin e Bashkimit Sovjetik për të siguruar:**
   ______________________________________________
   ______________________________________________

2. **Çfarë përmbanin traktatet e paqes pas Luftës së Dytë Botërore?**
   a. ______________________________________________
   b. ______________________________________________
   c. ______________________________________________

3. **Lufta e Dytë Botërore filloi me sulmin që Gjermania i bëri:**
   a. Çekosllovakisë; c. Hungarisë;
   b. Polonisë; d. Francës

4. **Rretho alternativën e saktë.**
   **SHBA-ja hyri në Luftën e Dytë Botërore pas sulmit të:**
   a. Gjermanisë mbi Përl Harbor; c. Italisë mbi Shqipërinë;
   b. Japonisë mbi Përl Harbor; d. Gjermanisë mbi Poloninë.

5. **Rretho alternativën e saktë.**
   **Lufta e Ftohtë filloi:**
   a. pas Luftës së Parë Botërore; c. ndërmjet dy luftërave botërore;
   b. pas Luftës së Dytë Botërore; d. pas viteve 1990.

6. **Shpjegoni kuptimin e termave "holokaust" dhe "gjenocid".**
   ______________________________________________
   ______________________________________________
   ______________________________________________

7. **Plotëso vendet bosh**
   a. Në ____________________ u zgjodh qeveria e re nën drejtimin e De Golit.
   b. Në ____________________ krijimi i Republikës Federale të Gjermanisë (RFGJ) dhe përfshirja në Planin Marshall.
   c. Në ____________________ mbahet referendumi për të vendosur për monarkinë ose republikën.
   d. Në ____________________ Ajzenhaueri zgjidhet president i SHBA-së dhe zëvendëson Trumanin.

8. **Lidh me shigjetë.**

| | |
|---|---|
| a. Konferenca e Paqes e Parisit pas Luftës së Dytë Botërore | ___ 22 qershor 1941 |
| b. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia | ___ shtator 1943 |
| c. Fundi i Luftës së Dytë Botërore | ___ 7 prill 1939 |
| d. Italia fashiste kapitulloi | ___ gusht 1946 |
| e. Gjermania sulmoi Bashkimin Sovjetik | ___ 2 shtator 1945 |

9. **Cilat ishin vendimet e Konferencës së Jaltës?**
   a. ______________________________________________
   b. ______________________________________________
   c. ______________________________________________

**10. Cilat ishin interesat e Hitlerit në Ballkan?**

______________________________________________
______________________________________________
______________________________________________

**11. Shëno me V (vërtetë) ose G (gabuar).**

a. Në fund të Luftës II Botërore në vendet e Europës Lindore u vendos diktatura. ____
b. Përplasjet e ashpra midis ShBA-së dhe Bashkimit Sovjetik njihet si Lufta e Ftohtë. ____
c. Italia fashiste kapitulloi në shtator të vitit 1944. ____
d. Lufta e Dytë Botërore është quajtur "lufta kundër njerëzimit". ____
e. Qëllimi i OKB-së është ruajtja e paqes dhe sigurisë në botë. ____
f. Pas Luftës II Botërore SHBA-ja u angazhua në përhapjen e komunizmit në Europë. ____
g. Në periudhën e komunizmit u lejua krijimi i partive politike. ____
h. Doktrina Truman shënon fillimin e Luftës së Ftohtë. ____

**12. Cilat ishin vendimet e Konferencës së Postdamit?**

a. ______________________________________________
b. ______________________________________________

**13. Si u zbatua procesi i stalinizimit të jetës ekonomike-politike në Europën Lindore?**

______________________________________________
______________________________________________

**14. Përcaktoni faktorët që ndikuan në "mrekullinë ekonomike" të Gjermanisë.**

a. ______________________________________________
b. ______________________________________________
c. ______________________________________________

**15. Cili është parimi bazë i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut?**

______________________________________________
______________________________________________

**16. Cilat ishin vendimet e Konferencës së Paqes të vitit 1946?**

a. ______________________________________________
b. ______________________________________________
c. ______________________________________________

**17. Cili ishte qëllimi kryesor i Planit Marshall? Çfarë roli luajti UNRRA?**

______________________________________________
______________________________________________

**18. Çfarë veçorish kishte politika e jashtme e Britanisë pas Luftës së Dytë Botërore?**

______________________________________________
______________________________________________

**19. Çfarë përmbanin reformat hrushoviane?**

______________________________________________
______________________________________________

# FORMULAR VETËVLERËSIMI

*(Tremujori i dytë)*

**Lënda: Histori** **Klasa: 8** **Emër mbiemër: ________________________________**

| | **Nëntematika** | **Niveli i vetëvlerësimit** | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Nëntematika 1.5 Lufta e Dytë Botërore (1939-1945)** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Shqyrtoj dhe tregoj shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe karakterin e saj; | | | |
| 2 | Dalloj blloqet kryesore ushtarake në prag të Luftës së Dytë Botërore; | | | |
| 3 | Përcaktoj në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; | | | |
| 4 | Shpjegoj dhe gjykoj pasojat Luftës së Dytë Botërore: pasojat ekonomike, sociale, psikologjike,pasojat e holokaustit; | | | |
| 5 | Vlerësoj rolin e institucioneve europiane dhe ndërkombëtare në zgjidhjen e konflikteve të luftës. | | | |
| 6 | Vlerësoj dhe provoj shkallën e përdorimit të njohurive, të shprehive, të aftësive dhe të qëndrimeve, që zotëron nxënësi për ngjarjet historike të ndodhura gjatë dhe ndërmjet dy luftërave botërore; | | | |
| 7 | Vlerësoj shkallën e pluralizmit në shtypin e kohës. | | | |
| **Nr.** | **Nëntematika 2.1 Bota pas Luftës së Dytë Botërore** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Tregoj vendimet e Konferencës së Paqes, duke evidentuar ndryshimet që ato sollën në botën e pasluftës; | | | |
| 2 | Përshkruaj karakterin dhe qëllimet e OKB-së; | | | |
| 3 | Përcaktoj karakteristikat e ekonomisë së pas luftës; | | | |
| 4 | Vlerësoj rolin e programit ekonomik UNRRA dhe Planit Marshall në rindërtimin e Europës pas Luftës. | | | |
| 5 | Përshkruaj gjendjen ekonomike politike të Shqipërisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. | | | |
| 6 | Vlerësoj rolin e shqiptarëve ndaj hebrenjve. | | | |
| **Nr.** | **Nëntematika 2.2 Lufta e Ftohtë** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përcaktoj dhe përdor këto koncepte e terma historikë: Luftë e Ftohtë, Perde e Hekurt, superfuqi, bllok/kamp politik; | | | |
| 2 | Përshkruaj shkaqet e Luftës së Ftohtë dhe krijimin e blloqeve ushtarake (NATO dhe Traktati i Varshavës); | | | |
| 3 | Shpjegoj pasojat e Luftës së Ftohtë; | | | |
| 4 | Evidentoj pozicionin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 2.3 Ekonomia gjatë viteve të Luftës së Ftohtë** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përshkruaj tiparet kryesore të organizimit ekonomik të shteteve perëndimore dhe lindore; | | | |
| 2 | Shpjegoj arsyet dhe rrugët drejt integrimit ekonomik-politik të shteteve të bllokut perëndimor (Komuniteti Europian i Çelikut dhe i Qymyrit, Komuniteti Ekonomik Europian); | | | |
| 3 | Përshkruaj tiparet kryesore të organizimit ekonomiko-politik të shteteve të bllokut komunist (KNER); | | | |

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.4:** **Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990** **Tema mësimore:** **Revolucioni III Tekniko-Shkencor** | | **Situata e të nxënit:** Foto nga shpikjet e tri Revolucioneve tekniko-shkencore dhe krahasim i arritjeve. | |
| **Rezultatet e të nxënit:** Nxënësi/ja: • evidenton shpikjet që u bënë gjatë Revolucioneve Tekniko-Shkencore; • liston në mënyrë kronologjike shpikjet; • tregon rëndësinë e tyre në ekonomi dhe përbërjen shoqërore; • tregon pasojat negative të përdorimit të shpikjeve. | | **Fjalë kyç:** Revolucion Tekniko-shkencor, zhvillim i shkencës dhe i teknikës, Epokë e Internetit. | |
| **Burimet:** Tekstet Histori 7 dhe Histori 8, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** Fizikë, Informatikë | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimi**

Mësuesi/ja prezanton fotografi nga Revolucionet Tekniko-Shkencore I dhe II, (të cilat mund t'i marrë nga interneti ose nga teksti *Histori 7*), si p.sh.:

***Foto e një fabrike, makina me avull e Xhejms Vatit, motori me djegie të brendshme (diezel).***

Mësuesi/ ja pyet nxënësit:

– Përshkruani foton e fabrikës/makinës me avull/motorit me djegie të brendshme.

– Cilës periudhë i përkasin?

– Cilat janë ndryshimet që pësoi ekonomia pas këtyre shpikjeve?

– Cilat janë disa nga shpikjet e tjera që ju dini?

Diskutohen përgjigjet e nxënësve. Për përgjigjet e pasakta, mësuesi/ja jep sqarimet e nevojshme.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- INSERT**
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në një fletë A4 apo fletoreje të ndërtojnë skemën e INSERT-it dhe e ndan klasën në 4 grupe.

Mësuesi/ja sqaron nxënësit se grupet 2 dhe 4 do të lexojnë "Kronologjia e revolucioneve tekniko-shkencore" ndërsa grupet 1 dhe 3 do të lexojnë "Përparimi i shkencës pas Luftës së Dytë Botërore".
Mësuesi/ja i orienton nxënësit që gjatë leximit do të vendosin në tekst shenjat:

✓ për informacionin që njohin; (-) në rastet kur informacioni që ata dinin është i ndryshëm nga ai në tekst apo që e kundërshton atë; (+) për informacionin e ri, (?) për informacionin e paqartë.

Nxënësit lexojnë tekstin dhe vendosin përbri shenjat. Më pas nxënësit diskutojnë për shenjat e vendosura dhe në fund ndërtojnë tabelën e mëposhtme:

| ✓ | – | + | ? |
|---|---|---|---|
| - *Revolucioni I* pati si atdhe Anglinë.<br>- Ky revolucion solli lindjen e fabrikës dhe të industrisë.<br>- Puna e dorës u zëvendësua me makineri.<br>- U shpik makina me avull e Xhejms Vatit.<br>- Motori me djegie të brendshme (diezel).<br>Makinat elektronike dhanë mundësinë për të bërë llogaritje të sakta në çdo fushë.<br>- Shpikja e internetit<br>.................................... | - Lindën shtresa të reja shoqërore: punëtorët dhe borgjezët.<br>- *Revolucioni II* Tekniko-shkencor përfshiu shekujt XVIII–XIX<br>.................................... | - Pas Luftës, në vitet '50–'60 u zhvillua elektroteknika dhe informatika.<br>- Energjia atomike filloi të përdorej për prodhimin e energjisë elektrike.<br>- Filloi prodhimi i aeroplanëve reaktivë e supersonikë.<br>.................................... | - Eksperimente për shërimin e tumoreve nëpërmjet përdorimit të lëndëve radioaktive.<br>- Përdorimi i trurit elektrik (robotët).<br>.................................... |

- Rishikohet tabela pas diskutimeve.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**
Diskutohen pyetjet dhe çështjet në rubrikën "Kontrolloni-Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime".

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për Revolucionet tekniko-shkencore, shpikjet, përdorimin e tyre në progresin dhe në të keq të njerëzimit.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Kërko në internet të dhëna për përdorimin e të rejave shkencore në fushën e mjekësisë.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
| **Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990**<br>**Tema mësimore: Zhvillimet në shkencë dhe teknologji gjatë shek. XX** | | **Situata e të nxënit:**<br>Foto të një avioni, radioje, si edhe objekte të tilla, si: kompjuteri, CD-ja etj. | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton arritjet në shkencë dhe teknologji gjatë shekullit XX;<br>• tregon pasojat ekonomike e sociale;<br>• jep gjykim për vendin që zënë kompjuteri, celulari, televizori në jetën e tij. | | **Fjalë kyç:**<br>Revolucioni i Tretë Industrial, shoqëri pasindustriale, ADN, bioteknologji. | |
| **Burimet:** Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** fizikë, Informatikë | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* - **Imagjinata e drejtuar**
Mësuesi/ja i orienton nxënësit të përfytyrojnë një bashkëmoshatar të tyre, i cili jeton në një fshat të largët. Në

fshat jetojnë jo më shumë se 10 familje. Në familjen e tij janë 5 anëtarë dhe vetëm babai punon etj.
Ai/ajo u kërkon nxënësve të imagjinojnë jetesën e bashkëmoshatarit të tyre në këtë fshat dhe ta përshkruajnë atë; çfarë i mungon atij në dallim nga ju.
Pas imagjinatës, nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin. Nxënësit prezantojnë përshkrimin.
Diskutohen pyetjet që lindin gjatë prezantimeve.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Të nxënit me këmbime**
Mësuesi/ja nga klasën në 4-5 grupe dhe çdo grupi i shpërndan nga një fletë, në të cilën është shkruar një pyetje (kjo orë mund të realizohet edhe në sallën e informatikës, nëse keni internet).

| Grupi 1 | Grupi 2 | Grupi 3 | Grupi 4 |
|---|---|---|---|
| Pse të shërben celulari? Rendit pasojat negative të përdorimit të tij. | Cilat janë qëllimet për të cilat përdorni kompjuterin? Rendit pasojat negative të përdorimit të tij. | Cilat janë ndryshimet në jetën e njeriut nga energjia elektrike dhe bërthamore? | Cilat janë disa nga ndryshimet ekonomike e sociale që sjell zhvillimi i shkencës? |

Secili nga ekspertët shkruan përgjigjet përfundimtare dhe shkon në grupet fillestare.
Secili ekspert jep përgjigje për pyetjen që kishte. Diskutohen përgjigjet.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Shkrimi i lirë**
Përzgjidhni një temat e mëposhtme dhe shkruani një ese:
- "A e zëvendëson përdorimi i kompjuterit librin?".
- "Mrekullia e elektronikës, revolucion i informatikës, ADN-ja molekula e jetës".

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit, lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për *Zhvillimet në shkencë dhe teknologji gjatë shek. XX.*

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej informacion për bioteknologjinë dhe inxhinierinë gjenetike.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990**<br>**Tema mësimore: Jeta sot dhe teknologjia e komunikimit *(Veprimtari praktike)*** | | **Situata e të nxënit:**<br>Arritjet e teknologjisë që përdoren në jetën e përditshme | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton ndryshimet që solli Revolucioni i Tretë Industrial në jetën e njerëzve;<br>• dallon anët pozitive të zhvillimit teknologjik;<br>• tregon problematikat që ka shkaktuar ky zhvillim teknologjik;<br>• propozon zgjidhje. | | **Fjalë kyç:**<br>zhvillimi teknologjik, bioteknologji; informacion, komunikim. | |
| **Burimet:** njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** TIK | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë: Lexim i orientuar**
Mësuesja i orienton nxënësit që të lexojnë pjesën e dhënë në tekst.

**Hapi i dytë: Shkrim i lirë**
Pasi nxënësit kanë përfunduar leximin mësuesi/ja u kërkon që të shkruajnë një ese me temë "si e përfytyron ai jetën në mungesën e celularit/ kompjuterit/ CD dhe /apo DVD/ MP3"

**Hapi i tretë: Diskutim**
Lexohen disa nga esetë që trajtojnë probleme të veçanta që lidhen me zhvillimin teknologjik.
Diskutohen esetë dhe evidentohen:
- problematikat kryesore;
- veçoritë pozitive dhe negative të zhvillimit teknologjik në jetën e sotme dhe të ardhme të njerëzimit;
- renditen faktet e paraqitura nga jeta e tyre e përditshme.

Nxënësit me ndihmën e mësuesit/eses tregojnë vendin që zë teknologjia në jetën e tyre, arsyet për të cilat e përdorin teknologjinë, kohën që shpenzojnë, masat që duhet të marrin për të shmangur efektet negative (planifikimin e kohës për përdorimin e teknologjisë).

**Hapi i katërt: Rrjeti i diskutimit**
Mësuesi/ja shtron pyetjen "A do të jetonit dot pa teknologjinë?" Dhe kërkon nga nxënësit të formojnë grupet "pro" dhe "kundër", sipas qëndrimit që ata mbajnë ndaj zhvillimit të teknologjisë.

Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi
Mësuesi vlerëson punën në grup. Mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Prezantohen foto nga lëvizjet shoqërore të shek. XX (lëvizjet feministe, studentore, lëvizjet kundër diskriminimit racial)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shoqëria dhe lëvizjet shoqërore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon lëvizjet shoqërore;<br>• tregon synimet e tyre;<br>• përshkruan arritjet e tyre;<br>• dallon shkaqet që çuan në shpërthimin e këtyre lëvizjeve.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>lëvizje demografike, urbanizim, zhvillim i shkencës dhe i teknikës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime nga lëvizjet shoqërore.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: Gjeografi</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Stuhi mendimi**
Mësuesi/ja i pyet nxënësit rreth njohurive të tyre dhe rreth informacionit të mbledhur:

– Cilat janë disa nga pasojat sociale që sjell zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë?
– Si ndikon zhvillimi i shkencës në jetën e qytetarëve? Argumentoni përgjigjen.
– Pse zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë shoqërohet me ndryshime demografike?
– A do të shoqërohet ky zhvillim me lëvizje shoqërore? Pse?
Diskutohen përgjigjet e nxënësve.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Lexim i drejtuar**
Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje dy pjesët e para të temës: "Faktorët ndikues në shoqëri (1951–2000)" dhe të gjejnë përgjigjet për pyetjet:
– Cilat janë ndryshimet në mënyrën e jetesës që sollën lëvizjet demografike?
– Cilët janë faktorët që ndikuan në ndryshimet e popullsisë në qytet e fshat?
– Ç'kuptoni me amerikanizim të kontinentit europian?
– Cilët ishin faktorët që ndikuan në rritjen e kohës së lirë të qytetarëve?

Pasi nxënësit kanë përfunduar leximin japin përgjigjet për pyetjet. Mësuesi/ja kërkon që nxënësit të lexojnë fjalitë që vërtetojnë përgjigjet e tyre.

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të lexojnë në heshtje pjesën e dytë të temës: "Lëvizjet shoqërore" dhe të gjejnë përgjigjet për pyetjet:
– Ç'kuptojmë me lëvizje shoqërore?
– Cilat janë ato?
– Cilat ishin arsyet që çuan në lëvizjet për arsim dhe kualifikim?
– Ç'kuptojmë me "dukuri e shoqërisë pasindustriale"?
– Çfarë kërkonte lëvizja feministe? Po ajo studentore?
– Pse lindi lëvizja kundër diskriminimit racial?
– Çfarë synonte ajo?
– Cilat ishin ndryshimet që solli kjo lëvizje?

Pasi nxënësit kanë përfunduar leximin japin përgjigjet për pyetjet. Mësuesi/ja i kërkon që nxënësit të lexojnë fjalitë që vërtetojnë përgjigjet e tyre.
Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të rendisin lëvizjet sipas kronologjisë.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **- Ditarët e të nxënit**
Mësuesi/ja fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes, në njërën anë të shkruajnë lëvizjet dhe në anën tjetër të shkruajnë një koment. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

## ► Vlerësimi
Mësuesi/ja përdor teknikën e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për lëvizjet shoqërore, synimet dhe arritjet e tyre.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur
Interpreto thënien e Martin Luter Kingut: "Unë kam një ëndërr" në një ese të shkurtër (mbështetu edhe te figura e presidentit Obama).

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990**<br>**Tema mësimore: Kultura, arti dhe besimi në botën e sotme** | | **Situata e të nxënit:**<br>Interpretohet rëndësia e mesazhit që përcjell Papa Gjoni XXIII në Enciklikën "Paqe në tokë" | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• dallon karakteristikat e artit, kulturës dhe besimit në gjysmën e dytë të shek. XX;<br>• analizon veçoritë në art dhe kulturë;<br>• jep gjykimin e tij për rolin e fesë në këtë periudhë. | | **Fjalë kyç:**<br>letërsi dhe art modern, frymë liberalizmi, koncil | |
| **Burimet:** teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjuha shqipe, arti pamor, muzika | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Di-Dua të di-Mësova**

Mësuesi/ja pyet nxënësit për të evidentuar njohuritë që kanë nxënësit, të cilat do t'i shërbejnë lidhjes së njohurive që kanë me njohuritë e reja.
– Ndryshimet në shkencë e teknologji a do të shoqërohen me ndryshime në art? Pse?

– Cilët janë disa nga shkrimtarët e shekullit XX?

– A keni lexuar ndonjë vepër të A. Kamysë? Mund të tregoni për të?

– Çfarë qëndron në thelb të veprave të shkrimtarëve të shekullit XX?

– Çfarë karakteri kishte arti i kësaj periudhe?

Nxënësit japin mendimet e tyre rreth pyetjeve.
Mësuesi/ja shkëput një pjesë nga libri i Kamysë "I huaji", e lexon atë dhe kërkon nga nxënësit që të tregojnë se çfarë transmetonte kjo pjesë.
Diskutohen përgjigjet e dhëna dhe përgjigjet e sakta shënohen në kolonën **"Di"**.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Di-Dua të di-Mësova**
Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë temën dhe të veçojnë se cilat janë informacionet që do të duan të dinë për temën.
Disa nga përgjigjet e nxënësve mund të jenë:

– Cilat ishin karakteristikat e letërsisë në këtë periudhë?

– Cilat janë veçoritë e artit pamor dhe muzikës?

– A pësoi ndonjë ndryshim besimi?

– Cili ishte roli i besimit në këtë periudhë?

Të gjitha pyetjet/çështjet e ngritura nga nxënësit shënohen në kolonën **"Dua të di"**.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* **– Di-Dua të di-Mësova**
Nxënësit lexojnë në tekst dhe gjejnë përgjigjet e pyetjeve apo çështjeve të ngritura dhe këto i vendosin në kolonën "Mësova". Nxënësit prezantojnë punën e bërë.
Punohet me rubrikën Kontrolloni-Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për të evidentuar dhe analizuar veçoritë e artit dhe besimit në vitet 1945–1990.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Përshkruani idetë kryesore të veprës "I huaji" të Albert Kamysë.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990** | | **Situata e të nxënit:**<br>Pjesë nga filmi "Parullat" | |
| **Tema mësimore: Ideologjizimi i arsimit, i artit dhe i kulturës në Shqipëri në vitet 1945–1990** ***(Veprimtari praktike)*** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon ndikimin e ideologjisë në arsim, art e kulturë;<br>• analizon ndikimin e ideologjisë dhe dallon anët negative;<br>• mban qëndrimin e tij për ideologjinë e realizmit socialist. | | **Fjalë kyç:**<br>ideologjizim, art, kulturë, arsim, frymë ideologjike | |
| **Burimet:** Njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjuhët dhe komunikimi, TIK | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**
Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin e dhënë në tekst.

**Hapi i dytë:**
Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe dhe i cakton çështjet mbi të cilat do të përqendrohet diskutimi dhe burimet e informacionit:

**Grupi 1:** Si ndikonte ideologjia në zgjedhjen e kuadrove?

**Grupi 2:** Cilët janë treguesit e ndikimit të frymës ideologjike në dokumentacioni shkollor?

**Grupi 3:** Përshkruaj si përcillej fryma ideologjike në përmbajtjen e shkollës.

**Grupi 4:** Cilat elemente tregojnë se bazat shkollës ishin në përputhje me ideologjinë.

**Grupi 5:** Si ndikonte ideologjia në vlerësim.

**Grupi 6:** Cilat janë boshllëqet dhe mbivlerësimet që krijonte ideologjia?

**Grupi 7:** Çfarë karakteristikash kishte letërsia, arkitektura e realizmit socialist?

**Grupi 8:** Cilat janë elementet që e bëjnë të dallueshme pikturën, skulpturën dhe muzikën e realizmit socialist?
Mësuesi/ja orienton nxënësit që, për të bërë punimin e tyre, duhet të mbështeten te burimet e informacionit:

1. FESH/ Vëll. 1, f. 117-118;
2. Internet "Ideologjizimi i teksteve shkollore"

Mësuesi/ja orienton nxënësit që të përzgjedhin materialin e nevojshëm gjatë orës mësimore.
Pas përfundimit të punës në grup nxënësit prezantojnë punimet e tyre.

**Hapi i tretë:**
Mësuesi/ja shënon në tabelë idetë që do të diskutohen
1. Rritja e sistemit arsimor parauniversitar dhe universitar në Shqipëri gjatë viteve 1940–1950.
2. Fryma ideologjike që përshkonte gjithë sistemin arsimor.
3. Zbërthimi i parimit mësim-punë-kalitje fizike-ushtarake.
4. Shkolla sot dhe parimet themelore të saj.

Për të nxitur diskutimin tregon një histori nga jeta reale e shkollës para viteve '90/ një pikturë/ apo vendos një tekst kënge:

**Hapi i katërt:**
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë një ditë në shkollën e para viteve '90.
Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi
Mësuesi/ja vlerëson punën në grup. Mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990** | | **Situata e të nxënit:**<br>Dokumentar "Fëmijët e diktaturës" | |
| **Tema mësimore: Aspekte të jetës së përditshme në Shqipëri gjatë viteve '45–'90**<br>***(2 orë) (Veprimtari praktike)*** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• përshkruan mënyrën e jetesës në vitet 1945-1990;<br>• dallon uniformitetin në mënyrën e jetesës;<br>• analizon aspektet e jetë së përditshme;<br>• mban qëndrimin e tij ndaj diktaturës. | | **Fjalë kyç:**<br>shoqëri socialiste, mënyrë jetese, përkrahje e pushtetit | |
| **Burimet:** njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjuhët dhe komunikimi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**

Një orë para zhvillimit të temës mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin e dhënë në tekst të përgatisin intervistën.
Mësuesi/ja sqaron nxënësit se intervistën do ta zhvillojnë 5-7 persona të moshës 50 vjeç.
Intervista do të ketë këtë përmbajtje:

**<u>Të dhëna individuale:</u>**
- Mosha,
- Gjinia,

- Vendbanimi,
- Profesioni që kanë pasur deri në vitin 1990,
- Vendet e punës që kanë pasur deri në vitin 1990.
- Të ardhurat mesatare mujore deri në vitin 1990.
- Kanë jetuar në shtëpi private apo apartament shtetëror.
- Mobilimi kryesor i shtëpisë.
- A kishin mjete të tilla elektroshtëpiake, si: makinë larëse, frigorifer, makinë fshirëse etj.?
- Nëse kanë pasur, kur kanë hyrë së pari në shtëpinë e tyre.
- Kur ka hyrë së pari në familjen tuaj televizori?
- Çfarë stacionesh televizive kanë qenë në dispozicion?
- Çfarë muzike dëgjonit?
- A njihej muzika moderne perëndimore?
- Çfarë veshjesh të përditshme përdornit?
- Cilat ishin festat zyrtare që festoheshin në atë kohë?
- Sa ditë pushimi vjetor gëzonit?
- Ku i kalonit pushimet tuaja vjetore?

Mësuesi/ja porosit orienton nxënësit që të hartojnë tabelën përmbledhëse me rezultatet e intervistimit dhe komente përgjithësuese që do të përmbajë tabela.

Gjithashtu mësuesi/ja kërkon që nxënësit të sjellin në orën tjetër mësimore foto të familjes/ familjarëve të tyre të bëra gjatë viteve 1945-1990 ose foto të gjetura në internet që tregojnë aspekte nga jeta e përditshme në Shqipërinë e viteve 1945-1990.

## ► Ora e veprimtarisë

**Hapi i parë:**
Nxënësit prezantojnë tabelën përmbledhëse me rezultatet e intervistave.

**Hapi i dytë:**
Mësuesja vendos në videoprojektor pjesë nga dokumentari "Fëmijët e diktaturës".
Pasi përfundon dokumentari nis diskutimi për mënyrën e jetesës së fëmijëve në diktaturë.

**Hapi i tretë:**
Mësuesi/ja mbledh fotot e sjella nga nxënësit, i ekspozon ato në tabelë dhe nxit diskutimin.
Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që bëjnë një përshkrim të një nga aspektet e jetës, si puna, të ushqyerit, të veshurit, kohës së lirë etj., në diktaturë duke e shoqëruar atë me foto.

**Hapi i katërt:**
Diskutohen disa prej eseve.
Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja vlerëson punën në grup. Mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990**<br>**Tema mësimore: Izolimi dhe bunkerizimi i Shqipërisë *(Veprimtari praktike)*** | | **Situata e të nxënit:**<br>Dokumentari për bunkerët<br>https://www.youtube.com/watch?v=L-Ik_8jvWCs | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• njeh termat bunkerizim dhe izolim;<br>• kupton shprehjet "bunkerizim i mendimit", "viktima të bunkerizimit", "i gjithë populli ushtar";<br>• dallon qëllimet për të cilat u ndërtuan bunkerët;<br>• analizon izolimin dhe bunkerizimin e Shqipërisë dhe dallon pasojat negative; | | **Fjalë kyç:**<br>bunkerizim, izolim | |
| **Burimet:** njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime, dokumentari në adresën *https://www.youtube.com/watch?v=L-Ik_8jvWCs* | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjuhët dhe komunikimi, TIK | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin e dhënë në tekst.
Ai/ajo shfaq në videoprojektor dokumentarin për bunkerët: Albanian Bunkers (Bunkerët në Shqipëri) duke klikuar në adresën: https://www.youtube.com/watch?v=L-Ik_8jvWCs ose Bunkerët-Marrëzia e izolimit. Duke klikuar në adresën e mëposhtme https://www.youtube.com/watch?v=RyCJIWMN68o

**Hapi i dytë:**

Mësuesi/ja ndan nxënësit në tri grupe dhe kërkon që çdo grup të caktojë një nxënës, i cili do të prezantojë punimin e grupit
Mësuesi/ja cakton detyrat për grupet:

**Grupi 1:** Bunkeri si element themelor i fortifikimit;
**Grupi 2:** Sistemi i fortifikimit në Shqipëri;
**Grupi 3:** "Bunkerizimi" si element i izolimit të Shqipërisë.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e bërë.

**Hapi i tretë:**

Mësuesi/ja fton nxënësit në diskutim frontal, ku nxënësit shtrojnë dhe u përgjigjen këtyre kërkesave:
- Çfarë është bunkeri?
- Çfarë kuptohet me "sistem fortifikues" dhe çfarë përfshin ai?
- Si e kuptoni shprehjen "bunkerizim i mendimit", "viktima të bunkerizimit", "i gjithë populli ushtar"?
- Si e kuptoni fjalën "zbor"?
- Si justifikohej bunkerizimi?
- Cilat ishin pasojat politike të bunkerizimit?

**Hapi i katërt:**

Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi për angazhimet gjatë punës në grup, përgjigjet e dhëna, prezantimet dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Zhvillo një intervistë për "Bunkerizimin dhe izolimin e Shqipërisë" me gjyshërit, të afërmit apo fqinjët, të cilët janë të paktën 50 vjeç.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Historí 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.4: Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945-1990</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Anëtarësimi i Shqipërisë në OKB</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Shqipëria, anëtare e OKB-së<br>(Veprimtari praktike)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon arsyet pse Shqipëria u anëtarësua në OKB në vitin 1955;<br>• analizon qëndrimin kundër të qeverisë greke;<br>• tregon qëndrimet e dy blloqeve për anëtarësimet e reja në OKB.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>anëtarësim në OKB, "gjendje e luftës", pretekst, bllokim, blloqe.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto dhe ilustrime. www.balkanweb.com/gazetashqiptare/shqiperia-ne-okb/</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: qytetari, gjuhët dhe komunikimi, TIK</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin e dhënë në tekst.

**Hapi i dytë:**

Mësuesi/ja ndan nxënësit në tri grupe dhe i cakton çështjet mbi të cilat do të përqendrohet diskutimi dhe burimet e informacionit:

**Grupi 1.** Pengesat e Shqipërisë për anëtarësimin në OKB;

**Grupi 2.** Qëndrimi i qeverisë greke ndaj kësaj çështjeje;

**Grupi 3.** Pranimi i Shqipërisë në OKB.

Mësuesi/ja orienton grupet që, për të bërë punimin e tyre, duhet të mbështeten te burimet e informacionit:

- Faqja e internetit në adresën: www.balkanweb.com/gazetashqiptare/shqiperia-ne-okb/
- Pjesa e leximit në tekst.

**Hapi i tretë:**

Mësuesi/ja shënon në tabelë idetë që do të diskutohen.

Pasi nxënësit kanë përgatitur informacionin për detyrën e dhënë mësuesi/ja i fton ata në diskutim.

**Hapi i katërt:**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit që të përshkruajnë një ese me temë "Shqipëria, vend anëtar i OKB-së".

Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha: Shoqëria dhe mjedisi** | **Lënda: Histori 8** | **Shkalla: IV** | **Klasa: 8** |
| **Nëntematika 2.5: Përfundimi i Luftës së Ftohtë** | | **Situata e të nxënit:** Informacion për reformat Perestrojka dhe Gllasnosti | |
| **Tema mësimore: Perestrojka dhe Gllasnosti** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:** Nxënësi/ja:<br>• dallon arsyet e pakënaqësisë së popullsisë në BS;<br>• tregon kërkesat për ndryshim;<br>• evidenton reformat dhe karakterin e tyre;<br>• analizon reformat dhe tregon pasojat;<br>• krahason Gorbaçovin me Jelcinin dhe evidenton ndryshimet. | | **Fjalë kyç:** Perestrojkë, Gllasnost, disidentë, fund i Luftës së Ftohtë | |
| **Burimet:** Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjeografi, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Përvijim i të menduarit**

Mësuesi/ja pasi shënon temën në tabelë, me anë të pyetjeve nxit diskutimin për situatën ekonomike e politike në veçoritë e sistemit politik dhe ekonomik në BS pas Luftës II Botërore.
Ai/ajo e ndan klasën në grupe, u shpërndan fletë A4 dhe i udhëzon të plotësojnë tabelën.
Grupet plotësojnë skemën.




- Pas përfundimit të detyrës diskutohen përgjigjet.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Shënime mbi shënime**

Mësuesi/ja i orienton nxënësit që të ndarë në grupe të lexojnë për pak minuta "Kërkesa për ndryshim" "Reformat e Gorbaçovit" "Ardhja në pushtet e Boris Jelcinit".

Pas leximit, mësuesi/ja i udhëzon të plotësojnë skemën. Idetë ose kategorive kryesore u vendos treguesin 1 në radhitje, ndërsa detajeve u vendos treguesit 2, 3, 4,5.

**1. Perestrojka dhe Gllasnosti.**

2. Kërkesa për ndryshim
   3. Rritja e pakënaqësisë
   3. Mungesa e lirisë, frika, izolimi, goditja e çdo mendimi të lirë shtuan pakënaqësinë.
   3. Dëshira për ndryshim.
   3. Kërkesë që shoqëria e tyre të bëhej si shoqëria perëndimore.

2. Reformat e Gorbaçovit
   *Reforma ekonomike dhe shoqërore*
   3. ***Perestrojka*** - ishte reformë ekonomike, që kërkonte të rikrijonte ekonominë e re kapitaliste nëpërmjet privatizimit.
   3. ***Gllasnost*** - kërkonte që shteti të merrte fytyrën publike
   3. Shpallte ristrukturimin e ekonomisë

   *Reforma me karakter politik*
   3. Shpalli lirinë e fjalës
   3. Shpërbërja e aparatit të vjetër administrativ dhe ndërtimi i një aparati të ri
   3. Heqja e ligjit sipas të cilit Partia Komuniste ishte e vetmja parti që drejtonte vendin

   *Pasojat e reformave*
   3. Nxiti opozitën dhe dobësoi rolin e Partisë Komuniste.
   3. Dolën në pah kontradiktat mes popujve jorusë që përbënin BS-në
   3. Sollën copëtimin e BS-së
   3. Në vitin 1991 u krijua *Komuniteti i Shteteve të Pavarura*, i cili përbëhej nga 10 vende që dikur ishin pjesë e BS-së.
   3. Në OKB vendin e BS-së e zuri Federata Ruse, ndërsa vendet e tjera që kishin formuar BS-në, hynë në OKB individualisht, në mënyrë të pavarur
   3. Bëri marrëveshje me SHBA për kufizimin e armëve strategjike
   3. Përfundon Lufta e Ftohtë

2. Ardhja në pushtet e Boris Jelcinit
   3. Në vitin 1993, Jelcini hartoi një kushtetutë, e cila zgjeronte mjaft të drejtat e presidentit, duke zvogëluar shumë rolin e parlamentit.
   3. Gjatë presidencës së Jelcinit (1991–1999) filloi transformimi i ekonomisë.
   3. Shfaqen disa dukuri, si: papunësia, pakënaqësia, përhapja e korrupsionit, lindja e oligarkisë, dukuri që lidheshin me periudhën e tranzicionit.

- Nxënësit punojnë dhe ripunojnë materialin.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**

Punohet me rubrikën "Kontrolloni- Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni- Nxirrni përfundime".

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për Perestrojkën dhe Gllasnostin.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Krahaso Gorbaçovin me Reganin, duke përdorur këto dy cilësi: *mbrojtëse* dhe *agresive*. Argumento mendimin tënd.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.5: Përfundimi i Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Foto nga shembja e murit të Berlinit dhe protestat që sollën rënien e sistemeve totalitare në vendet e Europës Lindore</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Revolucionet demokratike në Europën Lindore në vitin 1989</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• dallon tiparet e zhvillimit ekonomik dhe politik në këto vende;<br>• analizon zhvillimet ekonomiko-politike të këtyre vendeve dhe gjen shkaqet që çuan në rrëzimin e regjimeve diktatoriale;<br>• krahason dhe dallon veçoritë në përmbysjen e këtyre regjimeve;<br>• argumenton faktet.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>revolucione demokratike, Solidarnos, reforma demokratike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: informacioni që nxënësit kanë, teksti, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjeografi, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Parashikimi me terma paraprakë**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat:

**Viti 1989 Europë Lindore Rënie Parti të reja politike Muri i Berlinit**

**Regjime komuniste Demokraci**

Nxënësit, në mënyrë individuale do të shkruajnë nga një fjali me këta terma.
Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe shënohen në tabelë ato që përcjellin informacion të saktë.
Mësuesi/ja pyet nxënësit se cilat janë disa nga shtetet e Europës Lindore në të cilat u përmbysën regjimet diktatoriale në vitet 1989–1991?
Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Diagrami i Venit**

Mësuesi/ja i orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Diagrami i Venit". Mësuesi/ja i ndan nxënësit në 4 grupe dhe u cakton detyrat:

**Grupi 1.** Evidentoni veçoritë e zhvillimit ekonomik dhe politik në Poloni dhe Rumani, krahasojini ato;

**Grupi 2.** Evidentoni veçoritë e zhvillimit ekonomik dhe politik në Hungari dhe Çekosllovaki, krahasojini ato;

**Grupi 3.** Evidentoni veçoritë e zhvillimit ekonomik dhe politik në Gjermaninë Lindore dhe Poloni, krahasojini ato;

**Grupi 4.** Evidentoni veçoritë e zhvillimit ekonomik dhe politik në Çekosllavaki dhe Bullgari, krahasojini ato;

Mësuesi/ja ndërton skemën në tabelë dhe orienton nxënësit që të ndërtojnë të njëjtën skemë në fletore. Nxënësit plotësojnë skemën në fletore sipas modelit të mëposhtëm.

| *Poloni* | *Të përbashkëtat* | *Rumani* |
|---|---|---|

| *Veçoritë dalluese* |
|---|
| |

| *Të përbashkëtat* |
|---|
| |

Mësuesi/ja fton nxënësit që të diskutojnë rreth veçorive dalluese dhe tipareve të përbashkëta në zhvillimin ekonomik e politik të vendeve të Europës Lindore si: Polonia, Hungaria, Çekosllovakia, Bullgaria, Rumania, Gjermania Lindore.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve t'i rikthehen tekstit dhe të evidentojnë pasojat e shembjes së diktaturave në këto vende.

Pas përfundimit të detyrës, nxënësit diskutojnë rreth përgjigjeve të dhëna.

## ► Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit për punën në grup. Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për veçoritë dalluese dhe tiparet e përbashkëta në zhvillimin ekonomik e politik të vendeve të Europës Lindore.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Gjej informacion për shembjen e murit të Berlinit

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.5: Përfundimi i Luftës së Ftohtë</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Prezantohen foto të Luftës Civile në Kroaci, Bosnjë, Kosovë dhe nga shpallja e tyre shtete të pavarura.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Jugosllavia</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon situatën politike dhe ekonomike në Republikën Federative Socialiste Jugosllave;<br>• tregon shkaqet që çuan në shpërbërjen e Jugosllavisë;<br>• identifikon rrugën që ndoqën Kroacia, Sllovenia, Bosnja e Kosova për shkëputjen nga Jugosllavia;<br>• përshkruan përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>shpërbërje, luftë civile, Kosova republikë</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: gjeografi</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Shkrim i lirë**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të shkruajnë ngjarje apo fakte që flasin për Kosovën nga në periudhën 1945–2008.
Pasi përfundojnë detyrën, nxënësit lexojnë çfarë kanë shkruar.
Diskutohen përgjigjet.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Ditarët e të nxënit**

Mësuesi/ja i orienton nxënësit që të vendosur në çifte të lexojnë temën në tekst dhe nxënësi i parë identifikon, nënvizon dhe shënon në fletore çështjet që i duken më të rëndësishme për t'u diskutuar, ndërsa tjetri bën komentet për çdo çështje të evidentuar.

Më pas mësuesi/ja ndërton skemën në tabelë dhe kërkon nga nxënësit ta plotësojnë atë (një nxënës shënon vetëm një çështje apo koment).

| Çështja | Komenti |
|---|---|
| Si realizohej vetadministrimi? | Ndërmarrjet shtetërore ishin pronë e shtetit, por përdorimi i tyre u lihej në dorë punonjësve, të cilët formuan disa këshilla, që vendosnin për prodhimin, pagat, çmimet etj |
| Shpërbërja e Jugosllavisë | Politika totalitare dhe proserbe. Ngjarjet në Europën Lindore dhe në BS, rënia ekonomike, si dhe politika e Milosheviçit shkaktuan shpërbërjen e RFSJ-së. |
| Sllovenia dhe Kroacia | Në vitin 1991 shpallën shkëputjen dhe pavarësinë e tyre Republika e Sllovenisë dhe e Kroacisë.<br>Filloi lufta civile. Republika e Sllovenisë dhe e Kroacisë.<br>u shpallën shtete të pavarura e sovrane: Sllovenia, Kroacia të cilat i njohu edhe OKB-ja. |
| Popullsia e Bosnjës | Popullsia e Bosnjës përbëhet nga tri grupe të mëdha: boshnjakët myslimanë, që përbëjnë shumicën, kroatët katolikë dhe serbët ortodoksë. |
| Lufta civile në Bosnjë | Më 1993 Bosnja u shpall shtet i pavarur dhe sovran, u njoh edhe nga OKB-ja.<br>Serbët ortodoksë nuk pranonin që në shtetin e ri të mbizotëronin boshnjakët myslimanë, prandaj ata shpallën lindjen e Republikës Autonome Serbe, duke përvetësuar një pjesë të madhe të territorit<br>Serbët e Bosnjës u mbështetën nga ushtria federale jugosllave.<br>Forcat serbe kryen ndaj popullsisë myslimane boshnjake masakra të mëdha: burgosje, përdhunime e vrasje, pa dallim moshe e gjinie. Në Serbrenicë u masakruan rreth 10 000 boshnjakë. |
| Përfundimi Luftës Civile në Bosnjë | Në vitin 1995, me nismën e presidentit Klinton, ndërhynë trupat e NATO-s duke i dhënë fund konfliktit.<br>Bosnja mbetej shtet i vetëm i përbërë nga dy njësi të mëdha autonome: myslimano-kroate dhe serbe. |
| Kosova si Krahinë autonome e Jugosllavisë | Kosova që nga Kushtetuta e vitit 1974 njihej si krahinë autonome brenda Serbisë.<br>Në vitin 1989, politika e Milosheviçit u mohoi këtë të drejtë kosovarëve dhe i vuri ata nën pushtetin e plotë të Serbisë. |

| | |
|---|---|
| Kosova nën pushtetin e Serbisë | Në vitin 1990 në Kosovë u vendos një regjim ushtarako-policor serb. U shpërnda Kuvendi i Kosovës, qeveria dhe organet administrative e gjyqësore; u pushtua Radio-Televizioni; u mbyll gazeta "Rilindja" etj. |
| Reagimet e popullit të Kosovës | Më 23 dhjetor 1989 u krijua partia e parë antikomuniste *Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)* nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës.<br>Më 7 shtator 1990 u mblodhën në Kaçanik deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës dhe shpallën *Republikën* dhe *Kushtetutën e saj.*<br>Pas një viti u organizua *Referendumi,* i cili tregoi dëshirën e popullit kosovar për pavarësi dhe sovranitet.<br>U formua edhe Qeveria e Përkohshme e Republikës së Kosovës.<br>Në vitin 1992 populli i Kosovës zgjodhi deputetët për në Kuvendin e Kosovës dhe Ibrahim Rugovën si Kryetar të Republikës.<br>Në mes të viteve '90 u krijua *Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK).* |
| Shpërngulja e shqiptarëve të Kosovës | Në vitin 1999 mbi 800 mijë *shqiptarë të Kosovës u detyruan me dhunë* të shpërngulen nga territoret e tyre. Shumica e tyre u vendosën në Shqipëri. |
| Ndërhyrja e NATO-s në zgjidhjen e konfliktit | Më 24 mars 1999, duke e parë se situata ishte e rëndë, forcat e *NATO-s* sulmuan Serbinë. Ato larguan forcat ushtarake serbe nga Kosova dhe ndihmuan rikthimin e popullsisë kosovare. |
| Pasojat e Luftës në Kosovë | Lufta i kushtoi Kosovës mbi 10 000 të vrarë e 4 000 të humbur, me mijëra shtëpi të djegura. |
| Kosova, shtet i pavarur | Kosova kaloi nën administrimin e autoriteteve ndërkombëtare.<br>Më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës shpalli Pavarësinë, nën mbikëqyrjen e Bashkimit Europian (BE).<br>Sot Kosova ka *institucionet e veta demokratike*: Kuvendin, Qeverinë dhe Presidentin e vet. Republika e Kosovës është shteti më i ri në botë. Atë e njohu SHBA-ja, Anglia, Franca etj. dhe pret anëtarësimin e saj në OKB.<br>Më 9 prill 2008 Kuvendi miratoi Kushtetutën, e cila e përcaktoi Kosovën si Republikë të pavarur demokratike. |

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diagrami i Venit**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që të krahasojnë përpjekjet që bënë Kroacia, Sllovenia, Bosnjë-Hercegovina, Kosova për shpalljen e pavarësisë dhe të evidentojnë pasojat.

Diskutohen dhe vlerësohen punët e bëra nga nxënësit.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit, lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për të evidentuar dhe analizuar veçoritë e zhvillimit politik në Jugosllavi.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hulumto në internet dhe gjej të dhëna: foto, kronika, intervista nga pritja që iu bë shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.5: Përfundimi i Luftës së Ftohtë**<br>**Tema mësimore: Republika e pavarur e Kosovës si shteti më i ri në botë *(Veprimtari praktike)*** | | **Situata e të nxënit:**<br>Foto/video të shpërnguljes së kosovarëve në vitin 1999;<br>foto/video nga shpallja e pavarësisë së Kosovës | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• dallon pozicionin politik të Kosovës në vitet 1945–1990;<br>• tregon shkaqet e lëvizjeve për pavarësi në këto vite;<br>• analizon ngjarjet konfliktin e vitit 1999;<br>• krahason Republikën e Mbikëqyrur me Republikën e Pavarur dhe gjen dallimet. | | **Fjalë kyç:**<br>shpërngulje, NATO, Pavarësi e Mbikëqyrur, shtet i pavarur | |
| **Burimet:** njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto/video të shpërnguljes së kosovarëve në vitin 1999, foto/video nga shpallja e pavarësisë së Kosovës | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjeografi, gjuhët dhe komunikimi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**

Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin e dhënë në tekst.

Mësuesi/ja shfaq në videoprojektor foto ose video të momenteve kyç të shpalljes së Kosovës shtet i pavarur:

**Hapi i dytë:**

Mësuesi/ja ndan nxënësit në tetë grupe dhe kërkon që çdo grup të caktojë një nxënës, i cili do të prezantojë punimin e grupit.

Mësuesi/ja cakton detyrat për grupet dhe burimet ku do të mbështeten për të përgatitur prezantimin:

**Grupi 1.** Vendosja e sundimit serb pas vitit 1945 dhe pozita e nacionalizimit në Kosovë

**Grupi 2.** Cilët janë treguesit e ndikimit të frymës ideologjike në dokumentacioni shkollor?

**Grupi 3.** Kushtetuta e vitit 1974, Kosova shpallet krahinë autonome.

**Grupi 4.** Ardhja e Milosheviçit në krye të Federatës Jugosllave dhe heqja e autonomisë së Kosovës

**Grupi 5.** Rezistenca kosovare dhe greva e urisë e vitit 1989.

**Grupi 6.** Kosova drejt pavarësisë, 1991–1998.

**Grupi 7.** Gjenocidi serb ndaj popullsisë së Kosovës, shpërngulja me dhunë nga trojet e veta të kësaj popullsie, rezistenca e UÇK-së dhe ndërhyrja e NATO-s (1999).

**Grupi 8.** Shpallja e pavarësisë së Kosovës. Republika e pavarur e Kosovës. Pavarësia e mbikëqyrur?

Burimet:
- Historia e klasës së 9-të, historia e klasës së 12-të, botime shkollore Albas
- FESH, Vëllimi II, emërtimi Kosova, seksioni: Vështrim historik.
- Internet, adresa: *Kosova shtet i pavarur (Encyclopedia Britannica), rubrika: Histori, seksionet e kësaj rubrike: shpallja e Republikës dhe qëndresa paqësore; lufta çlirimtare dhe ndërhyrja veri-atlantike; çlirimi, pavarësia dhe administrata ndërkombëtare.*

Një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.

**Hapi i tretë:**

Mësuesi/ja fton nxënësit në diskutim frontal, ku nxënësit shtrojnë dhe u përgjigjen këtyre kërkesave:

- Si u vendos sundimi serb pas vitit 1945 në Kosovë?
- Pse Kosova shpallet krahinë autonome sipas Kushtetutës së vitit 1974?
- Përshkruaj lëvizjet studentore të vitit 1981?
- Cilat ishin kërkesat e studentëve?
- Cila ishte politika që ndoqi Milosheviçi me Kosovën?
- Pse u bë greva e urisë e vitit 1989? Cilat ishin kërkesat e grevistëve?
- Përshkruaj përpjekjet për pavarësi në vitet 1991–1998.
- Trego veprimet e serbëve që flasin për gjenocidin serb ndaj popullsisë së Kosovës.
- Cili ishte roli i UÇK-së në luftën në Kosovë?
- Cili ishte roli i NATO-s në konfliktin e vitit 1999?
- Cili ishte statusi i shtetit të Kosovës pas përfundimit të luftës?
- Kur u shpall pavarësia në Kosovë?
- Cilat janë shtetet europiane që nuk e kanë njohur Republikën e Pavarur të Kosovës? Pse?

**Hapi i katërt:**

Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi për angazhimet gjatë punës në grup, përgjigjet e dhëna, prezantimet dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.6: Bashkimi Europian</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Prezantohet flamuri, himni dhe monedha e BE-së</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Bashkimi Europian</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• dallon aleancat/marrëveshjet që u krijuan ndërmjet shteteve europiane;<br>• tregon arsyet e krijimit të tyre;<br>• përshkruan etapat nga 1951–2013;<br>• dallon institucionet e BE-së dhe funksionet e tyre.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>Bashkim Europian, institucionet e BE-së, monedha, simbolet</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: Informacioni që kanë nxënësit, teksti, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjeografi, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- parashikimi me terma paraprakë**

Mësuesi/ja shkruan në tabelë termat:

***Bashkim Europian*** ***Shtete europiane*** ***Bashkim doganor e monetar***

***Qarkullim i lirë*** ***Komuniteti Europian i Qymyrit dhe i Çelikut***

***Bashkëpunim politik***

Nxënësit, në mënyrë individuale do të shkruajnë nga një fjali me këta terma.
Lexohen fjalitë e ndërtuara dhe shënohen në tabelë ato që përcjellin informacion të saktë.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Pyetja sjell pyetjen**

Mësuesi/ja orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Pyetja sjell pyetjen". Mësuesi/ja përzgjedh një pjesë nga teksti, ua prezanton nxënësve dhe kërkon nga ata që të analizojnë fjalitë, të gjejnë përgjigjet për pyetjet si më poshtë:

- Pse shtetet europiane krijuan aleanca?
- Pse u krijua Komuniteti Europian i Qymyrit dhe i Çelikut?
- Pse në vitin 1957 u krijua Komuniteti Ekonomik Europian dhe Bashkimi Europian i Energjisë Atomike?
- Pse në vitin 1967 u bashkuan duke krijuar Komunitetin Europian ose KE-në? Pse vendet, si Britania e Madhe, Irlanda, Danimarka, Greqia, Spanja e Portugalia iu bashkuan këtij organizmi gjatë viteve 1973–1986?
- Komuniteti Europian i dha rëndësi edhe bashkëpunimit politik, si në fushën e politikave të jashtme, edhe atyre të mbrojtjes?

Mësuesi/ja orienton nxënësit për të gjetur përgjigjet.

Mësuesi/ja pasi merr përgjigje për pyetjet e bëra i kërkon nxënësve që të lexojnë temën, të punojnë në dyshe për të bërë pyetje pse rreth mësimit dhe të shkëmbejnë idetë me njëri-tjetrin.

Pasi nxënësit kanë përfunduar detyrën lexojnë një pyetje ose një përgjigje për pyetjen e bërë (me qëllim që të angazhohen sa më shumë nxënës).

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Ditarët e të nxënit**

Mësuesi/ja fton nxënësit që në një fletë fletoreje të ndarë me një vizë në mes, në njërën anë të shkruajnë një çështje dhe në anën tjetër të shkruajnë një koment ose një arsye. Më pas nxënësit prezantojnë gjetjet ose shënimet e tyre.

## ► Vlerësimi

Mësuesi mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri për rrugën drejt krijimit Bashkimit Europian, qëllimeve për të cilat u krijua, institucionet e tij dhe funksionet e tyre.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hartoni një ese me temë "Perspektiva europiane e Shqipërisë".

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.6: Bashkimi Europian** | | **Situata e të nxënit:** Hapja e negociatave për anëtarësimin në BE | |
| **Tema mësimore:**<br>**Shqipëria në rrugën e integrimit euro-atlantik *(Veprimtari praktike)*** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• identifikon hapat e ndërmarrë nga Republika e Shqipërisë për anëtarësimin në këshillin e Europës dhe NATO;<br>• analizon Marrëveshjen e Stabilizim–Asociimit dhe dallon detyrimet e shtetit shqiptar për anëtarësimin në BE;<br>• jep argumente mbi përfitimet dhe detyrimet e shqiptarëve në kuadër të liberalizimit të vizave;<br>• rendit ngjarjet sipas rendit kronologjik. | | **Fjalë kyç:**<br>Marrëveshja e Stabilizim–Asociimit, liberalizimi i vizave, negociata, anëtarësim | |
| **Burimet:** njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto, ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** qytetari, gjuhët dhe komunikimi | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:**
Mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë fragmentin e dhënë në tekst.
Mësuesi/ja prezanton një material informativ për hapat e deritanishëm të Shqipërisë për anëtarësimin në BE:

**Hapi i dytë:**
Mësuesi/ja ndan nxënësit në pesë grupe dhe kërkon që çdo grup të caktojë një nxënës, i cili do të prezantojë punimin e grupit.
Mësuesi/ja cakton detyrat për grupet dhe burimet ku do të mbështeten për të përgatitur prezantimin:

**Grupi 1:** Anëtarësimi i Shqipërisë në Këshillin e Europës

**Grupi 2:** Marrëveshja e Stabilizim–Asocimit

**Grupi 3:** Anëtarësimi në NATO

**Grupi 4:** Liberalizimi i vizave

**Grupi 5:** Hapja e negociatave për anëtarësim në BE

**Grupi 6:** Kosova drejt pavarësisë, 1991–1998.

Burimet:
- Historia e klasës së 12-të, botime shkollore Albas;
- Interneti me adresë: anëtarësimi i Shqipërisë në Këshillin e Europës; Marrëveshja e Stabilizim–Asociimit me Shqipërinë; Pranimi i Shqipërisë në NATO etj.

Një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.

**Hapi i tretë:**
Mësuesi/ja fton nxënësit në diskutim frontal, ku nxënësit shtrojnë dhe u përgjigjen këtyre kërkesave:
➢ Kur u anëtarësua Shqipëria në Këshillin e Europës?
➢ Cilat janë detyrimet dhe përfitimet si anëtarë të Këshillin e Europës?

➢ Kur u nënshkrua marrëveshja e stabilizim-asociimit?
➢ Cilat janë disa nga detyrimet dhe përfitimet e nënshkrimit të kësaj marrëveshje?
➢ A dëshironi që vendi ynë të jetë anëtar i BE? Argumentoni përgjigjen.

**Hapi i katërt:**
Nxirren përfundimet dhe bëhet vlerësimi për angazhimet gjatë punës në grup, përgjigjet e dhëna, prezantimet dhe vetëvlerësimi i diskutimit.

## ► Vlerësimi
Mësuesi mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.6: Bashkimi Europian</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Përshkrim i situatës në Ballkanin. Vendet e Ballkanit mes bashkëpunimit dhe konflikteve gjatë viteve 1990–2017.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore:<br>Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërmjet vendeve ballkanike</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton ndryshimet në marrëdhëniet mes shteteve të Ballkanit;<br>• analizon faktorët që ndikuan në zhvillimin e pas viteve '90 në Ballkan;<br>• përshkruan konfliktet në Ballkan;<br>• dallon shtetet e Ballkanit që janë anëtare të BE-së;<br>• analizon përmbajtjen e Paktit të Stabilitetit.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>Ballkani, Pakti i Stabilitetit, Grupi i Kontaktit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:<br>Teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjeografi, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Shkrim i lirë**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që, bazuar në njohuritë që kanë për Ballkanin, t'i shkruajnë në një fletë A4 ose në fletore.
Pas përfundimit të detyrës, nxënësit diskutojnë rreth përgjigjeve.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Sistemi ndërveprues i shënimeve - INSERT**

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve që në një fletë A4 apo fletoreje të ndërtojnë skemën e INSERT-it dhe e ndan klasën në 4 grupe. Mësuesi/ja sqaron nxënësit se do të lexojnë "Ballkani në kushte të reja", "Ballkani dhe e ardhmja e tij" dhe do të vendosin në tekst shenjat:

✓ Për informacionin që njohin; (-) në rastet kur informacioni që ata dinin është i ndryshëm nga ai në tekst apo që e kundërshton atë; ( +) për informacionin e ri, (?) për informacionin e paqartë.

Nxënësit lexojnë individualisht tekstin dhe vendosin përbri shenjat. Më pas nxënësit diskutojnë për shenjat e vendosura dhe në fund ndërtojnë tabelën e mëposhtme:

| ✓ | – | + | ? |
|---|---|---|---|
| - Konflikte të rënda ndërshtetërore dhe ndëretnike.<br>- OKB-ja dërgoi njësi paqeruajtëse në të gjitha vendet që rrezikoheshin nga konfliktet, veçanërisht në ish-republikat e Jugosllavisë.<br>- NATO-ja u aktivizua në këtë rajon më 1995, si garanci për një paqe të qëndrueshme dhe për sigurimin e popullsisë civile.<br>- BE-ja nxit anëtarësimin e tyre në gjirin e vet.<br>.................................... | | - Regjimet komuniste, të vendosura në Ballkan, nuk i zgjidhën problemet ndëretnike.<br>- Përmbysja e këtyre regjimeve tregoi qartë se konfliktet etnike ekzistonin.<br>- Shkëmbimet tregtare, kulturore, turistike dhe takimet politike të niveleve të ndryshme filluan pas përmbysjes së regjimeve diktatoriale<br>- Në vitin 1994 u krijua Grupi i Kontaktit, ku merrnin pjesë SHBA-ja, Rusia, Franca, Britania e Madhe dhe Gjermania. Synimi i tij ishte t'u jepte fund konflikteve të armatosura në këtë pjesë të Europës. Faktori ndërkombëtar i konsideron ato si pjesë të Europës dhe të vlerave të qytetërimit të saj. *Pakti i Stabilitetit*, një dokument që përcakton strategjinë e përbashkët në rrugën e anëtarësimit në BE për të gjitha vendet e Ballkanit.<br>- Ky pakt e kjo strategji nxit bashkëpunimin ballkanik në fushën politike, ekonomike dhe marrëdhëniet ndërshtetërore.<br>.................................... | - Ballkani është konsideruar si një "fuçi baruti".<br>............................. |

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**
Një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.
Punohet me rubrikën "Kontrolloni-Mendoni-Arsyetoni-Gjurmoni-Nxirrni përfundime.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit, lidhur me angazhimin e tyre në punën në çift apo në grup, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për situatën në Ballkan pas vitit 1990.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Hulumto dhe gjej të dhëna për rolin e NATO-s në konfliktet në Ballkan.

<table>
<tr><td>Fusha: Shoqëria dhe mjedisi</td><td>Lënda: Histori 8</td><td>Shkalla: IV</td><td>Klasa: 8</td></tr>
<tr><td colspan="2">Nëntematika 2.7: Prirjet e qytetërimeve sot</td><td colspan="2" rowspan="2">Situata e të nxënit:<br>Prezantim në videoprojektor ose foto të vendosura në tabelë që tregojnë veçoritë e ushqyerjes, veshjes, komunikimit, shkëmbimit të informacionit në shoqërinë e konsumit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tema mësimore: Jeta e përditshme në shoqërinë e konsumit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit:<br>Nxënësi/ja:<br>• përdor konceptet "shoqëri konsumi", "uniformitet";<br>• dallon elementet e shoqërisë së konsumit;<br>• analizon tiparet e shoqërisë së konsumit dhe evidenton anët pozitive dhe negative të saj.</td><td colspan="2">Fjalë kyç:<br>shoqëria e konsumit, informacion, komunikim, uniformitet</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet: informacioni që nxënësit kanë, teksti, foto dhe ilustrime.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare: gjeografi, qytetari</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
</table>

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Shkëmbe një problem**

Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të japin mendimin e tyre se çfarë kuptojnë ata me termin "Shoqëri konsumi".
Mësuesi/ja ndihmon në sqarimin e plotë të konceptit "Shoqëri konsumi".
Mësuesi/ja i ndan nxënësit në grupe dhe kërkon që secili grup të shkruajnë në një fletë një problem nga jeta e përditëshme në shoqërinë e konsumit dhe këtë t'ia japë grupit tjetër.
Grupet prezantojnë zgjidhjet.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Mbajtja e strukturuar e shënimeve**

Mësuesi/ja orienton nxënësit që tema e sotme do të zhvillohet me anë të metodës "Mbajtja e strukturuar e shënimeve", e cila ka si qëllim mbajten në mënyrë efikase të shënimeve dhe realizohet me anë të skemës (organizuesit grafik).
Mësuesi/ja bën skemën në tabelë dhe orienton nxënësit se çfarë duhet të përfshihet në skemë.
Në bashkëpunim me nxënësit evidentohen në tekst çështjet dhe më pas kërkohet nga ata që të gjejnë faktet në tekst dhe t'i vendosin në organizuesin grafik.

**Shoqëria e konsumit**

- Të ardhurat janë rritur
- Shoqëria shpenzon jo vetëm për nevojat bazë të jetës së përditshme, si për sende ushqimore a për veshje, pajisje shtëpiake, por edhe për shkollim, zbavitje, argëtim etj.
- Prodhohet më shumë, me çmim më të lirë, por mallrat ndryshojnë shpesh

→

**Uniformiteti**

- Falë mjeteve të shpejta të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit, njerëzit njihen me produktet e reja dhe i vënë shpejt në shërbim të tyre.
- Kudo në botë njerëzit bëjnë një jetë të përditshme të ngjashme, me të njëjtin komoditet

→

**Informacioni e ndërlidhja**

- Informacioni, megjithëse vazhdon të ruajë veçoritë e veta lokale, po merr ngjyrë uniforme. Përveç shtypit e radios, njeriu sot merr informacion nëpërmjet televizorit. Ky mjet e lidh informacionin dhe pamjet me njeriun në çdo kohë e kudo që ai ndodhet. Emisionet televizive në vijë satelitore, si: CNN, Eurovizion, BBC etj.,

sipas kohës, modës etj.

- Pajisjet elektronike, telefoni dhe veçanërisht kompjuteri, janë futur kudo në jetën tonë të përditshme. - Ato janë bërë pjesë e jetës së individit dhe mjetet më të përdorshme e të domosdoshme për njeriun, duke i lehtësuar punën.
- Sasia e madhe dhe e shumëllojshme e informacionit ndikon në zgjerimin e horizontit të tij kulturor.

dhe kushte pune.

- Si rrjedhojë, puna e jeta e njeriut është bërë më uniforme (e njëtrajtshme).
- Uniformiteti gradualisht po shtrihet edhe në sferën e ushqimit e të shijes. Kudo tregtohen hamburger, pica, patatina, koka-kola etj.
- Uniformiteti po shtrihet edhe në fushën e argëtimit, si një pjesë e jetës së përditshme. Shihen gati të njëjtat telenovela, filma, video-kaseta, dëgjohet dhe pëlqehet e njëjta muzikë, i njëjti stil veshjesh.

transmetojnë programe 24 orë pa ndërprerje.

- Interneti, rrjet informativ e komunikues, i jep mundësi të marrë njohuri që i nevojiten e t'i plotësojë kërkesat e tij, pa pasur nevojë të shpenzojë kohë. Nëpërmjet këtij rrjeti, ai plotëson nevojat, duke filluar nga prenotimi i një udhëtimi, deri te marrja e leksioneve universitare.
- Ndërlidhja mes njerëzve. Ajo po mundësohet me mjetet moderne të komunikimit, si celulari, posta elektronike, rrjetet sociale e linjat telefonike të shtrira anekënd globit.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Diskutimi**

Nxënësit japin mendimet e tyre për çështjet si më poshtë:

1. Analizoni anët pozitive dhe negative që paraqet jeta sot e mbështetur në teknologjinë e zhvilluar?
2. A mendon se vendi ynë është pjesë e uniformitetit? Argumento mendimin tënd.
3. Një turist ka thënë: "Unë vizitova shumë vende të botës, por asnjëherë nuk e ndjeva veten jashtë vendit tim". Si e komentoni ju këtë shprehje?
4. Si ndikon informacioni dhe ndërlidhja në uniformitet?
5. Komentoni figurat e këtij mësimi.
6. A bëjnë pjesë informacioni dhe ndërlidhja në uniformitetin e jetës?

*Diskutohen përgjigjet dhe nxirren përfundime.*

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja përdor teknikën e vlerësimit të nxënësit nga nxënësi. Mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për tiparet e shoqërisë së konsumit.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Shkruaj një ese me temë: "Sa më nevojitet mua kjo teknologji moderne"?

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.7: Prirjet e qytetërimeve sot** | | **Situata e të nxënit:** Politikat globale në art, kulturë, mjedis | |
| **Tema mësimore: Globalizimi dhe efektet e tij** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:** Nxënësi/ja:<br>• përdor termat/ konceptet globalizim, çlokalizim industrial;<br>• tregon fushat që përfshihen në globalizëm;<br>• analizon efektet e globalizimit;<br>• evidenton efektet pozitive dhe negative të tij. | | **Fjalë kyç:** globalizim, çlokalizim, industrial | |
| **Burimet:** teksti i nxënësit, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Parashikim me terma paraprakë**
Mësuesi/ja shënon në tabelë termat si më poshtë dhe kërkon nga nxënësit që të formojnë fjali

***globalizëm ekonomi uniformitet muzikë sport mjedis***

Diskutohen përgjigjet.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Kllaster**

Mësuesi/ja ndërton skemën e kllasterit dhe kërkon nga nxënësit që nga përgjigjet të përzgjedhin informacionin që duhet të vendosin në skemë.




**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Shkrimi i lirë**

Mësuesi/ja i kërkon nxënësve që të përshkruajnë efektet e globalizmit në jetën tyre. Prezantohen punët e nxënësve.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për të evidentuar dhe analizuar veçoritë e globalizmit dhe efektet e tij.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Pasqyroni globalizimin me anë të një skice.

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika 2.7: Prirjet e qytetërimeve sot** | | **Situata e të nxënit:** Foto të mjediseve të ndotura dhe nga momentet e pastrimit të tyre. | |
| **Tema mësimore: Ballafaqimi i shoqërisë me sfidat për mbrojtjen e mjedisit dhe kundër ngrohjes globale** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• evidenton shkaqet e ndotjes së mjedisit;<br>• përshkruan rolin e njeriut në mjedis;<br>• analizon pasojat që sjellin ndryshimet e mjedisit nga veprimtaria e njeriut;<br>• vlerëson rëndësinë e mjedisit në jetën e njeriut. | | **Fjalë kyç:**<br>mbrojtje e mjedisit, ngrohje globale | |
| **Burimet:** informacioni që kanë nxënësit, teksti, foto dhe ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** gjeografi, biologji, qytetari | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

**Hapi i parë:** *Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme* **- Përvijim i të menduarit**

Mësuesi/ja nxit diskutimin për mjedisin, mbrojtjen e tij nga ngrohja globale dhe sfidat

Pas diskutimit mësuesi/ja orienton nxënësit të lexojnë për disa minuta pjesën "Veprimtaria aktive e njeriut ndaj mjedisit", pasi nxënësit përfundojnë leximin mësuesi/ja i fton në diskutim dhe i tregon skemën e përvijimit të mendimit, të cilën e ka ndërtuar në tabelë.

Nxënësit punojnë në grup për plotësimin e tabelës.




Pas përfundimit të detyrës një përfaqësues për çdo grup prezanton tabelën e plotësuar.

**Hapi i dytë:** *Ndërtimi i njohurive të reja* **- Diagrami piramidal**

Mësuesi/ja i orienton nxënësit të lexojnë pjesët "Ndotja e mjedisit" dhe "Efekti serrë".

Pas leximit, mësuesi/ja pyet nxënësit se cila është çështja kryesore në materialin qësapo lexuat?

Nxënësit përgjigjen: Ndotja e mjedisit dhe përpjekjet për mbrojtjen e tij.

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe dhe çdo grupi i vë në dispozicion një fletë formati, ku ka ndërtuar modelin e diagramit piramidal dhe i sqaron për plotësimin e saj.

Nxënësit punojnë për plotësimin e diagramit piramidal.

**Ndotja e mjedisit dhe përpjekjet për mbrojtjen e tij**

**Ndotja e mjedisit**

Ndotja kërcënon drejtpërdrejt jetën e njeriut. Ndotja e mjedisit përfshin ndotjen e ajrit, të ujërave e të tokës.
Ajri ndotet nga gazrat e dëmshme, që shkarkohen në atmosferë duke krijuar smogun mbytës.
Ujërat e liqeneve, deteve e oqeaneve rrezikohen shpesh nga incidentet e anijeve naftëmbajtëse. Prishja e mjediseve ujore vjen edhe nga lumenjtë, të cilët derdhin në dete, liqene e oqeane mbetje industriale apo urbane (kanalet e ujërave të zeza).
Toka ndotet kur në territore të veçanta grumbullohen mbetje urbane, industriale e bujqësore, të cilat nuk eliminohen, por çlirojnë lëndë helmuese në natyrë. Rrezikshmëri të lartë paraqesin mbetjet radioaktive.

**Efekti "serrë"**

Efekti "serrë", që do të thotë ngrohja e tokës. Kjo sjell shkrirjen e akujve, rritjen e nivelit të ujërave të oqeaneve e deteve, rrezikon përmbytje të mëdha e fenomene të tjera negative.

**Konferenca të ndryshme për klimën**

Konventa e Vjenës (1985, për mbrojtjen e shtresës së ozonit);
- Protokolli i Montrealit (1987);
- Marrëveshja e Kiotos (1997, për pakësimin e $CO_2$)
- Konferenca e Rio-de-Zhanejros (1992);
- Konferenca e Johanesburgut (2002) etj.

**Hapi i tretë:** *Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura* - **Rrjeti i diskutimit**

Pasi nxënësit morën informacion për ndotjen e mjedisit dhe përpjekjet për mbrojtjen e tij zhvillon me nxënësit një diskutim për pyetjen:

PO — A është emergjente sot mbrojtja e mjedisit? — JO

***Argumentoni përgjigjen.***
Nxënësit japin përgjigjet.
Diskutohen përgjigjet e dhëna.

## ► Vlerësimi

Mësuesi vlerëson nxënësit për punën në grup. Mban shënime në evidencë për disa prej nxënësve, lidhur me angazhimin e tyre, përgjigjet e dhëna, që tregojnë se nxënësi ka fituar njohuri dhe aftësi për temën *Ndotja e mjedisit dhe sfidat e shoqërisë për mbrojtjen e tij*.

## ► Detyrat dhe puna e pavarur

Ese me temë "Veprimet tona në mjedis"

| Fusha: Shoqëria dhe mjedisi | Lënda: Histori 8 | Shkalla: IV | Klasa: 8 |
|---|---|---|---|
| **Nëntematika: Prirjet e qytetërimeve sot** | | **Situata e të nxënit:** . | |
| **Përsëritje:**<br>**Çështja 1.** ***Lufta e Ftohtë (1945–1989)***<br>**Çështja 2.** ***Zhvillimet në shkencë dhe teknologji, mënyrë e re jetese*** | | | |
| **Rezultatet e të nxënit:**<br>Nxënësi/ja:<br>• Analizon garën e dy blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë dhe pasojat që solli ajo;<br>• Identifikon ndryshimet që solli Revolucionit të Tretë Industrial;<br>• Rendisin ngjarjet sipas rendit kronologjik. | | **Fjalë kyç:**<br>traktat, marrëveshje, aleanca, teknologji, komunikim, informacion. | |
| **Burimet:** njohuritë që ka nxënësi, teksti, foto, ilustrime. | | **Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndër-kurrikulare:** Qytetari, Gjuhët dhe komunikimi. | |
| **Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve** | | | |

## ► Organizimi i orës së mësimit

❍ *Çështja 1:* **Lufta e Ftohtë (1945–1989)**

**Hapi i parë:**

Mësuesi/ja prezanton shkurtimisht përfundimet dhe pasojat e Luftës së Ftohtë.

**Hapi i dytë:**

Mësuesi/ja i ndan nxënësit në tri grupe dhe kërkon të plotësojnë tabelën e mëposhtme, të cilën e ka përgatitur më parë dhe ia shpërndan grupeve.

Mësuesi/ja sqaron përmbajtjen e tabelës dhe mënyrën si do të plotësohet.

**Grupi 1**

| *Ngjarja* | **Kur ka ndodhur?** | **Ku ka ndodhur?** | **Cilat shtete/ popuj u përfshinë?** | **Pse ndodhi?** |
|---|---|---|---|---|
| Lufta e Ftohtë | | | | |
| Traktati i Varshavës | | | | |
| Lufta në Jugosllavi e shpërbërja e saj | | | | |

**Grupi 2**

| *Ngjarja* | **Kur ka ndodhur?** | **Ku ka ndodhur?** | **Cilat shtete/ popuj u përfshinë?** | **Pse ndodhi?** |
|---|---|---|---|---|
| Krijimi i NATO-s | | | | |
| Revolta e Budapestit | | | | |
| Rënia e tensionit Lindje- Perëndim (Lufta e Ftohtë)<br>a. Takimi Kenedi–Hrushov<br>c. Takimi Regan–Gorbaçov | | | | |

**Grupi 3**

| *Ngjarja* | **Kur ka ndodhur?** | **Ku ka ndodhur?** | **Cilët shtete/ popuj u përfshinë?** | **Pse ndodhi?** |
|---|---|---|---|---|
| Pranvera e Pragës | | | | |
| Shpërbërja e BRSS-së | | | | |
| - Rënia e tensionit Lindje-Perëndim (Lufta e Ftohtë)<br>- Rënia e Murit të Berlinit | | | | |

**Hapi i tretë:**
- Pas përfundimit të detyrës, një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.
- Diskutohen përgjigjet.

❍ *Çështja **2:*** **Zhvillimet në shkencë dhe teknologji, mënyrë e re jetese**

**Hapi i parë:**
Mësuesi/ja prezanton shkurtimisht të rejat në shkencë, teknologji dhe mënyrën e jetesës në shek. XX.

**Hapi i dytë:**
Mësuesi/ja u kërkon grupeve që të plotësojnë tabelën e mëposhtme, të cilën ia shpërndan grupeve. Mësuesi/ja sqaron përmbajtjen e tabelës dhe mënyrën si do të plotësohet.

**Grupi 1**

| *Çfarë ka ndodhur* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Amerikanizmi | | | | |
| Fryma e re e jetesës | | | | |

**Grupi 2**

| *Çfarë ka ndodhur* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Jeta e konsumit | | | | |
| Revolucioni i Tretë Industrial | | | | |

**Grupi 3**

| *Çfarë ka ndodhur* | **Kur?** | **Ku?** | **Kush?** | **Pse?** |
|---|---|---|---|---|
| Propaganda (reklama) | | | | |
| Globalizmi | | | | |

**Hapi i tretë:**
Pas përfundimit të detyrës një përfaqësues për çdo grup prezanton punën e grupit.
Diskutohen dhe vlerësohen përgjigjet.

## ► Vlerësimi

Mësuesi/ja mban shënime në evidencë për nxënësit lidhur me angazhimin e tyre në punën në grup, përgjigjet e dhëna.

# Test i tremujorit III

1. **Rretho alternativën e saktë.**
   **Regjimi i kolonelëve (1967) në Greqi u vendos:**
   a) me revolucion; b) me grusht shteti;
   c) me anë të zgjedhjeve; ç) me anë të ndërhyrjes nga jashtë.

2. **Shpjegoni kuptimin e termave Perestrojka dhe Gllasnost.**
   ______________________________
   ______________________________
   ______________________________

3. **Rretho alternativën e saktë.**
   **Qeveritë e para jokomuniste** *në disa vende të Europës Lindore (Poloni, Hungari, RDGJ, Çekosllovaki) erdhën në pushtet me anë të:*
   a) revolucionit; b) ndërhyrjes nga jashtë;
   c) terrorit; d) rrugës paqësore nëpërmjet zgjedhjeve.

4. **Plotëso vendet bosh.**
   **ShBA hyri në Luftën e Dytë Botërore pas sulmit të:**
   a. Në ____________________ Greqia u pranua në NATO.
   b. Në ____________________ Zhivkovi u largua nga pushteti.
   c. Në ____________________ shpiket radioja e parë me transistor.
   d. Në ____________________ Shqipëria u bë anëtare e OKB-së.
   e. Në ____________________ Shqipëria u anëtarësua në NATO.

5. **Cilat janë institucionet e Bashkimit Europian?**
   a. ______________________________
   b. ______________________________
   c. ______________________________
   d. ______________________________
   e. ______________________________

6. **Shëno me V (vërtetë) ose G (gabuar).**
   a. Në janar 1981 Greqia u bë anëtare e Komunitetit Europian. ____
   b. Në Bullgari dhe Rumani gjatë Luftës së Ftohtë u zbatua modeli perëndimor i zhvillimit të ekonomisë. ____
   c. Në Shqipëri gjatë regjimit komunist pluralizmi politik ishte i ndaluar. ____
   d. Perestrojka ishte politikë bujqësore e Bullgarisë pas Luftës së Dytë Botërore. ____
   e. Qëllimi i OKB-së është ruajtja e paqes dhe e sigurisë në botë. ____
   f. Muri i Berlinit filloi të shembej në tetor të vitit 1990. ____
   g. Në Rumani rënia e regjimit komunist u shoqërua me gjak e dhunë. ____
   h. Bashkimi i Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore ndodhi më 1970. ____

7. **Çfarë ishte Pakti i Stabilitetit i vitit 1999?**
   ______________________________
   ______________________________

8. **Çfarë përfaqëson Revolucioni i Tretë Industrial?**
   ______________________________
   ______________________________
   ______________________________

**9. Çfarë u përcaktua në Traktatin e Mastrihtit?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**10. Renditni tri format e lëvizjes shoqërore në gjysmën e dytë të shek. XX.**

a. ______________________________________________

b. ______________________________________________

c. ______________________________________________

**11. Çfarë përfaqësonte Solidarnosi?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**12. Renditni masat që ndërmori qeveria shqiptare për vendosjen e sistemit komunist pas Luftës së Dytë Botërore.**

a. ______________________________________________

b. ______________________________________________

c. ______________________________________________

**13. Pse u përkeqësua gjendja në Rumani në vitet '80?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**14. Çfarë kuptoni me termin "globalizëm"?**

______________________________________________

______________________________________________

**15. Çfarë veçorish kishte politika e jashtme e Britanisë pas Luftës së Dytë Botërore?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**16. Çfarë është efekti "serrë" dhe si ndikon ai në mjedisin e botës së sotme?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**17. Pse trupat sovjetike ndërhynë në Hungari (1956) dhe Çekosllovaki (1968)?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**18. Çfarë simbolizonte rënia e Murit të Berlinit?**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

## FORMULAR VETËVLERËSIMI

*(Tremujori i tretë)*

**Lënda: Histori** **Klasa: 8** **Emër mbiemër:** ______________________________

| | **Nëntematika** | **Niveli i vetëvlerësimit** | | |
|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Nëntematika 2.3 Ekonomia gjatë viteve të Luftës së Ftohtë** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përshkruaj prirjet e Revolucionit të Tretë Industrial (elektronik); | | | |
| 2 | Vlerësoj ndikimin e Revolucionit të Tretë Industrial. | | | |
| 3 | Përcaktoj në hartë frontet kryesore të Luftës së Dytë Botërore; | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 2.4 Shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europën e viteve 1945–1990** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përshkruaj mënyrën e jetesës në shoqërinë europiane të viteve 1945–1990; | | | |
| 2 | Shqyrtoj lëvizjet sociale në Europë duke vlerësuar arritjet e tyre (lëvizja feministe, lëvizja e të rinjve, lëvizja kundër diskriminimit racial); | | | |
| 3 | Tregoj tiparet e reja në art, kulturë, shkencë dhe arsim në Europën e viteve '45–'90; | | | |
| 4 | Krahasoj aspekte të jetës së përditshme ndërmjet një familjeje shqiptare dhe një familjeje europiane gjatë viteve '45-'90 | | | |
| 5 | Shqyrtoj dhe interpretoj veçoritë e artit arsimit dhe jetës së përditshme gjatë viteve '45-'90. | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 2.5 Përfundimi i Luftës së Ftohtë** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Përcaktoj dhe përdor këto koncepte e terma historikë: revolucion demokratik, Gllasnost, Perestrojkë; | | | |
| 2 | Përshkruaj ngjarjet që shënuan përfundimin e Luftës së Ftohtë; | | | |
| 3 | Përcaktoj lëvizjet antikomuniste që çuan në transformimin e shteteve komuniste në shoqëri demokratike; | | | |
| 4 | Evidentoj në hartën e Europës, ndryshimet territoriale pas Luftës së Ftohtë (Bashkimi i Gjermanisë, shpërbërja e Jugosllavisë dhe pavarësia e Kosovës). | | | |
| 5. | Përshkruaj rrugën e zhvillimit historik që ka kaluar Kosova drejt pavarësisë; | | | |
| 6. | Vlerësoj ndikimin e institucioneve ndërkombëtare në krijimin e shtetit të Kosovës. | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 2.6 Ekonomia gjatë viteve të Luftës së Ftohtë** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1 | Vendos në linjën e kohës etapat e formimit dhe zgjerimit të BE-së deri më sot; | | | |
| 2 | Evidentoj Traktatin e Mastrihtit, si vazhdues të procesit të integrimit europian; | | | |
| 3 | Vlerësoj rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Europian; | | | |
| 4. | Listoj institucionet kryesore vendimmarrëse të BE-së dhe misionin e tyre; | | | |
| 5. | Vlerësoj zgjerimin e procesit të integrimit euro-atlantik në shtetet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore; | | | |
| 6. | Vlerësoj integrimin rajonal si proces ndihmës i integrimit europian. | | | |
| **Nr** | **Nëntematika 2.7 Prirjet e qytetërimeve sot** | **Mjaftueshëm** | **Mirë** | **Sh. mirë** |
| 1. | Evidentoj lëvizjet e reja sociale; | | | |
| 2. | Përcaktoj ndryshimet që solli në jetën ekonomike dhe shoqërore Revolucioni i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; | | | |
| 3. | Diskutoj kuptimin e ndotjes së mjedisit; | | | |
| 4. | Evidentoj efektet e globalizimit; | | | |
| 5. | Përshkruaj format dhe mënyrat e ndryshme të jetesës në qytetërimet e sotme, duke gjykuar mbi raportet trashëgimi dhe tendencat e reja sot; | | | |
| 6. | Vlerësoj tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit; | | | |
| 7. | Vlerësoj prirjet e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës; | | | |

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Tabaku, Anila
Histori 8 : libër mësuesi : për klasën e 8-të të
shkollës 9-vjeçare / Anila Tabaku, Najada Hoxha. –
Tiranë, etj. : Albas, 2017
142 f. : me il. ; 20.5x27.5 cm.

ISBN 978-9928-02-855-6

I. Hoxha, Najada
1. Historia botërore     2. Tekste për mësuesit
3. Tekste për shkollat 9-vjeçare
94(4/9) (073) (075.2)